

**SHQIPËRIA MES LINDJES DHE PERËNDIMIT:
STUDIM KRAHASIMOR MBI ORIENTIMIN GJEOSTRATEGJIK TË
SHQIPËRISË NË PERIUDHËN 2009-2019**

Erlis Hoxha

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Sociale, me profil Shkenca Politike-Marrëdhënie Ndërkombëtare
për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof. Asoc. Dr. Enri Hide**

Numri i fjalëve: 50.358

Tiranë, qershor 2020

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë Erlis Hoxha deklaroj me përgjegjësi të plotë se, ky punim doktoral është shkruar prej meje dhe nuk është prezantuar më përpara në asnjë institucioni tjetër akademik për vlerësim. Të dhënat dhe informacionet e paraqitura në të janë autentike dhe në përputhje të plotë me të gjitha rregullat dhe standardet shkencore të parashikuara.

Erlis Hoxha

ABSTRAKTI

Pozicioni gjeografik i Shqipërisë, midis Lindjes dhe Perëndimit, e bën atë dukshëm të cenueshëm ndaj ndikimeve dhe implikimeve të Fuqive të Mëdha perëndimore, si SHBA, BE, por edhe karshi fuqive joperëndimore, si Rusia, Turqia dhe Kina. Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i orientimit gjeostrategjik të Shqipërisë nën peshën e ndikimit të vendeve joperëndimore, duke shqyrtuar dimensionet ekonomike, politike dhe social-kulturore.

Pyetja kërkimore: *A është zhvendosur orientimi gjeostrategjik properëndimor i Shqipërisë nën ndikimin e vendeve joperëndimore?*

Hipoteza: *Ndikimi i Turqisë, Rusisë dhe Kinës, nuk e ka zhvendosur orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë.*

Metodologjia në këtë studimi kombinon qasjen sasiore dhe atë cilësore. Instrumentet e ardhur në ndihmë janë:

a) Pyetësorët vetë-raportues, të cilët u shpërndanë me një kampionim prej 500 të rinjsh, anëtarë të forumeve politike të partive kryesore në vend, si dhe midis studentëve nga universitete të ndryshme në vend.

b) Pyetësorët cilësorë, të cilët iu dërguan 6 ekspertëve të përzgjedhur.

Rezultatet e studimit treguan, se, përgjithësisht, të dyja grupet e mësipërme bashkohen në idenë se influenca e vendeve joperëndimore: Rusi, Turqi dhe Kinë, shfaqet në të tri dimensionet: ekonomike, politike dhe kulturore, gjithsesi ajo nuk ka arritur të zhvendosë orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë. Nga të tri vendet e marra në analizë, Turqia perceptohet si vendi me influencën më të madhe ekonomike, politike dhe kulturore, në raport me dy vendet e tjera: Rusi, Kinë, si dhe me SHBA-BE, ndërsa vendi me influencën penguese më të madhe në dimensionin politik të Shqipërisë perceptohet Rusia. Sa i takon Kinës, influenca e saj më e madhe perceptohet kryesisht në dimensionin ekonomik, pavarësisht se efekti i saj në këtë dimension nuk është shumë nevralgjik.

ABSTRACT

Albania's geographical position, between East and West, makes it significantly vulnerable to the influences and implications of the Great Western Powers, such as the United States, the European Union, but also to non-Western powers such as Russia, Turkey and China. The aim of this study is to assess the geostrategic orientation of Albania, examining the influence of non-Western powers, in economic, political and socio-cultural dimensions.

Research question: *Has Albania's pro-Western geostrategic orientation shifted under the influence of non-Western countries?*

Hypothesis: *The influence of Turkey, Russia and China has not shifted Albania's pro-Western geostrategic orientation.*

The methodology in this study combines quantitative and qualitative approaches. The study used the following measuring instruments:

a) Self-reporting questionnaires were distributed in a sample of 500 young people, members of the political forums of the main parties in the country, as well as among students from different universities in the country.

b) Qualitative questionnaires, which were sent to 6 selected experts.

The results of the study showed that, in general, the above two groups come together in the idea that the influence of non-Western countries: Russia, Turkey and China, appears in all three dimensions: economic, political and cultural, but it has not managed to shift the pro-western geostrategic orientation of Albania. Of the three countries analyzed, Turkey is perceived as the country with the greatest economic, political and cultural influence in relation to the other two countries: Russia, China, and the US-EU. Meanwhile, the country with the biggest influence to Albania's political dimension is Russia. As for China, its greatest influence is perceived mainly in the economic dimension, despite the fact that its effect in this dimension is not very strategic.

DEDIKIMI

Këtë punim ia dedikoj familjes time të çmuar, pa dashurinë dhe mbështetjen e së cilës, realizimi i këtij punim do të ishte i pamundur.

Një mirënjohje e veçantë, shkon për miken time, Prof. Asoc. Dr. Erika Melonashi, e cila më ka mbështetur, ditë pas dite, muaj pas muaji, deri në realizimin me sukses të këtij punimi doktoral.

Faleminderit!

FALENDERIME

Dua të falenderoj për zemërsisht udhëheqësin tim shkencor, Prof. Asoc. Dr. Enri Hiden, për ndihmën, këshillat dhe rekomandimet që më ka dhënë, për realizimin me sukses të këtij punimi.

Një falenderim i për zemërt i shkon Departamentit të Shkencave Sociale, dhe stafit të Shkollës Doktorale për mbështetjen dhe përkushtimin e treguar gjatë kësaj periudhe.

Së fundmi, por jo nga rëndësia, dua të falenderoj Profesor Henri Çilin, dhe Universitetin Europian të Tiranës, për mundësinë dhe bashkëpunimin e shkëlqyer përgjatë viteve të studimeve doktorale.

Me mirënjohje,

Erlis Hoxha

PËRMBAJTJA E LËNDËS	FAQ. 7
KAPITULLI I: HYRJE	FAQ. 10
1.1. Vështrimi historik	FAQ. 10
1.2. Konteksti i studimit	FAQ. 16
1.3. Qëllimi i studimit dhe pyetjet kërkimore	FAQ. 18
KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS DHE QASJA	FAQ. 20
TEORIKE	
2.1. Shkolla Realiste	FAQ. 20
KAPITULLI III: DOKTRINAT POLITIKE	FAQ. 25
3.1. Politika e jashtme dhe diplomacia shqiptare	FAQ. 25
3.2. Prezenca dhe roli i BE-së në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor	FAQ. 30
3.3. Prezenca dhe roli i SHBA-së në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor	FAQ. 34
3.4. Doktrina e Turqisë në Ballkanin Perëndimor dhe prezenca në Shqipëri	FAQ. 39
3.5. Doktrina e Rusisë në Ballkanin Perëndimor dhe prezenca në Shqipëri	FAQ. 44
3.6. Doktrina e Kinës në Ballkanin Perëndimor dhe prezenca në Shqipëri	FAQ. 55
KAPITULLI IV: METODOLOGJIA	FAQ. 68
4.1. Përzgjedhja e metodologjisë së studimit	FAQ. 68
4.2. Kampionimi	FAQ. 70
4.2.1. Kampioni sasior	FAQ. 70
4.2.2. Kampioni cilësor	FAQ. 72
4.3. Instrumenti matës	FAQ. 74
4.3.1. Instrumenti sasior	FAQ. 74
4.3.2. Instrumenti cilësor	FAQ. 74
4.4. Procedura e studimit	FAQ. 75
4.5. Kufizimet metodologjike	FAQ. 76

KAPITULLI V: ANALIZA SASIORE DHE CILËSORE	FAQ. 78
5.1. Analiza sasiore	FAQ. 78
5.1.2. Sfidat aktuale të Shqipërisë	FAQ. 78
5.1.3. SHBA dhe BE: Perceptimet e influencës ekonomike, politike dhe kulturore në Shqipëri	FAQ. 79
5.1.4. Turqia, Rusia, Kina: Perceptime të influencës ekonomike, politike dhe kulturore në Shqipëri	FAQ. 79
5.1.5. Analiza krahasuese: Turqia përballë SHBA-BE	FAQ. 81
5.1.6. Analiza krahasuese: Kina kundrejt SHBA-BE	FAQ. 81
5.1.7. Analiza krahasuese: Rusia përballë SHBA-BE	FAQ. 82
5.1.8. Turqia, Rusia, Kina, si pengesë ndaj integritit evropian	FAQ. 82
5.2. Analiza cilësore: Roli i Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor	FAQ. 83
5.2.1. Analizë: Sfidat e Shqipërisë	FAQ. 84
5.2.2. Analizë: Ndikimi i vendeve perëndimore SHBA-BE në Shqipëri.	FAQ. 87
5.2.3. Analizë: Ndikimi i Ruisë/ Turqisë/ Kinës në Shqipëri?	FAQ. 90
5.2.4. Analizë: Krahasim i nivelit të ndikimit të Turqisë, Ruisë, Kinës në Shqipëri	FAQ. 93
KAPITULLI VI: DISKUTIME DHE KONKLUSIONE	FAQ. 96
6.1. Perceptimi mbi sfidat dhe barrierat për integrimin evropian	FAQ. 97
6.1.1. Të dhënat sasiore	FAQ. 97
6.1.2. Të dhënat cilësore	FAQ. 99
6.2. Influenat ekonomike, politike dhe kulturore të SHBA-së dhe BE-së në Shqipëri	FAQ. 101
6.3. Influenat ekonomike, politike dhe kulturore të Turqisë, Ruisë dhe Kinës	FAQ. 104
6.3.1. Ndikimi kinez në Shqipëri	FAQ. 108
6.3.2. Të dhënat cilësore	FAQ. 109
6.4. Analizë krahasimore: SHBA-BE kundrejt vendeve joperëndimore: Turqi, Rusi, Kinë	FAQ. 111
6.5. Konkluzione dhe sugjerime për studime të mëtejshme	FAQ. 115

BIBLIOGRAFIA	FAQ. 117
SHTOJCAT Nr. 1	FAQ. 131
PYETËSORI PËR FORUMET POLITIKE	FAQ. 131
INTERVISTAT E EKSPERTËVE	FAQ. 132
SHTOJCA Nr. 2	FAQ. 133
INTERVISTAT E EKSPERTËVE	FAQ. 133
SHTOJCA Nr. 3	FAQ. 152
ANALIZAT SASIORE	FAQ. 152

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Vështrimi historik

Rënia e Murit të Berlinit dhe përfundimi i Luftës së Ftohtë, do të ndryshonte rrënjësisht dinamikën e zhvillimit të sistemit politik ndërkombëtar. Deri në vitet '90-të, sistemi politik ndërkombëtar ishte bipolar, i ndarë në dy blloqe kryesore: Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, Bashkimi Sovjetik me vendet e tij satelite. (Encyclopedia Britannica, 2020). Këto dy blloqe të mëdha kanë pasur një rivalitet të gjatë me njëri-tjetrin, por tashmë, nën presionin e zhvillimeve gjeopolitike, ishin të detyruara të ridimensiononin qëndrimet e tyre për t'u bërë ballë kërkesave dhe nevojave që do të sillte epoka e Pasluftës së Ftohtë. Përmbysja e sistemit komunist në pjesën dërrmuese të Evropës Lindore dhe asaj Juglindore do të sillte një sfidë të drejtpërdrejtë jo vetëm për Bashkimin Sovjetik, por edhe për kancelaritë e vendeve perëndimore dhe SHBA-në, në menaxhimin e krizës, jo vetëm politike, që po përjetonin këto vende, falimentimin politik dhe ekonomik të Federatës Ruse dhe vendeve satelite të saj (Schweller, 2000).

U deshën afro 70-vjet, që komunizmi, ky sistem politik, ekonomik, kulturor dhe strukturor, të dëshmohej i pamundur për të përballuar sfidat e kohës dhe për t'u ofruar standardet dhe mirëqenien e nevojshme vendeve të cilat e kishin përqafuar këtë model politik, ndër to edhe Shqipëria në vitet 1945-1990. Sfidat, me të cilën po përballlej në këtë periudhë Komuniteti Ndërkombëtar ishte rivitalizimi ekonomik, politik e social i Bashkimit Sovjetik, si dhe ish-republikave nën sundimin e tij. Ka pasur një angazhim të jashtëzakonshëm nga Këshilli Ekonomik Evropian, i cili ofroi ndihmën dhe ekspertizën e tij në përballimin e kësaj krize të gjithanshme, që kishte kapluar sistemin sovjetik, i cili konsistonte në:

1. Përshtatjen e ekonomisë ruse me rregullat e tregut të lirë.
2. Ofrimin e asistencës teknike të nivelit të lartë, për të mbështetur transformimin e drejtpërdrejtë të ekonomisë, nga e centralizuar në ekonomi të tregut të lirë.
3. Ndihmë monetare e drejtpërdrejtë nga Këshilli Ekonomik Evropian për Rusinë, në mënyrë që të kalonte periudhën tranzitore. (Milo, 2002)

Nga ana tjetër, rajoni i Ballkanit Perëndimor ishte, po ashtu, i trazuar nga këto ndryshime dramatike politiko – sociale. Thuhet të gjitha vendet, të cilat kishin përfaqëuar sistemin komunist, sikundër Shqipëria, tashmë u lindte nevoja të përballeshin me sfida si:

1. Pluralizmin politik (hapja e sistemit politik për të konkurruar si platforma ideologjike dhe programatike).
2. Përshtatjen e ekonomisë së centralizuar me rregullat e tregut të lirë.
3. Krijimin e mekanizmave, për të përshtatur ekonominë ndaj kapitalit dhe investimeve të huaja, të cilat ishin të panjohura për vendin në atë kohë.
4. Rritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale, për përballimin e sfidave të reja që kërkonte përshtatja e tregut në ekonomi, sikundër në të gjitha fushat e nevojshme.

(Abazi, 2008)

Natyrshëm këto hapa transformuese kërkonin angazhimin e aktorëve politikë të kohës, si dhe mbështetje në përvojën e vendeve të zhvilluara të Evropës Perëndimore. Rajoni i Ballkanit ishte tërësisht i papërgatitur për t'u përballur me këto sfida, pasi vinte nga një trashëgimi e gjatë nga diktaturat komuniste, ku Partia – shtet kishte monopolizuar krejt veprimtarinë ekonomike dhe politike. Nisur nga ky kontekst, sikurse vendet e rajonit, edhe Shqipëria do të bënte përpjekjet e para për t'ia përshtatur ekonominë tregut të lirë, por edhe liberalizimin e ideve dhe partive politike, sfida të cilat u mbështetën menjëherë nga SHBA-ja. Në vitet '90-të, vetë Sekretari i Shtetit Amerikan, James Baker, vizitoi për herë të parë Shqipërinë, duke dhënë kështu mbështetjen e SHBA-së për tejkalimin e këtyre sfidave imediate, ku dy çështje ishin thelbësore:

- a) Pluralizmi politik;
- b) Liberalizimi i ekonomisë, kalimi nga ekonomia e centralizuar në ekonomi e tregut të lirë.

Nga ana tjetër, ndryshimi i sistemit politik të Shqipërisë do të mbështetej edhe nga Këshilli Ekonomik Evropian, (Bashkimi Evropian i sotëm). Madje, nëpërmjet mekanizmave politike, ky këshill do ta mbështeste Shqipërinë në rrugën e vështirë për transformimin e sistemit politik dhe hapjen e ekonomisë dhe përshtatjen e saj me tregun e lirë. Sfidat e këtyre 30-viteve të fundit, nuk kanë qenë të lehta për Shqipërinë, megjithatë vlen të theksohet se janë bërë hapa të rëndësishme përpara. Shqipëria është bërë anëtare e më shumë se 40

organizmave evropiane dhe ndërkombëtare, të cilat kanë në themel promovimin dhe konsolidimin e vlerave demokratike, ruajtjen e paqes, forcimin e stabilitetit politik dhe ekonomik, ndër to, përmendim disa nga organizmat më të rëndësishme, në të cilat, vendi ynë bën pjesë, (Tafili, 2015):

- a) OKB
- b) KËSHILLI I EVROPËS
- c) NATO
- d) OSBE
- e) OECD
- f) UNESCO
- g) FMN
- h) OBT, etj.

Gjithashtu, progresi për marrjen e statusit të vendit kandidat në BE, si dhe përpjekja për hapjen e negociatave për anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian, janë hapa të cilat dëshmojnë qartë orientimin strategjik properëndimor të Shqipërisë. Mirëpo, krahas këtyre zhvillimeve, Shqipëria ka ende sfida të rëndësishme përpara, të tilla si:

- a) Konsolidimi i institucioneve të pavarura demokratike;
- b) Administratë publike profesionale, jashtë influencave politike;
- c) Sistem gjyqësor të pavarur.

Çdo ndalesë e pajustificuar e Shqipërisë në përmbushjen e këtyre angazhimeve, do ta zbehin orientimin strategjik properëndimor të saj, dhe do ta bëjnë atë të cenueshme ndaj influencave të vendeve joperëndimore, si Rusia, Turqia dhe Kina, të cilat, më vete apo së bashku, po investojnë në mënyra të ndryshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor, për të rritur sa më shumë ndikimin gjeopolitik të tyre.

Parashtrimi i problemit

Balanca e fuqive të aktorëve ndërkombëtarë pas Luftës së Ftohtë ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Rritja e fuqive joperëndimore në skenën globale, në dekadën e fundit, është duke e sfiduar vazhdimisht dominimin e aktorëve të rëndësishëm Perëndimorë në arenën ndërkombëtare, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, (Ersen, 2014).

Në këtë kontekst, Shqipëria nuk është e imunizuar nga këto influenza, përkundrazi, çdo dobësi apo paqartësi e institucioneve të saj ndaj sfidave reale të vendit, nga njëra anë, dhe zbehja e rolit të Bashkimit Evropian në proceset integruese me vendet e Ballkanit Perëndimor, nga ana tjetër, do t'u jepte shkas aktorëve joperëndimorë të gjenin hapësira për ta shtrirë më tej ndikimin e tyre në këtë rajon. Në këto rrethana, vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Shqipërinë, u duhet të përballen me sfida dhe rreziqe, si:

- a) rishfaqja e interesave ruse në dimensionin ekonomik, politik dhe ushtarak;
- b) agjenda neo-otomane e Turqisë në politikën e jashtme;
- c) interesat gjeoekonomike të Kinës në këtë rajon.

Vlen të theksohet se forcat e përbashkëta midis Ruisë, Turqisë dhe Kinës, krijojnë një trekëndësh strategjik që sfidon haptazi Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj perëndimorë në terma gjeopolitike dhe gjeoekonomike, të cilat shoqërohen me implikime të rëndësishme për fuqitë më të vogla ndërkombëtare dhe rajonale, por edhe për vendet individuale në pjesë të ndryshme të botës (Lachert, 2018). Me gjithë madhësinë apo rëndësinë e tyre në politikën botërore, nuk mund të anashkalohej fakti se vendet e Ballkanit Perëndimor ndikohen nga ndryshimet e përsëritura të pushtetit dhe konkurrencës midis Perëndimit dhe Lindjes. Paqëndrueshmëria politike dhe krizat e herëpashershme në këtë rajon (Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut), i kanë dhënë Ruisë hapësirë dhe mundësi që të depërtojë dhe prania e saj në Ballkanin Perëndimor të shndërrohet në shqetësim për BE-në dhe SHBA-në. Pavarësisht nga zhvillimet e brendshme politike lokale, interesat e ndryshme të vendeve jashtë këtij rajoni përplasen në Ballkanin Perëndimor dhe bëhen pjesë e konfliktit të përgjithshëm gjeopolitik midis Lindjes dhe Perëndimit, më së shumti ndërmjet Ruisë dhe Bashkimit Evropian, por pa përjashtuar edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ballkani Perëndimor duket se vazhdon të jetë ende një “rajon problematik” për Evropën dhe më gjerë. Në këtë kontekst, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të interesuara të shmangin çdo mundësi, për të mos lejuar përsëritjen e konflikteve të përgjakshme, sikurse kanë ndodhur në vitet 1990 (me Bosnjë-Hercegovinën dhe luftën e Kosovës), si dhe për të minimizuar ndikimin potencial të Ruisë dhe afrimin së fundmi të Kinës në këtë rajon.

Rusia, nga ana tjetër, i sheh vendet e Ballkanit Perëndimor, veçanërisht aleatët e saj historikë (Serbinë dhe Malin e Zi), si zona të favorshme për t'iu kundërpërgjigjur ndikimit të BE-së dhe SHBA-së drejt Lindjes. (Lo, 2002). Ajo ka përdorur instrumentet e saj ekonomike dhe ushtarake për të dëshmuar fuqinë e saj në këtë rajon, duke bashkëpunuar ngushtësisht me aleatët në çështjet ushtarake dhe duke investuar në sektorët kyç strategjikë, si: energjia, transporti, turizmi dhe tregjet financiare.

Shpeshherë, vëmendja ndaj Ruisë ka qenë tek lëvizjet e saj gjeopolitike në Ukrainë, Gjeorgji, si dhe në Baltik në të ardhmen, nga ana tjetër, Rusia po avancon sërish drejt Ballkanit Perëndimor, së pari, duke rivitalizuar marrëdhëniet e saj me partnerët historikë si Serbia dhe Mali i Zi.

Edhe pse Ballkani Perëndimor ka pësuar një konfigurim të ri gjeopolitik përgjatë dekadave të fundit, Rusia dhe Turqia kanë treguar një interes të gjerë në këtë rajon: Rusia në sektorin e energjisë, ndërsa Turqia si një nga fuqitë më të mëdha tregtare dhe investuese në rajon, duke përdorur lidhjet historike dhe kulturore, përveç investimeve ekonomike, për të rritur dominimin e saj. (Ribaj & Çami, 2015). Studiuesit shprehen, se stabiliteti dhe demokracia në rajonin e Ballkanit Perëndimor po dobësohen, duke krijuar në këtë mënyrë një terren të lirë për rikthimin e garave gjeopolitike, për të çuar më tej interesat e fuqive të tjera në rajon. Gjatë dekadës së fundit, demokracitë e brishta të vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë bërë hapa prapa, veçanërisht pas krizës financiare të vitit 2008, një proces që nuk është vlerësuar maksimalisht nga SHBA-ja dhe BE-ja. Indeksi i transformimit të “Bertelsmann” (BTI 2018, Albania Country Report) i rendit vendet e Ballkanit Perëndimor si demokraci jofunksionale. Ky Indeks, është një nga pyetësorët më gjithëpërfshirës të shteteve mbi përpjekjet e tyre për transformim dhe përfshin 129 vende, ndër të cilët edhe Shqipërinë, duke zbuluar pikat e tyre të forta dhe të dobëta. Indeksi BTI i vlerëson shtetet sipas treguesve, në një shkallë nga 1 deri në 10. Ky indeks i ndan treguesit në tri kategori kryesore: statusi i demokracisë, statusi i ekonomisë së tregut, si dhe indeksi i qeverisjes. Posaçërisht për Shqipërinë, ky indeks vlerëson: Statusin e Demokracisë: 7.05 /10; Statusi i Ekonomisë së Tregut: 6.61/ 10; Indeksi i Qeverisjes: 6.02/10 dhe Indeksi i Përgjithshëm: 6.83/10.

Nga të dhënat e mësipërme vërehet një progres i ngadaltë në procesin e integritimit evropian, në një kohë që Bashkimi Evropian po përballet me sfida të brendshme, si në fushën

politike, ashtu edhe në atë ekonomike. Vitet e fundit, dobësitë e Bashkimit Evropian përballë kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme, për të ofruar mundësi reale për vendet e Ballkanit Perëndimor, u krijuan terren të lirë fuqive dhe aktorëve të tjerë globalë, për të mbushur këtë boshllëk gjeoekonomik, veçanërisht Ruisë, Turqisë dhe Kinës. (Duroselle, Kaspi, 2009).

Turqia - Politika e Jashtme e Turqisë e dy dekadave të fundit, kryesisht është bazuar në doktrinën e “Thellësisë Strategjike” të ish-Ministrit të Jashtëm dhe ish-Kryeministrit, Ahmet Davutoglu, i cili doktrinën e vet e bazon tek e kaluara e ndritur e ish-Perandorisë Osmane, si dhe tek kufijtë e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe historinë e tyre. Në këtë prizëm, theksohen lidhjet e Turqisë me Ballkanin Perëndimor, Lindjen e Mesme, madje edhe me Azinë Qendrore (Davutoglu, 2001).

Prej vitit 2000, kohë kur Turqia njohu dhe bumën e saj ekonomik, interesi i saj për të investuar në këto vende ka qenë gjithnjë e më i lartë. Agjencia Turke për Zhvillim është aktive në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor (Levitin, 2016).

Rusia - Një analizë e kohëve të fundit arriti në përfundimin, se Gadishulli Ballkanik po bëhet një fushëbetejë e rëndësishme midis interesave gjeopolitikë e strategjikë të Ruisë dhe interesave të Perëndimit. Edhe pse në kontrast të fortë me institucionet dhe demokracinë perëndimore, nëpërmjet mjeteve informative, politike, ekonomike dhe ushtarake, Rusia ia ka dalë të përballët me to, madje nuk janë të pakta rastet e diskreditimit të tyre (Bieri, 2015).

Në disa vende të rajonit ekziston një perceptim i ndikimit më të madh ekonomik rus, krahasimisht me BE-në, siç është Serbia. Në aspektin e stabilitetit të zhvillimit ekonomik, është e rëndësishme të vlerësohet, se ekonomia e shumicës së vendeve të Ballkanit Perëndimor është tepër vunerabël/e dobët, me përjashtim të Kroacisë (Leci, 1999; 2005; 2006). Nevoja për investime ekonomike, por jo vetëm, e lidhur ngushtë me korrupsionin dhe institucionet e dobëta, kanë krijuar mundësi për aktorë të tillë si Rusia, për të përfituar dhe ndikuar politikisht dhe në fushën kulturore. Ndikimi ekonomik rus është më i fortë në Serbi, Bosnjë - Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, me ndikim të moderuar në Kosovë dhe më pak ndikim në Kroaci dhe Shqipëri.

Kina - Për vendet tashmë anëtare të BE-së, investimet kineze shihen si plotësuese të fondeve të BE-së, ndërsa për shumë nga vendet e Ballkanit Perëndimor prania kineze është

një mënyrë vitale për të siguruar financim për infrastrukturën dhe teknologjinë, megjithëse nuk janë vënë ende në dispozicion të vendeve që nuk janë pjesë e BE-së. (Zhou & Nakagawa, 2002; Patten, 2011).

Duke pasur një boshllëk financimi, procedurat e ngadalta të zbatimit për projektet e BE-së dhe pengesat e tjera institucionale, në këto rrethana, Kina është paraqitur si një alternativë tërheqëse me ofertën e saj të “proceseve të efektshëm të miratimit, financimit shtetëror të mbështetur dhe zbatimin e shpejtë”.

Përfshirja e Kinës me vendet e Evropës Juglindore është përqendruar në tri fusha kryesore:

- 1) Huadhënie e drejtpërdrejtë qeverive, për infrastrukturë;
- 2) Forcimin e lidhjeve tregtare;
- 3) Investime të drejtpërdrejta të kapitalit (Newton, & Subbaraman, 2002).

Strategjia e Kinës është të ndërtojë një “*linjë të shpejtë për Evropën*” për produktet kineze, duke “përdorur” Ballkanin Perëndimor si rrugë kalimi, për pasojë qasjet e liderëve të Kinës në këtë rajon rrjedhin nga strategjia e saj për krijimin e lidhjeve dhe integritet ekonomik të tyre. Ndërsa tregjet e Ballkanit Perëndimor janë relativisht të vogla për vëllimet kineze të produkteve, por ato kanë një pozicion gjeografik të rëndësishëm që mund të lidhë Kinën me Evropën Perëndimore për të depërtuar në tregun përfundimtar të synuar. (Lleshi, 2009).

Në mënyrë që të forcojë prezencën e saj në Ballkanin Perëndimor, në vitin 2012, Kina nisi iniciativën “16+1”, me qëllim intensifikimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit të saj me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, përfshirë Ballkanin Perëndimor, në fushën e investimeve, të transportit, të financave, të shkencës, të arsimit dhe kulturës. Çdo vit, në një nga shtetet, organizohet një mbledhje e palëve pjesëmarrëse, çka ka rezultuar një hap pozitiv në rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe ka ofruar një derë të hapur për infiltrimin kinez në tregjet perëndimore. Në gjenezën e saj, “16+1” u hartua në kuadrin e një bashkëpunimi të ndërsjellë, ku përfshiheshin 12 masa specifike, ndër to edhe krijimi i një linje kreditore, nëpërmjet të cilës janë investuar rreth 15.4 miliardë dollarë amerikanë. (Hillman, Mc Calpin, 2019).

1.2 Konteksti i studimit

Ky studim mbështetet në metodën sasiore dhe cilësore, për të shqyrtuar ndikimin e vendeve joperëndimore: Turqisë, Ruisë dhe Kinës, nga njëra anë, si dhe rolin dhe prezencën e SHBA – BE-së, nga ana tjetër, duke analizuar angazhimin e tyre në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe posaçërisht në Shqipëri. Ky studim ofron një analizë gjithëpërfshirëse të politikës së jashtme në këtë rajon dhe të Shqipërisë në veçanti, me qëllim matjen e perceptimit të ndikimit të vendeve joperëndimore përballë ndikimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian. Për realizimin e këtij studimi, si qasje teorike është përdorur *Teoria Realiste*. Kjo teori në marrëdhëniet ndërkombëtare, ka në thelb shtetet, të cilët konsiderohen si aktorë të rëndësishëm, pasi janë pikërisht ato që kanë fuqinë të ndikojnë ndaj shteteve të tjerë.

Periudha kohore e marrë në analizë është 10-vjeçari i fundit: 2009-2019. Përzgjedhja e kësaj periudhe kohore përkon me disa zhvillime të rëndësishme në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku në vitin 2009, Shqipëria dhe Kroacia do të bëheshin vende anëtare me të drejta të plota në Aleancën e Atlantikut të Veriut - NATO. Në aspektin e brendshëm, ky zhvillim do të konfirmonte orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë, ndërsa në rrafsh rajonal, dëshmoi edhe kahjen e vendeve të tjera të rajonit, si Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, të cilat shfaqën vullnetin për t'iu bashkuar kësaj Aleance, por edhe interesin për integrimin e tyre në Bashkimin Evropian. (Garcia 2009).

Kjo qasje gjeopolitike e vendeve të Ballkanit Perëndimor, nuk mund të kalonte pa “tërhequr vëmendjen” e Ruisë, si një vend me interes të theksuar për zhvillimet në këtë rajon.

Me rimëkëmbjen e ekonomisë, Rusia filloi të rikuperojë edhe statusin e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke u shfaqur si fuqi globale e dorës së parë, për të rifituar lavdinë e dikurshme, sigurisht përballë rivalit të përhershëm - Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë kontekst, këto zhvillime në Ballkanin Perëndimor do të shqetësonin Rusinë në “ambicien” e saj për të pasur me çdo kusht një rol ndikues në këtë rajon (Bugajski, 2020).

Nga ana tjetër, dy fuqi të tjera joperëndimore, si Turqia dhe më pas Kina, kanë shpalosur qëllimet e tyre për këtë rajon nëpërmjet investimeve në sektorë strategjikë: sistemin bankar,

në telekomunikacion, në transport dhe në energjetikë. Turqia, ndryshe nga Kina dhe Rusia, identifikohet me një influencë më konkrete në Ballkanin Perëndimor, duke investuar në mënyrë strategjike në sektorët kyçë, të sipërpërmendur. Turqia, në raport me dy vendet e tjera, ka një avantazh më të madh në këtë rajon, që lidhet me shkaqe historike, pasi është fakt i njohur historik, që Ballkani ka qenë për shekuj me radhë nën pushtimin otoman. Për rrjedhojë, kjo trashëgimi politiko - kulturore ka lënë gjurmët e saj. Nga ana tjetër, pavarësisht orientimit gjeostrategjik proevropian të Shqipërisë dhe partneritetit strategjik me SHBA-në, Rusia po bën të gjitha përpjekjet e mundshme për ta frenuar influencën e Perëndimit në Ballkanin Perëndimor.

Referuar të dhënave të këtij studimi, por dhe studiuësve të marrëdhënieve ndërkombëtare të rajonit të Ballkanit Perëndimor, influencat e vendeve joperëndimore janë identifikuar si shqetësuese dhe, jo rrallëherë, penguese për orientimin gjeostrategjik të rajonit dhe të Shqipërisë.

Në këtë kontekst, e gjithë sa më sipër, do të ishin shtysa për studiuësin për të ndërmarrë këtë studim, duke vlerësuar ndikimet dhe orientimin e dëshmuar properëndimor të Shqipërisë. (Bieri, 2015)

1.3 Qëllimi i studimit dhe pyetjet kërkimore

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë orientimin gjeostrategjik të Shqipërisë në periudhën 2009 – 2019, duke u fokusuar kryesisht në ndikimin e fuqive joperëndimore Rosisë, Turqisë dhe Kinës. Përcaktimi i këtij qëllimi lidhet me faktin se pas viteve “90, kursi i Shqipërisë në politikën e jashtme ishte euroatlantik, por në fund të viteve 2000, në rajonin e Ballkanit Perëndimor, fillon një fazë e re e ndikimeve të fuqive joperëndimore, sic janë, Rusia, Turqia dhe më pas Kina. Rritja e vazhdueshme e prezencës së tyre në këtë rajon, vë në diskutim vijimësinë e orientimit gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë.

Në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi, objektivat kryesore janë:

- a) Analizimi dhe identifikimi i ndikimit të fuqive joperëndimore me fokus në dimensionet: ekonomike, politike dhe social-kulturore.

- b) Vlerësimi i prezencës dhe ndikimit të vendeve aleate të Shqipërisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian.
- c) Paraqitja e një analizë vlerësuese të ndikimeve të këtyre vendeve në nivel rajonal.
- d) Matja e perceptimit të ndikimit të këtyre vendeve nga dy grupe të ndryshme, ekspertë të fushës dhe studentë.

Pyetja kërkimore: *A është zhvendosur orientimi gjeostrategjik properëndimor i Shqipërisë nën ndikimin e vendeve joperëndimore?*

Hipoteza: *Ndikimi i Turqisë, Rosisë dhe Kinës nuk e ka zhvendosur orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë.*

KAPITULLI II: QASJA TEORIKE

2.1. Shkolla Realiste

Arsyeja e përzgjedhjes së kësaj shkolle teorike të marrëdhënieve ndërkombëtare ka të bëjë me temën e studimit, e cila merr në analizë përballjen e fuqive midis shteteve, në këtë rast, përballjen e interesave gjeopolitike të Fuqive të Mëdha, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe, Ruisë, Turqisë dhe Kinës, nga ana tjetër. Analiza e tyre është në dimensionet ekonomike, politike dhe kulturore. Secili nga shtetet me avantazhet dhe disavantazhet që përfaqëson, por të gjitha së bashku në garën gjeopolitike për dominim, në këtë rast, Ballkanin Perëndimor, me të gjitha mënyrat e lejuara nga normat dhe rregullat ndërkombëtare të pranuar nga të gjitha vendet.

Realizmi është një shkollë mendimi, e cila marrëdhëniet ndërkombëtare i shpjegon nga pikëpamja e fuqisë. Ushtrimi i fuqisë së shteteve në marrëdhënie me njëri-tjetrin, në disa raste quhet real-politikë, e thënë ndryshe politikë e mbështetur te fuqia që kanë shtetet për të ndikuar te shtete të tjera me influencë më të dobët se ata. Realizmi, si teori në marrëdhëniet ndërkombëtare, ka shërbyer për studimin e Luftës së Ftohtë SHBA-Rusi. Kjo shkollë mendimi u zhvillua si kundërpërgjigje ndaj traditës liberale, të cilën mbështetësit e rrymës realiste do ta quanin idealizëm. (Goldstein, 2001).

Pas Luftës së Dytë Botërore, studiuesi Hans Morgenthau do të argumentonte, se politika e kombeve ushtrohet përmes ligjeve objektive, të cilat në plan të parë kanë interesin e tyre kombëtar, e shprehur ndryshe, fuqia për të ushtruar dhe mbrojtur interesat e shtetasve dhe kombit të tyre. Po ashtu, realistët, ideologjitë apo aspekte, si besimi fetar apo faktorët kulturorë, nuk i konsiderojnë përpara fuqisë politike dhe ushtarake që ka një komb. (Goldstein, 2001).

Realistët e trajtojnë fuqinë politike të veçuar nga morali dhe, sigurisht, i japin rëndësi shumë më të madhe aspektit të forcës ndikuese që ka një shtet. Në këtë kontekst, kjo teori e përzgjedhur i përgjigjet temës së studimit, pyetjes kërkimore dhe hipotezës së ngritur, ku forca/fuqia e shteteve të marra në analizë dhe interesat e tyre kryesore, ekonomike dhe politike, janë vendimtare në përcaktimin e kursit dhe vendosjen e balancave gjeopolitike në rajonin e Ballkanit Perëndimor, por dhe përtej tij.

Realistët idetë e tyre i përmbledhin në tri aspekte:

1. Shtetet janë aktorët më të rëndësishëm.
2. Shtetet veprojnë si individë të arsyeshëm në realizimin e interesave kombëtare.
3. Shtetet veprojnë në kushtet e një sistemi ndërkombëtar që nuk ka një qeveri qendrore.

Koncepti i fuqisë ka një rëndësi të dorës së parë për shkollën realiste, megjithëse është vështirë për ta përkufizuar apo matur atë. (Goldstein, 2001). Fuqia përkufizohet si aftësia që ka një aktor (shtet) të detyrojë një tjetër aktor të bëjë atë që në kushte të tjera nuk do ta kishte bërë. Pra, fuqia përkufizohet ndryshe si ndikim. Fuqia ushtarake dhe sanksionet ekonomike janë disa nga mjetet më të shpeshta që përdorin shtetet për të ndikuar tek të tjerët. P.sh.: Fuqia ushtarake e NATO-s në vitin 1999 e detyroi Serbinë të tërhiqej ushtarakisht prej Kosovës. Sipas shkollës realiste, disa nga treguesit e fuqisë së një shteti, janë: Burimet e tij natyrore, ku përfshihen (popullsia, gjeografia dhe pasuritë natyrore); Burimet e matshme, ku përfshihen (GDP-ja, niveli i zhvillimit teknologjik dhe industrial); Burime të pamatshme, ku përfshihen (imazhi kombëtar dhe ndërkombëtar, mbështetja publike dhe cilësitë / aftësitë e kryetarit të shtetit); Fuqia e shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare, e cila ushtrohet nëpërmjet:

- a) Mjeteve diplomatike (aftësia negociuese e shtetit)
- b) Mjeteve ekonomike (aftësia për të vendosur sanksione)
- c) Mjeteve ushtarake (aftësia imponuese e shtetit). (Goldstein, 2001).

Prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, debatet rreth lidhjes midis luftës dhe shtetit midis shkencëtarëve politikë në Shtetet e Bashkuara kanë qenë të mbizotëruara nga realizmi. Në gjirin e alternativave të *realizmit* ka qenë *liberalizmi* (duke përfshirë atë që quhet institucionalizim i parëndësishëm) dhe *konstruktivizmi*. (Fierke, 2007).

Versioni i kohëve të fundit të *realizmit*, që ka marrë vëmendje të konsiderueshme, është *realizmi sulmues*, propozuesi kryesor i të cilit është John Mearsheimer. Teza kryesore e *realizmit sulmues* është, se edhe shtetet që duan vetëm të jenë të sigurt veprojnë në mënyrë agresive, sepse ato i detyron sistemi ndërkombëtar për ta bërë një gjë të tillë. Pra, politika ndërkombëtare ka qenë gjithmonë e pamëshirshme dhe e rrezikshme, madje ka të ngjarë që të mbetet përherë e tillë. Premisat kryesore përfshijnë:

- mungesën e një qeverisjeje botërore;
- aftësinë e çdo shteti për të përdorur forcën kundër shteteve të tjera;

- mungesën e sigurisë së çdo shteti, se një shtet tjetër nuk do të përdorë forcën kundër tij, etj.

“Gjithashtu, të gjitha shtetet konsiderohen aktorë të arsyeshëm, të cilët kërkojnë të ruajnë integritetin e tyre territorial dhe autonominë e brendshme”. (Goldstein, 2001).

Megjithëkëtë, asnjë prej këtyre supozimeve nuk dikton se Fuqitë e Mëdha, si rregull i përgjithshëm, duhet të sillen në mënyrë agresive ndaj njëra-tjetrës. Pra, për shkak të këtyre karakteristikave të politikës ndërkombëtare deduktohet, se, në përgjithësi, shtetet kanë fare pak mundësi zgjedhjeje, përveçse të ndjekin pushtetin dhe të kërkojnë të dominojnë shtetet e tjera në sistem. Pra, dy shtete mund të shkojnë në luftë me njëri-tjetrin, edhe pse që të dy nuk duan gjë tjetër veçse të mbijetojnë.

Realizmi mbrojtës, nënndarje e realizmit, thekson, se shtetet duan vetëm të mbrojnë status quo-në, por nuk janë të interesuara për zgjerim agresiv. Waltz argumenton, se, edhe në qoftë se ata do të ishin të prirur të zgjeroheshin, tiparet e sistemit ndërkombëtar që Mearsheimer përshkruan, do t'i pengonte të arrinin këtë synim. (Waltz, 1979). Në të vërtetë, shqetësimi kryesor i shteteve nuk është të maksimizojnë fuqinë, por të ruajnë pozicionet e tyre në sistem. *“Shtetet e mesme, nëse janë të lirë të zgjedhin, bëjnë aleancë me anën më të dobët, sepse ajo që i kërcënon është pala më e fortë”.* (Waltz 1979).

Parimet realiste të Morgenthaut (1948) e vënë theksin mbi pushtetin përkundrejt moralit. Parimi i parë i Morgenthaut e vë theksin mbi *objektivitetin* dhe *racionalitetin*, duke vënë në dukje se politika, sikundër shoqëria, udhëhiqet nga parime objektive të cilat burojnë nga natyra njerëzore. Nga ana tjetër, ai thekson përfshirjen e proceseve irracionale në këtë vendimmarrje racionale, si në rastin e përdorimit të logjikës racionale për të përkrahur vendime, që, në thelb, nisen nga impulse irracionale.

Parimi tjetër lidhet me *konceptin e interesit*, i cili përkufizohet në terma pushteti, pra *realizmi* e studion politikën ndërkombëtare në *terma pushteti*, gjë që, për hir të së vërtetës, përcaktohet si monedha e diplomacisë. Pra, pushteti shërben si mjet, por edhe si qëllim në vetvete. Është mjet për të realizuar interesat e ndryshme të shteteve, por njëkohësisht qëllim sepse shtetet janë të pasigurta për qëllimet e shteteve të tjera, sidomos për sa i përket mbijetesës së tyre. Koncepti i pushtetit është koncept qendror në teorinë realiste. Gjithsesi, Morgenthau arrin ta përfshijë konceptin e moralit në diskutimin e pushtetit, duke theksuar se

shtetet nuk angazhohen gjithmonë në veprime të cilat maksimizojnë pushtetin e tyre. Ky është rasti, kur vendime të caktuara bien ndesh me parimet morale, parime të cilat shkelen vetëm në rastin kur vendimmarrja bëhet çështje mbijetese. Sipas Morgenthaut, në këtë rast mbijetesa e shtetit i mbivendoset moralit. Pra, teoria realiste e Morgenthaut e sheh raportin mes shteteve jo vetëm si luftë për pushtet, por gjithashtu si orvatje drejt një lidheshipi të moralshëm. Pra, shtetet veprojnë në mënyrë racionale në përpjekje për të maksimizuar pushtetin, por nga ana tjetër vendimet e tyre kufizohen nga ligjet ndërkombëtare, parimi moral ndërkombëtar apo opinionin publik. Dy parimet e tjera të teorisë fokusohen mbi aplikimin e parimeve morale në vendimmarrjen e shteteve, sidomos për sa i përket kontekstualizimit, pra parimet universale duhet të aplikohen në kohë dhe vend të caktuar. (Crisol, 2009).

Fuqia ushtarake dhe aleancat konsiderohen si themelet e sigurisë. Probabiliteti që aleancat apo fuqia ushtarake ta parandalojnë konfliktin, është i njëjtë me probabilitetin që ato ta provokojnë atë. Sipas Morgenthaut, balanca e fuqive është një fenomen i përgjithshëm social, i cili lind spontanisht kur shtetet apo grupet përpiqen të vetëmbrohen. Balancimi i fuqive mund të parandalojë luftën, por ekziston edhe mundësia që të rrisë gjasat për konflikt, meqenëse vlerësimi i motiveve, kapaciteteve apo vendosmërisë së shteteve të tjera nuk mund të jetë absolutisht i sigurt. Çdo shtet vepron me qëllimin e maksimizimit të sigurisë, mirëpo tensionet bëhen të papërballueshme nëse në këtë proces angazhohen shtete të shumta në të njëjtën kohë, duke nxitur në këtë mënyrë tensione ndërkombëtare në rritje. Si rrjedhojë, nëse fuqitë e reja perceptojnë se janë në avantazh, mund të shkojnë në luftë, ndërkohë që fuqitë ekzistuese mund të nisin luftëra me qëllime “parandaluese”. (Lebov, 2007).

Pra, balancimi i fuqive mund të dështojë në parandalimin e luftërave, gjithsesi Morgenthau argumenton se të paktën ai vepron në kufizimin e dëmeve dhe garantimin e ekzistencës së shteteve, qofshin këto të mëdha apo të vogla. Në këtë mënyrë, balancimi i fuqive shihet në funksion të ekzistencës dhe fuqisë së shoqërisë ndërkombëtare, duke kufizuar aktorët më të mëdhenj të sistemit. Pikërisht dobësimi i strukturës shoqërore të sistemit ndërkombëtar në shekullit XX, identifikohet si një prej faktorëve më me ndikim në dy luftërat botërore.

Në mungesë të kësaj strukture, aleancat dhe kapacitetet ushtarake mund të shkaktonin pikërisht ato luftëra që synonin të parandalonin dhe nuk përbënin asnjë lloj garancie për siguri.

KAPITULLI III: Politika e Jashtme e Shqipërisë dhe Doktrinat (Turke-Ruse-Kineze)

3.1. Politika e jashtme dhe diplomacia shqiptare

Hyrje

Për një kohë të gjatë, shqiptarët kanë vuajtur sistemin komunist, i cili do t'i privonte shtetasit e saj nga liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Vendi ynë mbeti i izoluar nga bota për plot 45-vjet, nën perden e hekurt. (Human Rights Watch, 1996).

Kjo qasje e nomenklaturës komuniste do të sillte pasoja tepër të rënda brenda dhe jashtë vendit. Në aspektin e brendshëm, në fund të viteve '80-të, ekonomia vendase do të binte në kolaps nga pamundësia për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave bazike të shtetasve të saj. Nga ana tjetër, në aspektin politik dhe të ndërveprimit me vendet e tjera, Shqipëria mbeti e izoluar si asnjë vend tjetër në këtë rajon, pa asnjë komunikim apo marrëdhënie shtetërore me vendet e tjera, sikundër dhe me organizmat e huaja ndërkombëtare. Pasojat e këtij izolimi, dhe tejkalimi i tyre, do të shndërroheshin në sfidat më të mëdha të qeverive të mëpasshme, të cilat pasuan leadershipin e fundit komunist, në fund të viteve '80-të dhe fillim të viteve '90-të. (The Balkanista, 2018).

Kalimi i stafetës dhe ndryshimet e sistemit politik në Shqipëri, do ta vendosnin vendin përpara disa përgjegjësive krejt të reja në diplomaci dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Shqipëria, nga një vend i izoluar totalisht nga bota dhe zhvillimet ndërkombëtare, tanimë, si në shumë fusha, edhe në atë të politikës së jashtme dhe diplomacisë, do t'i duhej t'i përshtatej nivelit të përgjegjësive që i takonin si aktor i rifutur në skenën ndërkombëtare, kryesisht në këto dimensione:

- a) Në raport me fqinjët, si aktor rajonal dhe përfaqësues i drejtpërdrejtë, në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të shqiptarëve jashtë kufijve shtetërorë (Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Luginën e Preshevës).
- b) Në raport me aktorët evropianë dhe ata globalë, si vendet e Evropës Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kinës, Rosisë, etj.
- c) Në raport me organizmat ndërkombëtare prestigjioze, si: NATO, OSBE, FMN, OBT, etj. (Montgomery, 1991).

Në këto rrethana, riangazhimi i Shqipërisë në politikën e jashtme dhe diplomaci do të përbënte një sfidë të vështirë, por të rëndësishme për vendin, pasi avancimi i kësaj agjende do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë për normalizimin dhe demokratizimin e jetës dhe veprimtarisë së saj ekonomike, politike, diplomatike dhe kulturore. Dy dekadat e para postkomuniste, të diplomacisë dhe politikës së jashtme të Shqipërisë, kanë qenë fazat e hapjes dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të “kalibruar” orientimin e saj gjeopolitik, sigurisht duke pasur në vëmendje aspiratat, interesat kombëtare dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Shqipëria do të rilidhte marrëdhëniet e saj me shumë vende evropiane dhe përtej Atlantikut, si dhe me organizata ndërkombëtare, të cilat do të kontribuonin në forcimin e institucioneve dhe konsolidimin e tyre, si dhe vijimin e reformave të thella strukturore që do të çonin në modernizimin e vendit. (Misha, 2015).

Në dekadën e tretë, postkomuniste, interesat e diplomacisë shqiptare dhe orientimi i politikës së saj të jashtme, do të bëhej edhe më i qartë në favor të agjendës euroatlantike (North Atlantic Treaty Organization: Official Website, 2014).

- a) Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, në vitin 2009,
- b) Kërkesa bërë Brukselit, nga ana e Shqipërisë, për marrjen e statusit të vendit kandidat për në BE (2009) (European Commission, 2020),

Këto dy momente, do të konfirmonin pa asnjë ekuivok orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë. Me ardhjen e qeverisë socialiste në pushtet, në vitin 2013, diplomacia dhe politika e jashtme shqiptare do të kishte një qasje të re, edhe më vitale, për çështjet e vjetra dhe ato të mbetura pezull. Po ashtu, kemi një rikonfirmim të vazhdimësisë së rrugës euroatlantike të Shqipërisë dhe zgjerimin e ndërveprimit diplomatik dhe rritjen e bashkëpunimit me fqinjët, duke ulur tensionet dhe rritur rolin e diplomacisë (jo vetëm politike), duke zgjeruar gamën e ndërveprimit ndërinstitucional, por edhe të bashkëpunimit bilateral e multilateral me vendet e tjera.

Mbështetja e vazhdueshme e Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian kanë qenë domethënëse në tejkalimin e shumë proceseve të vështira demokratizuese dhe konsolidimin e shtetit dhe institucioneve shqiptare.

Anëtarësimi me të drejta të plota në Bashkimin Evropian dhe forcimi i miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës përbëjnë një prioritet kombëtar dhe një angazhim të pakontestueshëm të të gjitha palëve politike në vend, pavarësisht kaheve apo ideologjive politike që ato përfaqësojnë.

Akset më të rëndësishme të politikës së jashtme të shtetit shqiptar dhe përfaqësimi i saj në botë përfshijnë:

1) *Partneritetin Strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Aleancën e Atlantikut të Veriut (NATO).*

Deklarata e përbashkët për partneritet strategjik mes Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do të firmosej në prill të vitit 2015 nga Ministri i Punëve të Jashtme z. Ditmir Bushati dhe Znj. Victoria Nuland, Ndihmës Sekretarja e Shtetit për Europën dhe Euroazinë. Ky dokument ishte i një rëndësie të veçantë për Shqipërinë, pasi dëshmon në mënyrë të qartë, orientimin gjeostrategjik properëndimor të saj, dhe bashkëpunimin si aleate e ngushtë përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në këtë dokument të përbashkët strategjik, është shprehur angazhimi dyanshëm në këto dimensione:

- a) Partneritetet për çështjet rajonale,
- b) Partneritetet për çështjet globale
- c) Partneritetet për agjenden dypalëshe, SHBA – Shqipëri, që konsiston në forcimin e shtetit të së drejtës, dialogun politik, zhvillimin ekonomik, sigurinë energjetike dhe shkëmbimet në arsim dhe kulturë.

Nëpërmjet këtij dokumenti strategjik të posaçëm, Shqipëria jo vetëm që forcoi pozitën e saj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po në të njëjtën kohë, u pozicionua si një aleat i besueshëm në sytë e partnerëve evropianë dhe arenën ndërkombetare në tërësi, (Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës: Faqja Zyrtare, 2020).

Nga ana tjetër, bashkëpunimi i ngushtë dhe partneriteti strategjik me Aleancën e Atlantikut të Veriut (NATO-n), pjesmarrja në misione të përbashkëta në kuadër të luftës së kësaj aleance me terrorizimin në mbarë botën e bëjnë Shqipërinë një vend luajal ndaj detyrimeve të saj në raport me vendet e tjera anëtare në këtë aleancë dhe misionit të saj. (Ministria e Mbrojtjes: faqja zyrtare, 2020)

2) *Partneritet Strategjik me Bashkimin Evropian dhe përshpejtim të proceseve integruese deri në anëtarësim të plotë në BE;*

Është e qartë se, integrimi në Bashkimin Evropian ka qenë një prioritet i Shqipërisë postkomuniste dhe është artikuluar si i tillë nga çdo qeveri që ka qeverisur vendin në këto 30 vitet e fundit. Politika e jashtme e Shqipërisë, vazhdimisht është artikuluar nëpërmjet dokumenteve dhe strategjive të hartuara për realizimin e këtij objekti të rëndësishëm kombëtar.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020, përbën dokumentin kryesor kombëtar, të politikës së jashtme të Shqipërisë që parashikon zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, si dhe përmbushjen e kërkesave të integritit evropian. Kjo strategji është e përbërë nga gjashtë prioritet:

- a) Integrimi Evropian,
- b) Mirëqeverisja, demokracia dhe sundimi i ligjit,
- c) Stabiliteti makroekonomik dhe fiskal,
- d) Rritja e konkurrencës,
- e) Zhvillimi njerëzor dhe kohezoni social (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020)

2.1) *Procesi i Berlinit - Strategjia Gjermane për Përshpejtimin e procesit të Integritit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.*

Shqipëria u bë pjesë e kësaj Konference të Nivelit të Lartë për Ballkanin Perëndimor, së bashku me vendet e tjera të rajonit, aspirante për t'iu bashkuar Bashkimit Evropian, Procesi i Berlinit ishte një projekt Gjerman, me një agjendë të qartë, në përshpejtimin e proceseve integruese të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Ky objektivi, do të arrihej nëpërmjet afrimit të vendeve të rajonit me njëri tjetrin, dhe investimeve strategjike, kryesisht në projektet infrastrukturore të rajonit duke përdorur programet aktuale të financimit të Bashkimit Evropian (Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim/Shteti Web,2015)

3) *Bashkëpunimi rajonal nëpërmjet diplomacisë ekonomike*

Kjo qasje, midis Shqipërisë dhe vendeve të rajonit, do të arrihej nëpërmjet vijimësisë së Procesit të Berlinit, duke rritur më tej kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor ndaj sfidave të përbashkëta rajonale.

4) *Bashkëpunimi Strategjik me Kosovën*

Dy Kryeministrat respektivë, ai i Republikës së Shqipërisë, Z. Edi Rama dhe Kryeministri i Republikës së Kosovës, Z. Hashim Thaçi, do të firmosnin në vitin 2014 në Prizren të Kosovës, Deklaratën e përbashkët për Bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik midis Shqipërisë dhe Kosovës, në fushat e mëposhtme:

- a) Politikën e jashtme dhe të sigurisë,
- b) Drejtësisë dhe çështjet e brendshme,
- c) Ekonomi, energji, transport, turizëm dhe mbrojtjen e mjedisit,
- d) Kulturë, arsim dhe shkencë (Deklaratë e përbashkët për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2014)

Përkundër qendrimeve shpresëdhënëse të qeverive, kohë pas kohe, Shqipërisë i mbetet shumë punë për të bërë në rrugën e saj të integrimit në Bashkimin Evropian, duke u përballur vazhdimisht me pengesa në arritjen e progresit thelbësor. Megjithëse mbështetja popullore për rrugën e vendit drejt integrimit në Bashkimin Evropian mbetet unanime, pritshmëritë rreth kohës së anëtarësimit po bëhen më të zbehta. Nga ana tjetër, këtyre perspektivave i janë bashkëngjitur dhe problemet e brendshme të Evropës me “Brexit”, përpjekjet për rimëkëmbjen ekonomike, kërcënimi në rritje të ekstremizmit të dhunshëm fetar dhe shenjat e autoritarizmit midis vendeve anëtarëve të saj. Nga gjashtë çështjet kryesore të identifikuara gjatë Forumit Ekonomik Botëror në Davos në vitin 2017, ekonomia dhe siguria janë çështjet më të mprehta. Në kontekstin e ndryshimeve të vazhdueshme të fuqive globale të pushtetit, edhe Shqipëria nuk ka mbetur e izoluar nga ky debat. Pjesë e diskursit publik janë dhe kërcënimet në rritje të radikalizmit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm, i cili ka nxitur një debat të gjerë rreth tolerancës fetare në vend dhe ndikimit të vendeve kryesisht myslimane në Shqipëri (Vurmo, Lamallari, Papa & Dhëmbo, 2015).

Megjithë luhatjet e vazhdueshme, me dinamikat në politikën e brendshme, zhvillimet gjeopolitike rajonale dhe influencat e vendeve joperëndimore, Shqipëria vazhdon të mbetet e orientuar në kursin properëndimor të saj, përkrah partnerëve të saj strategjikë, Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

3.2 Prezenca dhe roli i BE-së në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor

“E duam Shqipërinë si gjithë Europa” - kjo ishte shprehja simbol dhe më kuptimplote e fillim viteve '90-të, për Shqipërinë dhe shqiptarët që vuajtën sistemin komunist 45-vjeçar.

Rënia e Murit të Berlinit, në vitin 1989, ishte “parathënie” për atë që do të ndodhte më pas në tërë Evropën Lindore dhe Juglindore. Vetë lideri komunist, Ramiz Alia, duke parë zhvillimet dramatike të rënies së republikave komuniste njëra pas tjetrës, i vetëdijshëm për atë që do të ndodhte, në 1 maj 1990, do të deklaronte nga Korça, se: “Demokratizimi i vendit është një proces i pakthyeshëm”. (Lory, 2007). Pikërisht rënia e këtij sistemi diktatorial në Shqipëri, do ta vendoste Qeverinë e re postkomuniste, të dalë nga zgjedhjet e lira e demokratike të vitit 1992, përballë sfidave të shumta dhe të gjithanshme.

Së pari, tejkalimi i vështirësive ekonomike dhe politike, si dhe “mbushja” e boshllëkut të lënë nga shembja e regjimit komunist.

Së dyti, krijimi i kushteve për fillimin e transformimit tërësor, politik ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Së treti, rivendosja e marrëdhënieve diplomatike me botën demokratike, pra hapja e kufijve të “çimentuar” nga shteti komunist.

Për Shqipërinë, sfida të atilla nuk kanë qenë aspak të lehta, por më e rëndësishmja ishte ajo që kishte të bënte me faktin që elita politike e kohës, dalë pas zgjedhjeve të para pluraliste, kishte kuptuar diçka shumë të rëndësishme, që për Shqipërinë nuk mund të kishte kthim pas. E ardhmja e Shqipërisë dhe shqiptarëve ishte Perëndimi (si koncept politik, ekonomik dhe kulturor), njëherazi dhe rivendosja e menjëhershme e marrëdhënieve diplomatike me Evropën dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (aq shumë të mohuara gjatë regjimit), të cilët ofruan menjëherë mbështetjen e tyre për Shqipërinë.

Viti 1991 do të sillte zhvillime tejet të rëndësishme për Shqipërinë, sa i përket marrëdhënieve ndërkombëtare dhe hapjes së saj me vendet e tjera.

1. Shqipëria rivendosi marrëdhëniet diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në mars 1991. Në Qershor të po këtij viti, Shqipërinë e vizitoi Sekretari Amerikan i Shtetit.
2. Shqipëria vendosi marrëdhëniet diplomatike me kancelaritë e vendeve evropiane, pasuar nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit në vitin 1992 me Këshillin Ekonomik të kohës (BE-ja e sotme) (European Commission, 1992).

Marrëdhëniet e Shqipërisë drejt integritit do të vijonin më tej me një sërë angazhimesh të rëndësishme me institucione dhe organizma ndërkombëtare, si Këshilli i Evropës, ku Shqipëria bëhet anëtare me të drejta të plota në vitin 1995 (Saracini, 2019).

Viti 2003 do të ishte një moment i rëndësishëm për Shqipërinë dhe vendet e tjera aspiruese për t'iu bashkuar BE-së. Bashkimi Evropian, në kuadër të politikës së zgjerimit të saj, vendosi të hapë dyert për vendet e Ballkanit Perëndimor, duke iniciuar Samitin e Selanikut (European Commission, 2003).

Në vitin 2006, do të firmosej (MSA) Marrëveshja e Stabilizim Asociimit midis Shqipërisë dhe BE-së. MSA ishte një gur kilometrik shumë i rëndësishëm për vazhdimësinë e proceseve integruese dhe thellimin e reformave jetike për vendin. (Council of the European Union, 2006).

Përkatësia evropiane dhe identifikimi i Shqipërisë dhe shqiptarëve, me vlerat perëndimore, ka qenë dhe mbetet “fanari ndriçues” jo vetëm në aspektin politik, por edhe në kuptimin e vlerave, kulturës dhe standardeve që ky kontinent përfaqëson për ne shqiptarët.

Integrimi në BE ka qenë një prioritet i Shqipërisë demokratike dhe është artikuluar si i tillë nga çdo qeveri shqiptare: e majtë apo e djathtë, që ka qeverisur vendin pas viteve '90-të. Programi i Partisë Socialiste, viti 2013, i kushton një kapitull: “Bashkimi me Evropën: Kthimi në familjen evropiane, të cilës i përkasim”. (Programi i Partisë Socialiste, 2013). Vizioni i Shqipërisë drejt BE-së është përdorur shumë nga të gjitha qeveritë. Kjo qasje shërben si një mjet për të apeluar me forcë qëndrimin pro-BE-së, një mënyrë kjo për të bindur vendet e Bashkimit Evropian për qëllimet serioze të qeverive për të ecur përpara në këtë proces. Kjo qasje, e mishëruar dhe ligjërish, mbahet si një nga strategjitë kryesore të zhvillimit të vendit, dhe përbën dokumentin kryesor kombëtar në raport me përmbushjen e kërkesave të procesit të integritit evropian. (Këshilli i Ministrave, 2016).

Shqipëria do të merrte statusin e vendit kandidat të Bashkimit Evropian vetëm në vitin 2014, një zhvillim i rëndësishëm që i shkurton rrugën drejt hapjes së plotë të negociatave me Bashkimin Evropian.

Ndërkohë që mbështetja unanime për rrugën e vendit drejt integritit në BE ka mbetur e tillë për shumë vite, por nivelet e mbështetjes dhe pritshmëritë rreth kohës së anëtarësimit po bëhen gjithnjë e më pak optimiste. (Top-Channel, 2019).

E megjithatë, angazhimi i Bashkimit Evropian në rajonin e Ballkanit Perëndimor mbetet domethënës për synimin e vendeve aspiruese. Prezenca e saj është shumëdimensionale. (Fraenkel, 2016).

Së pari, është aspekti politik.

Anëtarësimi i këtij “rajoni problematik” në Bashkimin Evropian do të jepte garanci për shuarjen e konflikteve, të cilat vijojnë të jenë një kërcënim për paqen dhe stabilitetin e rajonit dhe më gjerë. Ballkani Perëndimor përbëhet nga popuj, të cilët njihen më tepër për armiqësinë mes tyre, sesa miqësinë. Mjafton t’i referohemi 100 viteve të fundit, për të kuptuar se sa shumë konflikte ka prodhuar ky rajon, e sa shumë janë investuar popujt në armiqësi. Pikërisht prej ndasive, që vijnë si pasojë e diferencave etnike, kulturore e gjuhësore: shqiptarët me serbët, serbët me kroatët, boshnjakët me serbët, etj.

Kontinenti Evropian dhe Ballkani Perëndimor, në një hark kohor më pak se dhjetë vjet, ka përjetuar dy luftëra me përmasa katastrofike, që kanë përfunduar me masakra nga më çnjerëzoret, deri në gjenocid kundër njerëzimit. Lufta e Bosnjë-Hercegovinës (1995) dhe Lufta e Kosovës (1998), të dy këto konflikte të armatosura kanë lënë pas me dhjetëra mijëra viktima të civilëve të pafajshëm (Lockie & Rosen, 2019). Pikërisht nga mungesa e angazhimit të komunitetit ndërkombëtar në kohën e duhur.

Së dyti, është aspekti gjeopolitik.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, influencat e vendeve joperëndimore si Turqia, Rusia dhe Kina, janë tepër të pranishme, çka do të thotë se mungesa e një strategjie dhe vizioni integruës në terma afatgjatë të Ballkanit Perëndimor, do të çonte pashmangshmërisht në forcimin e rolit dhe ndikimit të këtyre vendeve joperëndimore, duke ia lënë “fushën” e lirë, të cilën, me siguri, ato do të dinë ta shfrytëzojnë maksimalisht.

Së treti, është aspekti ekonomik.

Popullsia dhe ekonomia e vendeve të Ballkanit Perëndimor është e lidhur pashmangshmërisht me ekonominë, ku tregjet e Ballkanit Perëndimor janë të lidhur ngushtë me tregjet e vendeve të Bashkimit Evropian. Kjo për shkak të afërsisë dhe komunikimit infrastrukturor midis tyre. (European Western Balkans, 2020).

Thënë ndryshe, janë të gjitha arsyet se pse mund dhe duhet që këtyre vendeve t’u jepet një shans për të qenë plotësisht pjesë e BE-së, me gjithë sfidat që ajo paraqet.

E kundërta, pra, vonesat, ngrirjet e proceseve integrale, do ta çonin rajonin në një udhëkryq, nga ku të gjithë do të kishin çfarë të humbnin.

3.3. Prezenca dhe roli i SHBA-së në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor

Prej themelimit të shtetit shqiptar, dhe përgjatë gjithë historisë së saj mbi 100-vjeçare, Shqipëria ka qenë e “dënuar” të bashkëjetojë midis “dy botëve”: Lindjes dhe Perëndimit, secila me ndikimin e saj, në formësimin e identitetit, gjuhës dhe kulturës së kombit tonë. Historia e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës është e hershme. Ajo daton në fillim të shekullit XX, me Konferencën e Paqes në Paris 1919. Presidenti Amerikan, Woodrow Willson, me qëndrimin që mbajti në këtë konferencë, do të kontribuonte në favor të çështjes shqiptare, aq shumë e domosdoshme për shtetin e ri dhe të brishtë shqiptar (shpallur i pavarur në nëntor 1912). Ky gjest do të shënonte miqësinë e përhershme midis dy vendeve. Mbështetja e SHBA-së në Konferencën e Paqes së Parisit ka ngelur një ngjarje e veçantë në historikun e marrëdhënieve shqiptaro - amerikane, nëse marrim në konsideratë kontekstin historik në të cilin ndodhej vendi ynë. Marrëdhëniet e para diplomatike midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë do të nisnin në vitin 1922, kohë kur presidenti amerikan, Warren Harding, emëroi Ambasador të SHBA-së në Tiranë, z. Ulysses Grant Smith. Falë marrëdhënieve të mira të krijuara midis dy vendeve, si dhe njëloj preference të SHBA-së ndaj vendit tonë, në periudhën 1922-1939, Shqipërinë do ta vizitonin me dhjetëra shtetas amerikanë, me interesa nga më të ndryshmet, kryesisht diplomatë, njerëz nga bota e arsimit (përmendim themelimin e shkollës teknike “Harry Fultz” 1922), biznesmenë me interesa në eksplorimin burimeve natyrore të nëntokës. Marrëdhëniet diplomatike SHBA - Shqipëri do të ndërpriteshin në vitin 1939, në periudhën kur Shqipëria do të pushtohej ushtarakisht nga Italia fashiste, për të rinisur 52 vjet më pas, fill pas përmbysjes së regjimit komunist në Shqipëri, në vitin 1991. (Kulla, 2019).

Menjëherë pas emërimit të ambasadorit amerikan në Shqipëri, z. William Rajerson, në mars 1991, disa muaj më vonë Shqipërinë do ta vizitonte Sekretari i Shtetit Amerikan, James Baker, i cili do të pritej në mënyrë madhështore nga shqiptarët. Vizita e Sekretarit të Shtetit Amerikan do të hapte siparin e një marrëdhënieje të re midis dy shteteve përkatëse. (Sly,1991). Vendin tonë e kanë vizituar 5 sekretarë shteti të SHBA-së, por pikën e tyre kulmore marrëdhëniet shqiptaro - amerikane e kanë pasur me vizitën e Presidentit të SHBA-së, George W. Bush, në vitin 2007. Një vizitë e cilësuar historike për popullin shqiptar dhe

aspiratat e tij euroatlantike. (Voice of America, 2009). Ndër të tjera, kjo vizitë do të mbahet mend për dy mesazhe tejet të rëndësishme të Presidentit të Shteteve të Bashkuara. Mesazhi i parë kishte të bënte me rrugëtimin e Shqipërisë për t'u bërë anëtare e NATO-s, ku Presidenti Amerikan do të konfirmonte mbështetjen e plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për këtë aspiratë të shqiptarëve. Pas dy vitesh, në prill të vitit 2009, Shqipëria do të bëhej anëtare me të drejta të plota e Aleancës Politiko-Ushtarake më të fuqishme të kohës - NATO, falë mbështetjes dhe vizionit të SHBA-së, për konfigurimin gjeopolitik të rajonit të Ballkanit Perëndimor (Associated Press, 2009). Anëtarësimi i plotë i Shqipërisë në këtë aleancë do të paraprihej nga një sërë angazhimesh ndërkombëtare të nivelit të lartë, të iniciuara dhe të mbështetura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për këtë rajon. Nisma e “Kartës së Adriatikut”, nënshkruar në Tiranë, në vitin 2003, nga tri shtetet aspiruese për t'u anëtarësuar në Aleancën e Atlantikut të Veriut (NATO): Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë së Veriut, ishte pjesë e vizionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Aleancës së Atlantikut të Veriut për integrimin politiko-ushtarak të këtyre vendeve dhe Ballkanit Perëndimor në tërësi (Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, 2019).

Mesazhi i dytë i rëndësishëm i presidentit George W. Bush, lidhej me përcaktimin e statusit final të Kosovës, ku Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nga Tirana do të deklaronte, se Pavarësia e Kosovës së shpejti do të ishte një realitet i pamohueshëm. Një vit më vonë, më 17 shkurt 2008, Kosova me mbështetjen e jashtëzakonshme të SHBA-së dhe shumicës së vendeve më të fuqishme të Bashkimit Evropian, shpalli Pavarësinë nga Serbia, shteti nga i cili kish qenë i okupuar prej gati një shekulli. (Deutsche Welle, 2007)

Mbështetja e SHBA-së për Shqipërinë dhe rajonin ka qenë e vazhdueshme në sfidat integruese të saj. SHBA-ja ka investuar në terma burimorë dhe kohorë në rajon; ndërhyrjet ushtarake si ajo në Kosovë, janë një shembull ilustrues (Bandow, 1999). Por, e gjithë çështja qëndron se cilat janë interesat e vërteta të SHBA-së në Ballkanin Perëndimor? Përse ky investim? (Daalder, 2002). SHBA-ja është një shtet multietnik, i cili bazohet mbi vlera të qëndrueshme demokratike, ndërsa shumica e vendeve të Bashkimit Evropian, në të kaluarën, kanë pasur konflikte historike me njëra-tjetrën për shkak të ideologjive të kundërta. Mbështetësit e modelit multietnik të SHBA-së, mendojnë se ky model mund të funksionojë

në vende ku larmia etnike dhe konfliktet që lindin nga ky faktor janë të pranueshme. Vendet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë qenë kurrë një spektër i vetëm, përveç periudhës otomane, kur morën edhe emrat përkatës. Në terma etnikë dhe kulturorë, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë pasur gjithmonë një pangjashmëri të madhe, krahasuar me vendet e tjera të Evropës Veriore, Qendrore apo dhe Perëndimore. Rajoni i Ballkanit Perëndimor, duke qëndruar për shekuj me radhë jashtë zhvillimeve kulturore, ekonomike dhe politike të Evropës, nuk ka arritur të sinkronizojë proceset shtet-formuese, megjithëse luftërat për arritjen e pavarësisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe përcaktimi i kufijve të tyre, janë monitoruar ngushtësisht nga Evropa Perëndimore. (Veremis, 2001).

Nga ana tjetër, interesi i SHBA-së në Ballkanin Perëndimor vazhdon të mbetet real, sidomos për sa i përket ruajtjes së paqes dhe stabilitetit të saj. (Bieber, 2019). Përfshirja e SHBA-së do të ndryshojë në varësi të zhvillimeve në këtë rajon, sjellim në vëmendje rolin e SHBA-së në situata konflikti në (Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë, Serbi).

Për SHBA-në, roli si arbitër në Ballkanin Perëndimor ka qenë një eksperiencë relativisht e re. Deri vonë, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk janë konsideruar si aset strategjik, përkundrazi janë parë më së shumti si shkaktare të problemeve dhe, hera-herës, si destabilizuese në kontinentin evropian. Ende ka shumë pikëpyetje në lidhje me faktin, nëse ndërhyrjet e SHBA-së në Ballkanin Perëndimor kanë qenë të bazuara në parime: për shembull, mbrojtja e më të dobët në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë, apo kanë qenë të ndikuara nga faktorë të tjerë. P.sh., raportet e vendeve të Perëndimit me botën islame, apo raportin e Turqisë me Evropën (Graham et al., 2018). Rasti i Kosovës, nga ana tjetër, paraqet një shembull se si agjenda shumetnike dhe shumëkulturore e SHBA-së është ndalur. Në luftën etnike të territoreve, nga ana tjetër, NATO është pozicionuar në favor të njëres palë mbi palën tjetër, gjë që do të rezultojë shumë shpejt në një shtet etnikisht të pastër, larg ëndrrës së bashkëjetesës shumetnike dhe shumëkulturore. Kritikët pragmatistë mendojnë se SHBA-ja nuk ka interes tjetër në këtë rajon, përveç se ruajtjen e besueshmërisë si fuqi globale. Në të vërtetë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i dedikohen multikulturalizmit, ajo ngelet një shoqëri shumetnike me një kulturë të vetme politike. Ndërhyrjet e SHBA-së në Ballkan çuan

në krijimin e protektorateve etnikisht të pastra, në vend të federatave demokratike shumetnike. (Graham, Levitsky, Munter, Wisner, 2018).

Nëse krahasojmë prezencën ekonomike dhe ushtarake në lidhje me kontributet e Shteteve të Bashkuara dhe Evropës në Ballkanin Perëndimor gjatë dekadës së fundit, dallohet qartë se Evropa ka marrë përsipër një pjesë të madhe të ngarkesës. Në dimensionin ekonomik (si ndihma humanitare apo financiare), Evropa e bashkuar e ka tejkaluar tri herë kontributin që Shtetet e Bashkuara kanë investuar në këtë rajon. Bashkimi Evropian mbarti pjesën më të madhe të barrës ushtarake në fillim të viteve '90-të, sikundër është rasti edhe në ditët e sotme. P.sh., nëse i referohemi krizës humanitare të Kosovës në vitet 1999-2000, Bashkimi Evropian ishte donatori më i madh për Kosovën, duke siguruar më shumë se 3 miliardë dollarë për programet humanitare, krahasuar këto me 900 milionë dollarë nga Shtetet e Bashkuara për të njëjtën periudhë. (Daalder, 2002). Duhet theksuar, se ajo që ndodh në Evropën Juglindore ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë me interes parësor për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Daalder sugjeron 3 komponentë të rëndësishëm, në lidhje me politikat e SHBA-së në Ballkan:

1. Angazhimi,
2. Ndarja e përgjegjësisë me Evropën,
3. Fleksibiliteti,

Së pari, për aq kohë sa Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë një interes themelor për paqen dhe stabilitetin e Evropës, është logjike që do të mbeten të përfshirë në ato raste ku këto dy elemente janë të kërcënuara (European External Action Service, 2017). Pra, nëse NATO mbetet e përfshirë në rajon, po ashtu duhet të jenë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me potencialin e saj ushtarak. Së dyti, angazhimi ushtarak i NATO-s duhet të përputhet me kushtet për zhvillimin e këtij rajoni. Nga ana tjetër, realiteti politik dikton që Evropa duhet të ketë një rol më domethënës në këtë rajon, për shkak të faktorëve që e favorizojnë në raport me SHBA-në, gjë që e ka bërë më së shumti në fushën ekonomike dhe atë ushtarake, ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të vazhdojnë të përmbushin pjesën e tyre, edhe për

faktin se ajo gëzon një shkallë më të lartë besimi, sidomos falë strategjive efektive dhe koherente diplomatike, nëse e krahasojmë me qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Si konkluzion, Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbeten ende një aktor global i dorës së parë, angazhimi i tyre është domethënës në të gjitha rajonet ku ata kanë shprehur interes strategjik, sidomos për Ballkanin Perëndimor, në të cilin kanë kontribuar dhe do të vazhdojnë të kontribuojnë për paqen dhe prosperitetin e këtij rajoni kaq delikat, kjo, falë strategjisë dhe vizionit afatgjatë të lidërshipt të kombit dhe qeverisë amerikane në vazhdimësi. Për faktorin shqiptar në këtë rajon, Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e zi, është një mundësi e shkëlqyer që partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe këtë “momentum” historik bashkëpunimi dhe mbështetjeje nga SHBA-ja, ta kthejnë në favor të zgjidhjes së çështjeve të tyre të mprehta, si dhe integritit të plotë të shqiptarëve në të gjitha trojet ku ata jetojnë. (Ambasada Shqiptare në SHBA, 2015). Statusi i të cilit ngelet të përcaktohet nga vizioni i lidërshipt shqiptar në këto troje, për mos ta humbur këtë shans historik, që, shqiptarët, si komb autokton dhe kontribuues për paqen dhe stabilitetin në rajon, të zënë vendin që meritojnë.

3.4 Doktrina e Turqisë në Ballkanin Perëndimor dhe prezenca në Shqipëri

Ballkani Perëndimor nuk është një rajon i panjohur për Turqinë e sotme apo ish-Perandorinë Osmane, përkundrazi ajo ka një histori të gjatë dhe komplekse me këto vende. Pavarësisht të kaluarës së trazuar, diplomacia turke, në mënyrë konstante, ka shfaqur parimet thelbësore të politikës së jashtme në tërësi dhe, veçanërisht, për këtë rajon, nëpërmjet doktrinës së ish-ministrit të saj të jashtëm, Ahmet Davutoglu, në veprën e tij: “Thellësia Strategjike”. (Davutoglu, 2001). Nëpërmjet kësaj doktrine synohet rikthimi i lavdisë së dikurshme të ish-Perandorisë Osmane dhe shndërrimi i Turqisë në një fuqi domethënëse në rajon dhe më gjerë. Turqia fuqinë e saj e bazon tek lidhjet historike me Perëndimin dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pa lënë mënjanë partneritetet me vendet e Lindjes së Mesme. Qasja agresive e Turqisë në politikën e jashtme gjatë dy dekadave të fundit është diskutuar gjerësisht brenda dhe jashtë Turqisë, pikërisht për shkak të interesave gjeopolitike që ajo synon të realizojë nëpërmjet kursit të ri në politikën e jashtme dhe, veçanërisht, në rajonin e Ballkanit Perëndimor. (Ataman, 2008). Aktorë dhe faktorë të ndryshëm të zhvillimeve gjeopolitike po përpiqen të kuptojnë, se çfarë po kërkon të bëjë Turqia në Ballkanin Perëndimor. Meqenëse investimet turke tashmë janë më aktive në këtë rajon, është e pritshme që bota e biznesit turk ta rrisë akoma më tepër prezencën e saj ekonomike gjatë viteve të ardhshme. (Brljavac, 2011). Duke parë intensitetin e shkëmbimeve ekonomike, Turqia gjithnjë e më tepër po perceptohet si një fuqi rajonale ekspansioniste jo vetëm në terma ekonomike, por dhe politike, megjithëse në aspektin e politikës së jashtme ajo për një kohë të gjatë është orientuar nga doktrina e Ahmet Davutoglus: “Thellësia Strategjike” e njohur ndryshe si agjenda Neo-Otomane. (Aral, 2001).

Nga ana tjetër, Turqia nuk i ka anashkaluar marrëdhëniet me vendet arabe, mirëpo ky interesim i Turqisë në këtë rajon është parë me skepticizëm nga vendet e Ballkanit Perëndimor, duke marrë parasysh që pjesa dërrmuese e popullsisë së atjeshme janë të besimit të krishterë. Për më tepër, kur ky afrim i saj gjeopolitik në tentativë me këto vende, i atribuohet më së shumti konsideratave ideologjike dhe jo interesave kombëtare të Turqisë. Përpjekjet e Ankarasë për të prezantuar politikën e vet të jashtme si të pavarur dhe të shkëputur nga ajo e Perëndimit, nuk ka kaluar pa rënë në vëmendjen e Ballkanit. (Cagaptay,

2007). Gjithsesi, e kaluara dhe historia e vendeve të Ballkanit Perëndimor në raport me turqit, kanë ndikuar në krijimin e perceptimit se Turqia po ndjek një kurs diskret në politikën e jashtme, të orientuar në agjendën neo-otomane në këtë rajon. Mendohet se Turqia kërkon të ndjekë një politikë ekspansioniste drejt Ballkanit me përmasa politike, ekonomike, kulturore dhe arsimore, duke i parë investimet turke në rajon si instrumente pushtuese të saj. (Paličková, 2019).

Në fakt, në thelb neo-otomanizmi kërkon të rigjallërojë dhe të ridimensionojë pozitën gjeopolitike të Turqisë së dikurshme (të humbur tashmë), në raport me gjithë aktorët dhe faktorët e tjerë, rajonalë dhe transatlantikë, duke riformatuar partneritetet e saj me këta aktorë, me synimin e vetëm: kapitalizimin e fuqisë së Turqisë me të gjitha mjetet dhe mënyrat që ajo ka në dispozicion. Kjo qasje e Turqisë, për ta parë veten si qendër të politikës botërore, ka qenë shqetësuese edhe për aktorët ndërkombëtarë euroatlantikë. (Ulgen, 2010). Vihet re se në kabllogramet e Ambasadës Amerikanë në Ankara të vitit 2009, që tashmë janë bërë publike, kjo qasje e politikës së jashtme turke paraqitet si “e rrezikshme”, madje në një komunikim tjetër paralajmërohej, se: “Strategjia e politikës së jashtme turke është krijimi i një aleance të shteteve myslimane, që si kundërpërgjigje do të çonte në ndërtimin e kundëraleancave, duke e përplasur rajonin e Ballkanit Perëndimor në bazë të linjave fetare”. Në këtë rast, krahas aksit mysliman, do të krijohet aksi ortodoks, aq i suksesshëm në shkatërrimin e Perandorisë Osmane në fillim të shekullit të kaluar dhe, sot, me superioritet ekonomik, teknologjik dhe ushtarak, që e bën kërcënimin e sotëm turk inekzistent. (SEESOX, 2011).

Turqia e ka bërë të qartë ambicien e saj në politikën e jashtme, njëherazi falë fuqisë ekonomike për t’u pozicionuar si fuqi rajonale, pse jo dhe si aktor në rang global, duke iu imponuar vendeve të Lindjes së Mesme si shtet lider, gjë e cila do ta vinte në përplasje të pashmangshme me aktorët e tjerë të marrëdhënieve ndërkombëtare me peshë, si Rusia, Kina, Bashkimi Evropian dhe, sigurisht, me SHBA-në. (Demir, 2017).

Nisur nga ky këndvështrim, Turqia do duhet të përballet me ndërlikimin e marrëdhënieve me këto vende dhe pasojave që rrjedhin nga shpалosja e kësaj politike të jashtme me disa rajone,

së pari me vendet e Lindjes së Mesme, Ligën Arabe, Arabinë Saudite dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. (Gordon, Taspinar, and Ozel, 2009). Nga ana tjetër, Turqia e ka të pashmangshme përballjen me një nga organizmat më të fuqishëm politiko - ekonomik si Bashkimi Evropian.

Një tjetër rivalitet i fortë për Turqinë është Rusia me ish-Republikat e saj, të cilat sigurisht nuk e mirëpresin aspak shfaqjen e saj si aktor kryesor në këtë rajon, nisur në njëfarë mënyre edhe për shkak të influencës tejet të madhe që ka Rusia ka në këto vende. Si rrjedhojë, sipas gjasës, këto rrethana do të çojnë në një përplasje të pashmangshme në këtë rajon, edhe për faktin se Rusia është një aktor tashmë i konfirmuar i përmasave globale, ku njeh si kundërshtarë të saj aktorë si SHBA-në dhe Bashkimin Evropian. (Aydintasbas,2020).

Me gjithë shfaqjen e doktrinës: “Thellësia Strategjike” dhe qëllimit për të pasur një rol parësor në rajonin e saj, Turqia nga ana tjetër nuk e ka anashkaluar agjendën e integritit në Bashkimin Evropian, duke ia bërë të qartë BE-së, herë në mënyrë të drejtpërdrejtë e herë tërthorazi, se afrimi i saj në këtë union do të ishte një hap pozitiv për të gjithë aktorët ndërkombëtarë. (*Turkish Ministry of Foreign Affairs, 2020*).

Mirëpo, referuar zhvillimeve të brendshme të Turqisë, në lidhje me respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, si dhe qasjes së politikës së jashtme, ka bërë që procesi i integritit të saj evropian të ngeçë. Turqia është identifikuar si shkelëse e një prej kriterëve kryesorë të aderimit në BE. Turqia nuk plotëson kriteret e Kopenhagës, si kusht për anëtarësim në BE, posaçërisht respektimin e minoriteteve. Në këto rrethana, Ankaraja është e vetëdijshme për këtë pengesë dhe mendon t’i imponohet Bashkimit Evropian.

Përpos gjithë pengesave të hasura në rrugën për zbatimin e doktrinës së Davutoglusë, si dhe doktrinës së “Thellësisë strategjike”, Turqia synon të rrisë ndikimin e saj në Ballkanin Perëndimor, kryesisht tek shtetet me përbërje myslimane. Mirëpo, vendet ku Turqia aspiron ta rrisë ndikimin janë nën influencën e Bashkimit Evropian. Shqipëria, së bashku me Maqedoninë e Veriut, janë në prag të çeljes së negociatave si vende kandidatë për në BE, Bosnjë-Hercegovina ka aplikuar për statusin e vendit kandidat, Kosova ka nënshkruar MSA-në me BE-në. Në këto rrethana, pavarësisht se në këto vende ka segmente të caktuara të elitës

politike me qasje pro-turke, apo që kanë interesa të zvarrisin procesin e integritit në BE dhe të orientohen drejt projekteve turke, vullneti popullor në tërësi është proeuropian. Thënë ndryshe, kursi i tanishëm i politikës së jashtme turke në Ballkanin Perëndimor është i destinuar të jetë i pasuksesshëm, për zbatimin e agjendës së saj në politikën e jashtme. (Yavuz, 2006).

Ndikimi turk në Shqipëri

Turqia është një vend me ndikim rajonal, si politikisht, ashtu edhe ekonomikisht. Roli i saj në Shqipëri është mjaft domethënës, falë dhe lidhjeve historike të saj në të kaluarën. (Zhelyazkova, 2000). Sidoqoftë, perceptimi për ndikimin e saj, siç raportohet nga të dhënat statistikore, ashtu dhe intervistat cilësore të studimit, na ofrojnë një pikënisje të rëndësishme jo vetëm të klimës aktuale politike, por edhe të orientimit gjeostrategjik të Shqipërisë në politikën e jashtme.

Reformat me qasje liberale politike në Shqipëri, vitet e fundit kanë rritur ndjeshëm investimet e huaja në vend. (Bieber, Taleski, & Dimitrov, Nikola, 2017). Sipas të dhënave të vitit 2014, partnerët më të mëdhenj të tregtisë së jashtme të Shqipërisë ishin: Italia, Serbia, Spanja, Malta dhe Turqia. (Banka e Shqipërisë, 2014). Për më tepër, anëtarësimi në NATO dhe Banka Botërore (si dhe negociatat për anëtarësim në BE) kanë krijuar kushte të favorshme për tërheqjen e drejtpërdrejtë të investimeve të huaja, që shkojnë deri në 750 milionë euro në vit (në Evropën Juglindore ky është vendi i tretë pas Serbisë dhe Kroacisë). Rezultati përfundimtar i këtij procesi ishte një rritje ekonomike mbi 6% në baza vjetore. (Banka e Shqipërisë, 2017).

Interesat e Turqisë në rajon nuk janë risi, ndërsa Shqipëria dhe Kosova përfaqësojnë dy partnerë të rëndësishëm ekonomikë të këtij vendi në rajonin e Ballkanit Perëndimor. (Grigoriadis, 2010). Marrëdhëniet e ngushta ekonomike me të dyja këto vende mund të jenë të shpjegueshme në aspektin e afërsisë kulturore dhe fetare. (Hide, 2015). Vlen të theksohet se popullsia shqiptare është kryesisht myslimane. Sipas ambasadorit turk, z. Yörük (2018) aktualisht ka më shumë se 400 kompani turke që veprojnë në Shqipëri, në sektorë të ndryshëm, si: energjia, minierat, telekomunikacioni, bankat, etj., me një fuqi punëtore prej

rreth 15 000 punonjësish, me potencial për zhvillim të mëtejshëm në vitet e ardhshme. Disa shembuj konkretë të fushave të investimeve turke përfshijnë: investimet në telekomunikacion “AlbTelekom”, në arsim, nëpërmjet institucioneve arsimore si “Universiteti Epoka” dhe Kolegjet “Mehmet Akif College”, në sistemin bankar: “Banka BKT” (Turkish Embassy, 2017).

Falë Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të nënshkruar midis Shqipërisë dhe Turqisë në vitin 2006, iu dha mundësia zhvillimit të tregtisë dhe bashkëpunimit midis dy vendeve. Sipas këtij traktati, nuk ka asnjë dallim midis mallrave turke dhe mallrave nga vendet e Bashkimit Evropian. Sidoqoftë, duhet të vihet në dukje, se, në të njëjtin vit, 2006, Shqipëria nënshkroi edhe Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim me BE-në. Sipas një raporti nga SETA, organizatë kërkimore për çështjet politike, ekonomike dhe sociologjike, në vitin 2015 eksporti turk drejt Shqipërisë arriti vlerën prej 287 milionë euro. (SETA, 2018). Vlen të përmendet, se Shqipëria së bashku me Kosovën janë vendet e vetme ballkanike, ku eksportet turke dominojnë ato gjermane, ku në vitin 2015 eksporti gjerman drejt Shqipërisë ka arritur vetëm vlerën prej 223 milionë euro. (SETA, 2018).

Në fakt, Shqipëria mban vendin e tretë në Evropën Juglindore (pas Serbisë dhe Kroacisë), sa i përket investimeve të huaja të drejtpërdrejta, duke arritur në 750 milionë euro në vit me Turqinë, që ofron një kontribut të konsiderueshëm; për shembull investimet e huaja direkte turke gjatë vitit 2017 arritën vlerën prej 45 milionë euro (Banka e Shqipërisë, 2017).

Një dimension tjetër me ndikim, i cili shkon pa u vënë re, por është shumë i rëndësishëm, i referohet ndikimeve socio-kulturore. Lidhja historike midis Turqisë dhe Shqipërisë ka sjellë ngjashmëri të rëndësishme në kuptimin e normave, vlerave dhe mënyrës së jetesës, të cilat mund të jenë ose të lidhura drejtpërdrejt me religjionin (dominimi i fesë myslimane në Shqipëri), (Vracic, 2016).

Si konkluzion, vlerësohet se influenca turke në Shqipëri ka qenë më e pranishme në dimensionin ekonomik, pasi rezultatet në këtë fushë janë më të matshme. Megjithatë, aspektet politike dhe kulturore kanë qenë të ndërthurura me ato ekonomike, por nuk kanë ndikuar drejtpërsëdrejti.

3.5 Doktrina e Ruisë në Ballkanin Perëndimor dhe prezenca në Shqipëri

Bashkimi Sovjetik i kohës, pas rënies së sistemit komunist në vitet '90-të do të pësonte një kolaps të gjithanshëm: politik, ekonomik dhe socio-kulturor. Pikërisht këto ngjarje të rëndësishme historike, do të shërbenin si pikë kthese për krijimin e një konsensusi të ri brenda vendit, për riorientimin gjeopolitik të Federatës Ruse, i cili, tashmë, nuk do të bazohej tek e kaluara, por do të orientohej në përputhje me nevojat dhe kërkesat që kishte vendi. L. Aron thekson se Rusia duhet të vazhdojë të mbetet një nga superfuqitë më të mëdha bërthamore, por edhe një superfuqi në aspektet e tjera ndërkombëtare, siç janë politikat ekonomike, politikat ushtarake dhe ato në gjeopolitikë. (Aron 2013).

Analizimi i politikës së jashtme të Ruisë dhe orientimi i saj gjeostrategjik në vendet e Ballkanit Perëndimor synon të shpjegojë interesat, rolin dhe ndikimin e saj në raport me aktorët e tjerë në këtë rajon, perëndimorë dhe joperëndimorë, si: Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga njëra anë, ndërsa Turqia dhe Kina, nga ana tjetër, të cilat po ashtu kanë interesa ekonomike dhe politike në këtë rajon.

Ballkani Perëndimor është një nga rajonet, ku Rusia gjithnjë e më tepër po këmbëngul të rikonfirmojë praninë e saj, posaçërisht në dekadën e fundit. Përpyekjet e saj në këtë rajon bëhen edhe më të dukshme nisur nga paqartësitë dhe vonesat e Bashkimit Evropian në proceset integruese, apo politikat aspak të qarta përkundrejt vullnetit të shfaqur të vendeve të Ballkanit Perëndimor për t'u anëtarësuar në familjen evropiane. (Nuttall, 2019).

Një faktor tjetër, favorizues për interesat e Ruisë në këtë rajon, janë boshllëqet e krijuara nga qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor, fenomene si keqkëqerisja, korrupsioni, struktura të dobëta të zbatimit të ligjit dhe shtetit ligjor në tërësi, mungesa e ekonomive të qëndrueshme, si dhe rënia e vigjilencës në aspektin civil dhe atë ushtarak të këtyre vendeve. Të marra së bashku, këto elemente e kanë bërë Rusinë të jetë më agresive për shtrirjen e ndikimit të saj në këtë rajon. (Conley, 2016).

Rusia ka përdorur një qasje të moderuar në Ballkanin Perëndimor, duke "deportuar" nëpërmjet përqendrimit të biznesit rus në sektorë strategjikë, si bankat, energjia dhe pasuritë

e paluajtshme. Një pjesë e vendeve, si Serbia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina, janë të varura nga shkëmbimet ekonomike me Rusinë, gjë e cila konfirmon prezencën dhe ndikimin domethënës të saj në këtë rajon. (Mardell, 2020).

Një tjetër aspekt i këtij ndikimi janë importet ruse, të shoqëruara këto me një zgjerim të kapitalit të saj në këto vende. Nisur nga argumentet e mësipërme, vihet re se qeveritë e këtij rajoni janë nën presionin të gjithanshëm, nga njëra anë, presioni rus, dhe nga ana tjetër në raport me vendimet strategjike që kanë të bëjnë me orientimin gjeostrategjik të tyre, në raport me NATO-n dhe BE-në, si dhe vendime të tjera të rëndësishme siç janë zgjerimi dhe liberalizimi i tregut të energjisë në rajon, por dhe qëndrimet që u duhet të mbajnë në raport me sanksionet e Perëndimit, të vendosura ndaj Rusisë. (Holzner & Schwarzhappel, 2018).

Rusia po shfaqet si një fuqi e dorës së parë në këtë rajon dhe, si e tillë, ajo mbetet një nga aktorët e rëndësishëm, ndikimi i së cilës do të sillte ndryshime domethënëse të konfigurimit gjeopolitik në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, ajo nuk është aktori i vetëm gjeopolitik në këtë rajon, ku dukshëm pikasin interesat e dy fuqive të tjera, si Kina dhe Turqia. (Conley, Luke, 2018).

Diskutimet rreth ndikimit politik dhe ekonomik të Rusisë në vendet e Ballkanit Perëndimor janë gjithnjë e në rritje, madje një prej elementeve kryesore të këtij diskutimi ka qenë kriza e Eurozonës në vitin 2008. Natyrisht, pjesa më e madhe e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë të lidhura ngushtë jo vetëm politikisht, por edhe ekonomikisht me Bashkimin Evropian, kështu, për këtë arsye, në sektorin financiar këto vende janë shumë të lidhura me zhvillimet ekonomike dhe politike që ndodhin në brendësi të tij. (World Bank, 2012).

Në vitin 2008-2009 u vërejt, se të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor: Malit të Zi, Serbisë, Kroacisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, për shkak të recensionit global pësuan tronditje në ekonominë e tyre. Në vitin 2009, PPB reale pësoi një tkurrje të konsiderueshme, gjë që solli një zgjatje të recensionit deri në vitin 2010. Ndërsa, për sa i përket prodhimit mesatar në rajon, ai është ende shumë herë më poshtë niveleve të para të krizës së vitit 2008. (EUI, 2012).

Në këtë kontekst, kriza në vendet e BE-së ka ndikuar shumë edhe në ekonomitë lokale të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke sjellë një reduktim të investimeve të huaja direkte, paralelisht me kërkesat për eksporte drejt këtyre vendeve. Mirëpo, në rajon një gjë e tillë ka çuar në njëfarë mënyre drejt një nënvlerësimi të politikave të BE-së, politika të cilat më përpara ishin tejet të vlerësuara, pasi BE e “eksporto” këtë krizë edhe në ekonominë e këtyre shteteve. (ECFR, 2013).

Gjithmonë, kur ndodh një tronditje financiare, efekti i parë lidhet me pasigurinë që shkakton, diçka e tillë ndodhi edhe me krizën financiare të eurozonës në vitin 2008. Rusia, nga ana tjetër, nuk qëndroi në heshtje, por e shfrytëzoi këtë “shok ekonomik të Evropës”, duke u ofruar si alternativë, fillimisht duke u përpjekur që të paraqitet si një fuqi e besueshme nëpërmjet përfaqësimit të saj ekonomik dhe politik për vendet e Ballkanit Perëndimor. (Casier, 2011).

Po ashtu, Moska nuk ka ngurruar të nxisë dhe të inkurajojë kompanitë ruse, që të investojnë gjerësisht në Evropë dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke u përpjekur që ky rajon të kthehet në një nga qendrat gjeostrategjike, si dhe një nga pikat hyrëse preferenciale të saj në aspektin ekonomik. (Secrieru, 2019).

Sigurisht, interesat e Rusisë në Ballkanin Perëndimor nuk janë vetëm me karakter ekonomik, por pikësëpari janë interesa të qarta gjeopolitike. Në këto rrethana, Rusia e ka të pashmangshme përballjen me aktorë të tjerë në Ballkanin Perëndimor, sikurse është Bashkimi Evropian - një superfuqi me interesa të qarta, njëherazi ekonomike dhe gjeopolitike në këtë rajon. Sigurisht, epërsia i përket Bashkimit Evropian, pasi ka çfarë t’u ofrojë vendeve të këtij rajoni nëpërmjet politikave dhe instrumenteve të saj, mundësive për bashkëpunime të favorshme, forcimit të interesave të ndërsjella, si dhe ruajtjen dhe garantimin e sovranitetit të përbashkët. (CESS, 2008).

Megjithatë, për Moskën Ballkani Perëndimor mbetet një rajon gjeostrategjik, duke pasur parasysh gjithnjë rolin e saj si një nga vendet më të mëdha të furnizimit me gaz dhe naftë në vendet e Bashkimit Evropian. (Foreign Policy of the Russian Federation, 2013).

Studiuesi rus, Trenin, ka analizuar qasjen që duhet të ketë një vend i madh si Rusia, e cila, së pari, duhet të jetë një aktor i pavarur, që mund të mos ketë miq të natyrshëm, por mund të ketë partnerë, të cilët janë në të njëjtën kohë edhe konkurrentë. (Trenin, 2007).

Në këtë aspekt, çdo aktor politik mund të jetë në vetvete një partner, por njëkohësisht edhe konkurrent. Për sa i përket raporteve të bashkëpunimit dhe konkurrencës, kjo varet nga fusha të caktuara të interesit që ka secili vend. (Blank, 2013; Mitrova, 2014).

Fuqitë si Bashkimi Evropian dhe Rusia, megjithëse po përdorin gjithë mekanizmat që disponojnë, nuk janë aktorët dhe faktorët e vetëm në Ballkanin Perëndimor që duan të shtrijnë ndikimin e tyre në këtë rajon. Kina dhe Turqia, nga ana tjetër, po veprojnë po ashtu si aktorë të rëndësishëm dhe po ushtrojnë presionin e tyre, për sa i përket zhvillimeve ekonomike dhe politike në këtë rajon. Në këtë kontekst, Rusia nuk dëshiron një përplasje të fortë me Kinën dhe Turqinë, si rrjedhojë ajo po përdor instrumentet e saj në mënyrë që të shmangë rrezikun që vjen nga forcimi i rolit dhe politikave ekonomike të këtyre aktorëve të fuqishëm gjeopolitikë drejt Ballkanit Perëndimor, sidomos pas krizës financiare të vitit 2008 që pësuan vendet e këtij rajoni. (Wilson, 2019). Studiuesi Ole Wæver thekson, se një aspekt tjetër, përveç atij ekonomik, janë dhe konceptet e sigurisë për një perspektivë ndryshe të Moskës ndaj Ballkanit Perëndimor, duke bërë edhe një rivlerësim të aseteve dhe veprimeve ekonomike siç janë energjia dhe infrastruktura.

Ndërkohë, çështjet e sigurisë dhe ato ekonomike të Ruisë në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, janë konceptuar si një nga çështjet prioritare për sa i përket aspektit gjeopolitik. Ndikimi ekonomik i Ruisë në këtë rajon dëshmon një politikë të jashtme, e cila, ndër të tjera, është fokusuar edhe tek përfitimet nga bashkëpunimet ekonomike, duke u imponuar në të gjitha proceset globale ku rol mbizotërues, pa diskutim kanë institucionet kryesore të Perëndimit. (Center for the Study of Democracy, 2018).

Ndikim i Ruisë në vendet e Ballkanit Perëndimor

Qasja e Ruisë ndaj Malit të Zi spikat me një lakore, e cila ndryshon vazhdimisht në raport me kursin e politikës së saj të jashtme. Sapo qeveria malazeze shfaq ambicien për t'u afruar

me Bashkimin Evropian dhe NATO-n, vihet re agresiviteti dhe presioni i Moskës nëpërmjet mekanizmave të saj ekonomike dhe politike. (Marovic, 2016).

Aspekti kryesor i ndikimit në ekonominë dhe në politiken e jashtme malazeze janë investimet e huaja të drejtpërdrejta të Rusisë në Malin e Zi. Ato (IHD) përbëjnë afërsisht një të tretën e prodhimit të brendshëm bruto të vendit, ku Rusia mbetet investitori i vetëm më i madh në Malin e Zi, me 1.27 miliardë dollarë investime. (Tomovic, 2016).

Një nga investimet më të rëndësishme ruse në Malin e Zi është “Podgorica Aluminum Plant”, një fabrikë alumini që kontribuon me rreth 15% të GDP-së në ekonominë e Malit të Zi. Po ashtu, sipas të dhënave zyrtare të Malit të Zi në 2016, në regjistrin e korporatave të shtetit malazez, një e treta e të gjitha kompanive të huaja në këtë vend janë në pronësi të shtetasve rusë. (Tomovic, 2016). Ndikimi i korporatave ruse do të shtrihej gjithnjë e më shumë në ekonominë malazeze, kjo, natyrisht që e bën ekonominë malazeze të varur nga investitorët rusë, praktikisht ky ndikim do të shtrihet edhe në politiken e saj të jashtme. (Center for Democratic Studies, 2018). Turizmi është një sektor jetik për ekonominë e Malit të Zi dhe shërben si gjenerator tepër i rëndësishëm, që ndikon drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike.

Duke iu referuar shifrave, të ardhurat nga turizmi përbëjnë rreth një të pestën e prodhimit të brendshëm bruto të Malit të Zi, si dhe mbi 54% të eksporteve. Të ardhurat vjetore të Malit të Zi nga turizmi llogariten në shifrën 850 milionë euro. (Center for Democratic Studies, 2018). Një aspekt tjetër domethënës për ndikimin e Rusisë edhe në këtë sektor strategjik për Malin e Zi është, se minimumi $\frac{1}{4}$ e këtyre të ardhurave nga turizmi vijnë nga turistët rusë, numri i të cilëve ka pësuar një trend rritës nga viti 2005 deri në fund të vitit 2016, madje shifrat tregojnë se numri i turistëve rusë në Malin e Zi është rritur vazhdimisht: nga 60,000 në 2005 në 316,000 në vitin 2016. Gjithsesi, vlen të theksohet se luhatjet e klimës politike nuk kanë ndikuar për mirë në këtë fushë. Pas përkeqësimit të marrëdhënieve politike të Malit të Zi me Rusinë dhe afrimit të saj me Bashkimin Evropian dhe NATO-n, tendenca e medieve ruse ka qenë gjithnjë për t'i larguar turistët rusë nga Mali i Zi, pavarësisht faktit që shumë prej këtyre turistëve kanë blerë pasuri të paluajtshme dhe kanë investuar në këtë vend (Montenegro

Ministry of Tourism & Sustainable Development, 2016). Gjatë 10 viteve të fundit, rusët kanë investuar në Malin e Zi një total prej rreth 8.1 miliardë euro.

Në periudhën nga 2007-2017, një pjesë e rëndësishme e fluksit të Investimeve të Huaja Direkte në Malin e Zi erdhi nga vende të njohura ndryshe si parajsja fiskale. (Tomovic, 2016). Duhet thënë, se një nga investimet më të mëdha ruse në Malin e Zi, për blerjen e uzinës së aluminit të Podgoricës, erdhi po ashtu nga një kompani e regjistruar në Qipro. Rusia, përmes investimeve të saj, ka ndikuar sa ka mundur dhe ka treguar forcën e saj në ekonominë malazeze. Megjithatë, është venë re një tërheqje graduale e saj në dekadën e fundit, ku ajo megjithëse po përpiqet që të fitojë më tepër peshë në ndikimin e ekonomive lokale të rajonit të Ballkanit, nga ana tjetër shihet se investimet mbeten të ulëta dhe shumë pak të ndryshueshme në krahasim me atë të vendeve anëtare të BE-së. (Holzner& Schwarzhappel,2018).

Maqedonia e Veriut është më pak e varur nga ndikimi i drejtpërdrejtë i Rosisë në ekonominë e saj, pavarësisht qasjes së ish-kryeministrit Gruevski, i cili ishte i fokusuar për forcimin e lidhjeve ekonomike të Maqedonisë së Veriut me ato ruse në sektorë strategjikë, kryesisht në fushën e energjisë, posaçërisht gazin rus (Stojkovska, 2012). Nisur nga nevoja apo domosdoshmëria e gazit rus për ekonominë e Maqedonisë së Veriut, ish-kryeministri Gruevksi e shihte si tepër të nevojshme aleancën me Rusinë, për t'u investuar si partner i besueshëm rajonal, duke siguruar marrëveshje të favorshme për Maqedoninë e Veriut dhe njëkohësisht duke u bërë një pikë tranziti për gazin rus në rajonin e Ballkanit Perëndimor e më gjerë. Mirëpo, kjo linjë nuk funksionoi, pasi Rusia, midis dy linjave të kalimit të gazit, zgjodhi linjën e kalimit përmes Turqisë dhe jo atë të Maqedonisë së Veriut. Por jashtë sektorit të naftës dhe gazit, volumet tregtare midis Rosisë dhe Maqedonisë së Veriut kanë qenë në nivele jo të konsiderueshme. E vetmja rritje e volumit tregtar midis dy vendeve vjen për shkak të eksporteve bujqësore të Maqedonisë së Veriut drejt Rosisë, po edhe kjo vetëm atëherë kur Rusia vendosi të mos pranojë mallra bujqësore nga BE-ja, për shkak të sanksioneve të vendosura ndaj saj nga vendet e Bashkimit Evropian (Stojkovska, 2012). Në këtë kontekst, Rusia krijoi hapësirë për prodhuesit e tjerë jashtë Bashkimit Evropian, siç ishin mallrat dhe produktet bujqësore të Maqedonisë së Veriut, kjo dhe për një arsye tjetër, e cila

ishte politike, pasi Maqedonia e Veriut refuzoi t'i bashkohej sanksioneve vendosur Rusisë nga BE-ja dhe SHBA-ja. Ky vendim do të shihej pozitivisht nga Rusia. Investimet ruse të drejtpërdrejta në Maqedoninë e Veriut janë vetëm 27 milionë euro (në vitin 2015), tepër të ulëta nëse këto shifra i krahasojmë me investimet direkte të Austrisë për shembull, të cilat kapin shifrën 500 milionë euro. (Center for the Study of Democracy, 2018; Retman, 2017). Investimet e drejtpërdrejta ruse në Maqedoninë e Veriut filluan rreth vitit 2009 dhe janë rritur në mënyrë graduale që atëherë. Bizneset dhe biznesmenët rusë kanë investuar kryesisht aty ku kanë gjetur hapësira nëpërmjet lidhjeve të drejtpërdrejta, duke investuar në raporte personale me Kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, duke krijuar raporte preferenciale, ndër ta përmendim “LUKOIL”, një nga kompanitë më të mëdha ruse që vepron në Maqedoni. (Stefanova, 2016).

Ndryshe nga Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, marrëdhënia e Serbisë me Rusinë është tepër e ngushtë, si në aspektin ekonomik dhe politik, ashtu dhe atë strategjik.

Bashkëpunimi midis këtyre dy vendeve ka rrënjë të hershme. Sa i takon qëndrimin të Rusisë në raport me Kosovën, ajo ka qenë e prerë kundër shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe dukshëm në favor të Serbisë. (Russian News Agency, 2017).

Rusia është investuar me kapacitetet e saj në politikën e jashtme, duke bllokuar dhe sabotuar njohjet e reja shtetit të Kosovës, kudo ku ajo ka pasur ndikim. Nga ana tjetër, Serbia është krenare për partneritetin me Rusinë, ndërsa qëndrimin e saj kundër Kosovës e përdor si një kartë të fortë në Bruksel dhe me vendet e tjera, të cilat janë në mëdyshje për njohjen e shtetit të Kosovës. (Polterman, 2014).

Marrëdhëniet midis Serbisë dhe Rusisë mund të interpretohen edhe nëpërmjet lidhjeve të tyre historike, edhe pse në dhjetëvjeçarin e fundit, krahas bashkëpunimit politik, ato janë intensifikuar dukshëm, sidomos në fushën ekonomike dhe ushtarake, të cilat pikën e tyre kulmore e patën me disa marrëveshje të rëndësishme dypalëshe. Rusia është e vendosur të rrisë bashkëpunim ekonomik me Serbinë në disa prej sektorëve të saj kyç të ekonomisë, si në fushën e energjisë, gazit e naftës, infrastrukturën rrugore dhe atë hekurudhore, po dhe në sektorin bankar. (Energy Community, 2017).

Marrëveshja energjetike e vitit 2008, midis “Gazprom” dhe kompanisë më të madhe serbe “Naftna Industrija Srbije” (NIS), ka prodhuar efekte të rëndësishme në ekonominë serbe. (Energy Community, 2014), ku firma të mëdha në pronësi të shtetasve rusë rezultojnë të lidhura ngushtë në mënyrë indirekte në Serbi, të cilat kontrollojnë të ardhura afërsisht 5 miliardë euro, ose 13 për qind e të ardhurave totale të gjeneruar nga ekonomia vendase. Një tjetër dëshmi e ndikimit të kompanive ruse vihet re te varësia e kompanive lokale serbe për importet e lëndëve të para, si gazi, ku “Gazprom” dhe “Lukoil” dominojnë tregjet e naftës dhe karburanteve. (Energy Community, 2017).

Në këta sektorë, Serbia është pothuajse plotësisht e varur nga importet e gazit natyror nga Rusia. (Center for the Study of Democracy, 2018). Ky ndikimi i Ruisë në Serbi nuk është rastësor, ajo ka bashkuar lidhjet e saj politike dhe praninë e saj ekonomike në Serbi, duke shfrytëzuar traditën pro-ruse, pan-sllave dhe qëndrimet pan-ortodokse nëpërmjet ndikimit të saj të gjithanshëm në Serbi. Të gjithë këto elemente kanë lënë gjurmë të rëndësishme ekonomike e politike në shtetin serb. (Center for the Study of Democracy, 2018).

Rusia i është drejtuar gjithnjë e më shpesh forcës ushtarake, për të përparuar me objektivat e saj në politikën e jashtme. Për këtë qasje, ajo po paguan “çmimin”, që më së shumti lidhet me sanksionet e herëpashershme të vendosura nga Komuniteti Ndërkombëtar, sanksione të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në pengimin e zhvillimit ekonomik të Ruisë. Mënyra sesi Presidenti Putin vepron në politikën e jashtme, ndikon drejtpërdrejt në politikën e brendshme dhe popullaritetin e tij. Ekspertët janë të mendimit, se duhet të ketë një rifokusim të mekanizmave ekonomike, pikërisht për shkak të kostove që Rusia po merr nga qasja në politikën e jashtme. Mjafton të përmendim rastin kur Fondi i Rezervës së Ruisë në vitin 2014 ishte 87 miliardë \$, në vitin 2017 ky fond shkoi në 0. Kjo ndodhi për shkak të sanksioneve që iu vendosën Ruisë nga Komuniteti Ndërkombëtar për çështjen e Ukrainës. Nga ana tjetër, rreziqet gjeopolitike dhe klima e paqëndrueshme e ekonomisë dhe funksionimit të biznesit në Rusi, po ndryshojnë dinamikën e fluksit të kapitalit, nga një hyrje neto (79 miliardë dollarë midis viteve 2000-2007) në një fluks neto masiv (646 miliardë dollarë gjatë periudhës 2008-2016) (Kholodilin & Netšunajev, 2019).

Këta faktorë, të kombinuar me çmimet e ulëta të naftës, kanë ndikuar në uljen e normës mesatare të rritjes ekonomike nga 7% (2000-2007) në vetëm 0.9% (2008-2016). Nëse Rusia nuk ndryshon kursin e saj ekonomik dhe qasjen e saj në politikën e jashtme, në raport me aktorët e tjerë ndërkombëtarë, rrjedhimisht ajo do të ketë më pak burime për mirëmbajtjen dhe modernizimin e forcave të saj të armatosura, i cili është mjete kryesor që Moska mbështetet për të ruajtur statusin e saj të fuqisë, brenda dhe jashtë vendit. Në këto rrethana, presidenti Putin propozoi një zhvendosje të buxhetit nga investimet ushtarake drejt sferës civile, si një përpjekje e parë për ekonomizimin e politikës së jashtme të Rusisë. (Istrate, 2020). Për të përmirësuar situatën demografike, qeveria vendosi të zgjasë programin 10-vjeçar të stimulimit të lindjeve deri në 2021, si dhe nxitjen e programeve të favorshme hipotekare për familjet me dy ose më shumë fëmijë. Po ashtu, u shqyrtuan reforma e sistemit fiskal dhe e pensioneve. Në Siri, pasi siguroi mbijetesën e regjimit të “klientit” të saj me mjete ushtarake, Rusia njoftoi një ulje të pranisë së trupave të saj në këtë vend. Rusia identifikohet më tepër si fuqi gjeopolitike, sesa një fuqi tregtare. Si e tillë, ajo është e drejtuar më shumë nga agjenda e sigurisë, sesa nga ajo ekonomike. Marrëdhënia me Ukrainën është një shembull domethënës. Përmendim këtu Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë (DCFTA) midis Ukrainës dhe BE-së, e cila parakuptohej nga Rusia që do të ndikonte negativisht në marrëdhëniet e saj tregtare me Kievin. Në të vërtetë, ajo që ndikoi realisht negativisht do të ishte aneksimi i Krimesë dhe lufta në Ukrainën Lindore, që la gjurmë në marrëdhëniet tregtare dypalëshe. (Secieru 2018).

Pavarësisht kostove ekonomike, rusët e konsiderojnë politikën e jashtme të vendit dhe reformat ushtarake si arritjet kryesore të presidentit Putin. Kështu, është logjike që Presidenti të shfrytëzojë ato që njerëzit i konsiderojnë si histori sukcesi, ndërsa, nga ana tjetër, mos të ngurrojnë të fajësojnë palët e treta (burokratët, autoritetet rajonale, fuqitë e jashtme, etj.) për dështimet. (The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation, 2016).

Një fakt i pamohueshëm për realitetin në Rusi është, se drejtimi i politikës, të jashtme dhe të brendshme, është në dorën e elitës. Në këtë këndvështrim, është e kuptueshme tendenca për rezistencë ndaj ndryshimit. Rusia arriti t'i mbijetonte tronditjes së dyfishtë të sanksioneve dhe çmimeve të ulëta të naftës, pa bërë lëshime të mëdha në qasjen e saj në politikën e

jashtme. Nga këndvështrimi i Kremlinit, nuk ka asnjë arsye, se pse duhet të zëvendësohet një model ekonomik, i cili dëshmoi se ia doli të funksionojë edhe ndaj presionit të sanksioneve të jashtme. Nga ana tjetër, në Moskë ekziston shqetësimi se destabilizimi i reformave ekonomike do ta ekspozojnë Rusinë ndaj ndikimit të aktorëve të jashtëm, diçka që mund ta çojë Rusinë në humbjen e epërsisë që ajo ka si një aktor ndërkombëtar me peshë. (Larrabee, Pezard, Radin, Chandler et al. 2017).

Sipas këndvështrimit të elitave qeverisëse, është pikërisht kjo qasje që shkaktoi rrëzimin e Bashkimit Sovjetik. Prandaj, udhëheqja e dobët politike e mbështetur nga reformat perceptohet si më kërcënuese për të ardhmen e Rusisë, sesa një ekonomi gati në kolaps nën një sundimtar të fortë. Në këto rrethana, Rusia mund të kryejë reforma të kufizuara me qëllim rregullimin e sistemit ekzistues, në vend që të përpiqet të krijojë një të ri. Një perspektivë tjetër nënvizon se ka një ndjenjë të vetëbesimit pas fitoreve të perceptuara të politikës së jashtme të shënuara në Ukrainë dhe Siri, prandaj diplomacia e mbështetur nga forca konsiderohet më e efektshme, sesa qëndrimet e jashtme me qasje ekonomike. (Secieru 2018).

Ndikimi rus në Shqipëri

Ndonëse Shqipëria nuk është e listuar në mesin e dhjetë vendeve me interes ekonomik rus, vitet e fundit ka pasur disa sinjale të dukshme pro saj. Ndikimi ekonomik në rritje i Rusisë është ndihmuar nga përpjekjet politike për të ringjallur dhe zhvilluar marrëdhëniet ekonomike midis dy vendeve; fokusi ka qenë në rritjen e investimeve ruse në sektorët e energjisë, transportit dhe turizmit. (Kurbatskiy, 2012). Ndryshimet e para po bëhen tashmë të dukshme. Për shembull, ka disa tregues të negociatave midis kompanive kineze dhe turke “Lukoil” dhe “Gasprom” lidhur me nxjerrjen e naftës në zonën e Patos-Marinzës. (Metohu, 2017). Në të njëjtën linjë, vërehet se Ambasada Ruse në Tiranë po përpiqet të marrë kontrollin mbi pjesën shqiptare të Tubacionit Trans-Adriatik (TAP) duke rritur ndjeshëm investimet ruse në vendin tonë. Varësia e vendeve evropiane në gazin rus dhe kërcënimi në rritje i rrugës alternative të gazit Azerbajxhan në Evropë e justifikon interesin në rritje të Rusisë për projektin TAP, duke kaluar nëpër territorin shqiptar. (Metohu, 2017).

Interesi i fuqishëm ekonomik dhe gjeopolitik i Rosisë në rajon është plotësuar me përpjekjet për të ndryshuar diskursin mediatik në Shqipëri, përveç vendeve të tjera në rajon. Shembujt përfshijnë një seri artikujsh të diskutueshëm, që haptazi denoncojnë përpjekjet e Rosisë për të “blerë” influencën e medias në Shqipëri; një strategji e tillë do të përfshijë disa stacione televizive shqiptare, gazeta dhe media online në kompanitë ruse, qëllimi përfundimtar i të cilit është përhapja e “propagandës ruse”. (Gjonaj, 2017, Mejdini, 2016). Sidoqoftë, duhet theksuar se ky informacion është kontestuar zyrtarisht nga Ambasada Ruse në Tiranë.

Vizita e papritur e shefit të CIA-s, John Brennan, në Shqipëri në vitin 2016, ngriti dyshime mbi ndikimin rus në Shqipëri, megjithatë mund të thuhet se marrëdhëniet politike mes dy vendeve nuk mund të përshkruhen si shumë aktive, sikurse dimensionet më të spikatura të ndikimit rezultojnë të jenë ato ekonomike dhe kulturore. (Kurbatskiy, 2012).

Në të vërtetë, një takim dypalësh ndërqeveritar midis vendeve të Rosisë dhe Shqipërisë do të mbante sesionin e tij të shtatë në Tiranë pas 7 vjet ndërprerjeje, (Mlloja & Hunci, 2016). Ndonëse marrëdhëniet midis dy vendeve po përmirësohen ngadalë (siç u konfirmua nga ambasadori shqiptar në Rusi dhe ambasadori rus në Shqipëri në intervista të ndara), përpjekjet në rritje për të mbajtur një dialog dypalësh, pavarësisht ndryshimeve themelore në çështjet politike, janë mjaft të qarta. Në kontekstin shqiptar, këto zhvendosje në rrafshin gjeopolitik dhe ekonomik ngrenë një pikëpyetje të madhe mbi orientimin gjeostrategjik të Shqipërisë përballë identitetit lindor dhe prezencës ruse. Debati i përkatësisë, në një sistem ose tjetrin, për shekuj me radhë ka zënë hapësira politike dhe akademike, aq sa shpeshherë është kthyer në një pikë të nxehtë të identitetit kombëtar shqiptar. Disa studiues pohojnë, se ekziston një ndarje në mes të modeleve formale demokratike perëndimore që ndiqen nga shteti dhe identiteti i saj i lindur lindor, që është në kundërshtim me të parën. (Hide, 2015).

Si konkluzion, vlerësohet se influenca ruse në Shqipëri ka qenë më së shumti e pranishme si faktor pengues në dimensionin politik, ndërsa në aspektin ekonomik dhe kulturor ka qenë më pak domethënëse dhe nuk ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë.

3.6 Doktrina e Kinës në Ballkanin Perëndimor dhe prezenca në Shqipëri

Qasja e Kinës në politikën e jashtme karakterizohet nga një sërë parimesh dhe sloganesh, të cilat, në thelb, kanë bashkëpunimin dhe jo konfliktin ndërmjet shteteve. Prej viteve '80-të, nën udhëheqjen e liderit kinez, Deng Xiaoping, deviza e Pekini ka qenë për ndjekjen e një “politike të paqes”, në të cilën synimet kryesore të Kinës vijnë të jenë:

- a) *Ruajtja e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të saj;*
- b) *Krijimin e një klime të favorshme në raport me komunitetin ndërkombëtar;*
- c) *Hapja dhe modernizimi i Kinës nëpërmjet reformave të thella.*

Kina është shteti, i cili ka futur për herë të parë në marrëdhëniet ndërkombëtare konceptin filozofiko-politik të një “bote harmonike” dhe “ngritje paqësore”. Kësisoj, Kina ka deklaruar se do të promovojë paqen, zhvillimin dhe bashkëpunimin mes shteteve, me qëllim arritjen e rezultateve të synuara prej saj në politikën e jashtme. Kina i ka kushtuar absolutisht një kujdes të veçantë zhvillimit të marrëdhënieve me fqinjët dhe ruajtjes së partneritetit me ta, një mënyrë kjo për parandalimin e kërcënimeve që mund t’i vijnë nga jashtë, të cilat mund t’i shkaktojnë paqëndrueshmëri në politikën e saj të brendshme. Kina është investuar në mënyrë të kujdeshme në diplomaci, duke shpalosur fuqinë dhe potencialin e saj në këto dimensione:

- a) *Lënien mënjane të mosmarrëveshjeve me shtetet fqinje;*
- b) *Krijimin e marrëdhënieve të besimit dhe promovimin e tyre;*
- c) *Integrimin ekonomik dhe bashkëpunimin shumëpalësh për adresimin e shqetësimeve të përbashkëta.*

Për shkak të numrit të madh të popullsisë, është e kuptueshme që nevojat e Kinës për energji dhe burime natyrore janë po ashtu të mëdha, kryesisht në sektorët e naftës dhe gazit natyror. Këto nevoja e kanë bërë Pekinin të jetë i hapur dhe të lidhë marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe, me vendet që kanë në dispozicion burime të atilla, në mënyrë që të sigurojë zhvillimin e saj të qëndrueshëm ekonomik. (Information office of State Council, 2012). “Diplomacia energjetike” e Kinës ka çuar jo rrallëherë në krijimin e marrëdhënieve të ngushta edhe me regjime jodemokratike, gjë e cila ka ngritur pikëpyetje tek aktorët e

rëndësishëm perëndimorë, në lidhje me rolin e saj si një aktor i përgjegjshëm në arenën ndërkombëtare. Nga ana tjetër, nevoja për të siguruar burime ka krijuar edhe fërkime me fqinjët, në lidhje me rezervat e energjisë në Jug dhe Lindje të saj.

Qëndrimi mbrojtës i Kinës dhe qasja e saj e pa kompromise për të ruajtur një mjedis ndërkombëtar jo konfliktual, i kanë lejuar përqendrimin në sfidat e brendshme, por edhe mundësinë për bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera, për të ruajtur stabilitetin rajonal. Megjithatë, studiuesit kanë ngritur disa pyetje rreth politikës së jashtme kineze, si për shembull: *Si do të zgjidhen pretendimet territoriale të mbivendosura në Detin e Kinës së Jugut, Detin e Kinës Lindore, Ngushticën e Tajvanit dhe përgjatë kufirit të saj perëndimor me Indinë? Si do ta zbatojë Kina fuqinë e saj politike dhe ekonomike në rritje? A cenohet gjendja e saj e brendshme?*

Disa sfida kryesore transnacionale të shekullit të 21-të, do të kërkojnë zgjidhje që përfshijnë ngushtësisht Kinën, duke bërë të qartë përfitimin e marrëdhënieve të qëndrueshme kineze dhe angazhimin e saj me Shtetet e Bashkuara dhe bashkësinë ndërkombëtare.

Kina është sot një nga superfuqitë ekonomike në rang global. Nëpërmjet strategjive të kujdesshme dhe të mirëstudiara, ajo ka bërë që ndikimi i saj gjeoekonomik të jetë gjerësisht i shtrirë në ekonominë globale. (World Politics Review, 2020). Kina ka zgjidhur dhe vazhdon të zgjidhë të gjitha dilemat teknologjike, të cilat shumë shtete me potenciale të mëdha ekonomike e kanë pasur të pamundur realizimin e tyre dhe, si pasojë, tashmë kanë mundësinë që ta marrin si shembull këtë histori suksesi nga ana ekonomike. (Schoff & Ito, 2019).

Kina është mbështetur në vizionin dhe strategjinë e presidentit të saj, Xi Jinping, i cili është pro politikës së hapur, në pikëpamjen ekonomike dhe tregtare, nga ana tjetër ai mbështet fort projektet dhe bashkëpunimet pa barriera që do të çojnë në zhvillimin e ndërsjellë të ekonomisë globale (Erickson, 2019).

Studiues të spikatur të ekonomisë botërore kanë raportuar vazhdimisht ndryshimet galopante që po ndodhin me këtë shtet, madje ata theksojnë se rritja e ekonomisë kineze i ofron

qëndrueshmëri dhe një mbështetje tepër të fortë rritjes së ekonomisë botërore. (Amadeo, 2019).

Duke iu referuar Fondit Monetar Ndërkombëtar, Kina prej disa vitesh është një nga liderët kryesorë sa i përket zhvillimit të ekonomisë botërore, madje falë këtyre parashikimeve rreth 39% e rritjes së ekonomive globale vijnë nga shteti kinez. (International Monetary Fund, 2020).

Edhe pse një superfuqi ekonomike botërore, Kina vazhdon që të ketë suksese tek investimet në fushat bazike, që i përkasin zhvillimit të arsimit, të infrastrukturës dhe teknologjisë novatore, e cila ka ndikuar së tepërmi në ruajtjen e qëndrueshmërisë ekonomike për një periudhë afatgjatë. Nëse kthehemi pas në kohë, kur Kina përgatitej vite më parë për strategjitë që do e ndihmonin të shndërrohej në një fuqi botërore, vëmë re se një nga strategjitë e saj ka qenë zgjerimi i roleve dhe ndikimeve të këtij shteti pa shkaktuar “shqetësime”, apo kundërshtime të hapura me vendet e tjera. Ky model ekonomik ka arritur që të sigurojë një rritje të lartë ekonomike, krahasuar kjo me kurbat e viteve të para në fillimet e dekadës së këtij shekulli. (Lardy, 2012). Këto përparime dhe arritje të realizuara, përveçse janë të njohura, po kërkohen si referenca të domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik për shumë vende të tjera.

Kina, me rolin e spikatur ekonomik, ka vendosur si objektiv që të kontribuojë me mençuri, por edhe me fuqinë e nevojshme ekonomike, në të gjitha projektet të cilat do të shërbenin për të pasur një rritje dhe përmirësim të ekonomisë globale.

Shembulli më kuptimplotë i kësaj qasjeje është nisma: “One road, one belt”, shpalosur nga presidenti kinez, Xi Jinping, në vitin 2013. (Chatzky & McBride, 2020).

Kjo nismë është një nga projektet më ambicioze infrastrukturore të Kinës, e njohur ndryshe si “Rruga e Mëndafshit” dhe pritet të japë efekte tepër pozitive në ekonominë botërore. Projekti ka si qëllim zgjerimin e tregjeve të saj aktuale dhe krijimin e “korridoreve” të reja të zhvillimit, si hekurudha, autostrada, porte dhe aeroporte, të cilat janë në qendër të kësaj strategjie zhvillimi, duke përfshirë disa kontinente: nga Azia Lindore deri në Evropë.

Nëpërmjet këtij projekti Kina synon të rrisë dhe të zgjerojë ndikimin e saj ekonomik dhe gjeopolitik në rrafsh global, duke nxitur dhe promovuar frymën gjithëpërfshirëse, duke bërë të mundur përfitimin nga të gjitha vendet e përfshira, në mënyrë që ekonomia globale të mirëfunksionojë. Ky projekt përfshin më shumë se 152 vende dhe organizata, të cilat po identifikojnë në vazhdimësi të gjitha mundësitë efektive të bashkëpunimit me njëri-tjetrin (Chatzky & McBride, 2020).

“One road, one belt” - nuk është nisma e vetme e ndërmarrë nga Kina, pasi do të pasohej dhe nga iniciativa të tjera, që mendohet të jenë urë lidhëse e gjigantit ekonomik aziatik me tregjet e Evropës Perëndimore.

Për vendet e Ballkanit Perëndimor, Kina u investua me nismën “16 + 1”, në bashkëpunim me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEC & China), e cila ka si qëllim promovimin e marrëdhënieve të biznesit dhe investimeve midis atyre shtatëmbëdhjetë vendeve të rajonit. Nëpërmjet kësaj iniciative, Kina i afrohet rajonit të Ballkanit Perëndimor me një “ofertë” konkrete. Më vonë, në vitin 2019, kësaj iniciative do t’i bashkohej edhe Greqia. (Ciurtin, 2019).

Nëse i referohemi nismës “16+1”, shohim një tjetër “frymëmarrje” ekonomike, që rajoni i Ballkanit Perëndimor ka përfituar falë prezencës ekonomike kineze.

Nëpërmjet qasjes politiko-ekonomike, vërehet se me vendet e Ballkanit Perëndimor Kina është treguar shumë e kujdesshme, që të mos cenojë raportet e këtyre vendeve me Bashkimin Evropian. Kësisoj, vihet re se nga politikat e Kinës dhe të Xi Jinping-ut, në rajonin e Ballkanit Perëndimor nuk ka skenarë të errët me qëllim aneksimin e territoreve të shteteve të pavarura, madje as demonstrime të forcave për plotësime të objektivave të superfuqive, përkundrazi Kina ka ndjekur një politikë paqësore të dialogut dhe bashkëpunimit. Sigurisht, kjo lloj strategjie ka dhënë efektet e saj pozitive, të cilat i kanë lejuar shtetit kinez të ketë një rol rritës në arenën ndërkombëtare. Pavarësisht zgjerimit dhe shtrirjes së influencës së saj në Evropë dhe Ballkanin Perëndimor, Kina nuk i ka anashkaluar marrëdhëniet me vendet e Afrikës, Azisë dhe Paqësorit (Milhiet, 2017). Nëse do i riktheheshim edhe një herë marrëdhënieve bashkëpunuese midis Kinës dhe Shqipërisë, si dhe nismave të ndërmarra të

cilat kanë ndodhur kryesisht kohët e fundit në plan global, do të shihnim se Kina dhe vendi ynë janë përballë shanseve historike, të cilat nuk duhen humbur, pasi janë në kohën e duhur.

Më 16 dhjetor 2014, u mbajt Takimi i 3-të i Krerëve të Qeverive të Kinës dhe vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore në Beograd, Serbi. Takim u bë në kuadër të iniciativës “16+1”. Në këtë Samit pjesëmarrësit theksuan, se bashkëpunimi Kinë-CEEC është në përputhje me marrëdhëniet Kinë-BE dhe riafirmuan angazhimin e tyre për partneritet dhe paqe, duke u bazuar në parimin e barazisë, respektit dhe besimit të ndërsjellë, duke kontribuar kështu, siç është e përshtatshme, në zbatimin e Agjendës Strategjike BE-Kinë 2020. Thujse të gjitha palët pjesëmarrëse ranë dakord, që të thellohej bashkëpunimi për realizimin e projekteve të mëdha në infrastrukturë, industri, bujqësi, turizëm, kërkim dhe zhvillim, shkencë dhe teknologji, mbrojtjen e mjedisit, si dhe shkëmbimet e burimeve njerëzore.

Nga ana tjetër, ky samit po ndodhte në një moment tensioni ndërmjet Evropës dhe Ruisë, ku Bashkimi Evropian i kishte vendosur sanksione Ruisë, për shkak të ndërhyrjeve që kreu në Ukrainë. (European Council, 2020).

Kjo ngjarje shërbeu akoma më shumë për të forcuar marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet Kinës dhe Evropës, duke nxjerrë përfitime reciproke në dekadat që do të vijjnë. Gjatë zhvillimit të samitit u bë e mundur krijimi i Këshillit të Biznesit midis Kinës dhe vendeve të Evropës Juglindore dhe Qendrore. Këshilli kishte si objekt hedhjen e një hapi të mëtejshëm ekonomik, por në të njëjtën kohë ishte pika kryesore e këtij samiti. Po ashtu, Kina zotohej se do të krijonte një fond të ri investimesh me vlerë 3 miliardë dollar, si dhe do të dyfishonte volumin tregtar mes Kinës dhe Evropës Qendrore dhe Juglindore. Kryeministri Li Keqiang, në këtë samit premtoi një fond prej 10 milionë dollarësh për projektet e infrastrukturës dhe energjisë. Gjatë takimit katërditor, kryeministri Li Keqiang zhvilloi takime të shumta me udhëheqësit e pranishëm në Samit, ku qëllimi i këtyre të fundit ishte tërheqja sa më shumë e investimeve kineze. Mbas takimeve dypalëshe të kryeministrit Li Keqiang, u arritën disa marrëveshje, ku kompanitë kineze do të ndërtojnë:

- Autostradën në Malin e Zi – Serbi me vlerë 800 milionë euro.

- Ura në Beograd me vlerë 226 milionë dollarë.
- Investim në impiante energjetike në Serbi dhe Bosnjë.

Në Samitin e Beogradit mori pjesë edhe Shqipëria, e cila arriti dakordësinë me palën kineze për ndërtim e Rrugës së Arbrit. Në këtë Samit u arrit të shqyrtohen mekanizmat, që do të jenë në gjendje të paraqesin projekte të përbashkëta me njëri-tjetrin, duke rritur atraksionin e tyre për tërheqjen e fondeve të reja të Republikës Popullore të Kinës.

Një momentet i rëndësishëm i Samitit ishte nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet tri vendeve: Serbisë, Hungarisë dhe Kinës, për ndërtimin e një linje hekurudhore 370 km. Pekini kërkon t'i shtrijë investimet në territorin e Evropës, kjo në përputhje me strategjinë e miratuar në vitin 2012. Ky projekt kap vlerën e 1.9 deri në 3.1 miliardë dollarë (1.5 deri në 2.5 miliardë euro), e financuar nga Chinese Development Bank dhe që do të zbatohet prej kompanive shtetërore kineze. Projekt ka një afat kohor deri në dy vjet dhe synon të ketë shtrirje në Maqedoni dhe të vazhdojë deri në Shkup. Rreth 32 milionë njerëz do preken nga ky projekt që bashkon Kinën dhe Evropën nëpërmjet linjës së re hekurudhore. (Toncev, 2017). Nxitja e liberalizimit të tregtisë ndihmon rimëkëmbjen e ekonomisë globale, e cila nuk është fort e qëndrueshme dhe lehtësitë e investimeve të reja rrisin rezistencën e presionit të rënies ekonomike.

Projekti “One road, one belt” dhe mekanizmi i bashkëpunimit “16+1” midis shtetit kinez dhe shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore (këtu përfshihet dhe Shqipëria), janë dëshmi e ambicies së Kinës në këtë drejtim. Shqipëria ka një avantazh të dukshëm në raport me vendet fqinje të nismës “16+1”, kjo falë vijës bregdetare dhe kapaciteteve të saj portuale përgjatë Rrugës detare të Mëndafshit dhe zonës të Mesdheut, ajo është një nga destinacionet më të parapëlqyera sa i përket investimeve të Kinës. (China Daily, 2017). Ndërtimet infrastrukturore dhe shfrytëzimet e mineraleve, si dhe telekomunikacioni tek sektorët e shërbimeve, të bashkëpunimeve ekonomike shqiptaro-kineze kanë hyrë në një nga fazat më të reja dhe më frytdhënëse. Pikërisht lidhur me këtë strategji, këshilltari ekonomik dhe tregtar i Ambasadës Kineze në Shqipëri, Lian Gang, është shprehur në një nga intervistat e dhëna

tek Radio e Jashtme e Kinës (CRI SHQIP), se investimet kineze të bëra në Shqipëri janë kryer të gjitha sipas parimeve zbatuese të projektit “One road, one belt”. (CRI online, 2017).

Në këtë projekt, strategjitë kryesore janë: gjithëpërfshirja, konsultimet e barabarta, marrëdhëniet e ndërsjella dhe respektimi i rregullave të tregjeve, të cilat janë pro një zhvillimi të vazhduar dhe të balancuar. (Mejdini, 2016). Investimet dhe mirëmenaxhimi i këtyre investimeve janë shembujt më të mirë të bashkëpunimit për të pasur përfitime të përbashkëta, në mënyrë që të përmirësohen përdorimet e burimeve që janë dypalëshe, por edhe që kanë realizuar një përpjesëtim të ndërsjellë për sa i përket bazave shfrytëzuese, të cilat kanë qenë jo vetëm nxitësit kryesorë të zhvillimit ekonomik, por kanë ndikuar edhe në rritjen e numrit të të punësuarve dhe niveleve profesionale në Shqipëri. Edhe pse midis Kinës dhe Shqipërisë kemi një largësi të konsiderueshme gjeografike, sikundër një diferencë tejet të madhe sa i përket madhësisë së ekonomive tek të dyja shtetet, mundësitë e bashkëpunimit midis tyre janë tepër të mëdha. Thuajse të dyja shtetet janë në gjendje të plotësojnë katërçipërisht të gjitha kërkesat që kanë, pa përmendur këtu miqësinë e vjetër dhe besimin e fortë politik. (Brady& Higashi, 2019).

Ndikimi kinez në Shqipëri

Zanafilla e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kinës është e kahershme. Ato do të nisnin pas Luftës së Dytë Botërore, kohë kur qëndrimi i kampit të vendeve komuniste kishte filluar të ravijëzohej, së pari në raport me Perëndimin dhe, më pas, midis njëri-tjetrit, pra vendeve të Bllokut Komunist. Viti 1954, që do të shënonte fillimin e marrëdhënieve zyrtare midis Shqipërisë dhe Kinës, kohë kur secili shtet dërgoi përfaqësinë diplomatike në vendin përkatës dhe hapën siparin e bashkëpunimit midis tyre, kuptohet me një fokus modest bashkëpunimi, por që do të zgjerohej në vitet në vijim, si rrjedhojë e ndryshimit të konfigurimit gjeopolitik brenda Bllokut Komunist. (Intervistë Gjon Boriçi, 2019).

Këto marrëdhënie do të intensifikoheshin në vitin 1960, pas ndarjes përfundimtare të Shqipërisë dhe Kinës me Bashkimin Sovjetik. Ato kishin dënuar rëndë vijën ideologjike të ndjekur nga Moska zyrtare dhe kishin tradhtuar idealet komuniste-staliniste. Në këtë kontekst, të dy vendet nisën një erë të re bashkëpunimi me njëra-tjetrën në politikën e

jashtme, ku Shqipëria do të ishte një zë i fuqishëm në OKB për rikthimin e Kinës në këtë organizëm, si dhe shtrinë bashkëpunimin e tyre konkret për zhvillimin ekonomik, industrial, bujqësor dhe në aspektin ushtarak. Një dimension tjetër i bashkëpunimit Shqiptaro-Kinez, është ai në aspektin arsimor dhe kulturor, ku pati një shkëmbim të ndërsjellë të vlerave kulturore dhe kinematografike, pa anashkaluar edhe shkëmbimin studentor, çka do ta forconte më tej lidhjen midis dy popujve. (Intervistë Prof. Paskal Milo, 2019).

Këto marrëdhënie do të vazhdonin të tilla deri në mesin e viteve '70-të, kur Kina do të ndryshonte kursin e saj gjeopolitik, duke u hapur me Perëndimin dhe aktorë të tjerë, si nevojë për të zhvilluar dhe modernizuar më tej ekonominë e saj gjithnjë në rritje. Ishte pikërisht ky ndryshim kursi, që do të çonte në ftohjen e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kinës, mirëpo, pavarësisht kësaj, bashkëpunimi i gjatë dhe marrëdhëniet e forta të krijuara më herët midis dy vendeve, do të bënin që rigjallërimi i marrëdhënieve diplomatike dhe bashkëpunimi i ndërsjellë, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë në vitet '90-të, për të dy vendet të ishte më i lehtë (Kreka, 2015).

Në ditët e sotme, në Shqipëri, kompanitë e ndryshme kineze i ushtrojnë aktivitetet e tyre në fusha, si: industria minerare, telekomunikacioni, infrastruktura, energjetika, nafta dhe sektorët e ndryshëm të shërbimeve. Nga ana tjetër, për Shqipërinë investimet kineze janë shumë të rëndësishme, madje kanë një domethënie shumë të madhe, e parë kjo në katër aspektet kryesore.

Së pari, këto investime tregojnë besimin e kompanive të ndryshme kineze tek tregu dhe tek zhvillimi i ardhshëm i Shqipërisë.

Së dyti, nëse do të përmendnim projekte të ndryshme të mëdha, siç është blerja e kompanisë së naftës “Bankers”, si dhe blerja e disa prej aksioneve të Aeroportit “Nënë Tereza”, të cilat mund të përdoren si strategji për të tërhequr vëmendjen e shumë firmave të tjera për të investuar, në mënyrë që të nxiten dhe të zhvillohen sektorët e tjerë industrialë.

Së treti, ne konstatojmë se bashkëpunimet e ndryshme kanë maksimizuar përdorimet e burimeve, të cilat janë shumëpalëshe. Nëse do të përmendnim këtu projektin e Aeroportit

“Nënë Tereza”, do të shihnim një ndërthurje të burimeve të palëve kineze për sa i përket kapitaleve, klientelës, që mund të jenë udhëtarë ose mallra, si dhe zgjerimit të bizneseve të palëve shqiptare dhe asaj gjermane për sa i përket pjesës së menaxhimit. Ndërkohë, si rezultat mund të përmendim, se numri në tremujorin e parë të vitit 2018 në aeroport u rrit me 10%. (Instat, 2018).

Dhe së katërti, shumë kompani kineze, përveç bizneseve të ndryshme, kanë mirëmenaxhuar të gjitha përgjegjësitë e tyre shoqërore, njëhohësisht kanë dhënë një ndihmesë të madhe për sa i përket shtimit të taksave, rritjes së punësimit apo trajnimeve profesionale. Këtu mund të përmendim kompaninë e naftës “Bankers”, ku janë të punësuar mbi 2000 punëtorë, të cilët, përveç njohurive, kanë përfituar dhe përvojë profesionale, gjë e cila i ka ndihmuar në shtimin e të ardhurave vetjake. Një tjetër investim kinez është edhe kompania “Huawei” ku pjesa më e madhe e stafit është me kombësi shqiptare, kjo gjë jo vetëm që ka rritur nivelet profesionale, por ka sjellë edhe një nxitje për sa i përket të gjitha shkëmbimeve njerëzore midis tyre (Mejdini, 2016). Nga ana tjetër, nëse do të shihnim potencialin e bashkëpunimit tek fusha e investimeve, përveç pjesës së minierave, naftës, infrastrukturës ose hidrocentraleve, Shqipëria është një vend i cili ka mjaftueshëm hapësira zhvilluese në sektorë të ndryshëm, si industria e përpunimit ose tek pjesa e turizmit. Falë pozitës tepër të favorshme gjeografike, një pjesë e mirë e produkteve shqiptare mund të tregtohen edhe në tregjet e BE-së, duke pasur një leverdi shumë të dukshme tek pjesa e transportit dhe tek tarifat e ulëta doganore. Nga ana tjetër, firmat e ndryshme kineze kanë mundësi të zgjedhin një shumëllojshmëri projektesh përpunuese, por sipas kushteve të veta. Për sa i përket zhvillimit të kapitaleve teknologjike ose zhvillimit bashkëpunues shumëpalësh, këtu mund të përmendim partnerë të ndryshëm gjermanë ose italianë, në mënyrë që të bëhet një shfrytëzim i mundësive zgjeruese të biznesit. Mirëpo, s’mund të lëmë pa përmendur dhe kushtet e mira natyrore dhe burimet tepër të pasura kulturore që ka Shqipëria, për të pasur një zhvillim më të madh të turizmit. (Albania Foreign Investment, 2020)

Nëse kthehemi pas në kohë dhe kujtojmë vitet ’60-’70-të, periudha kur marrëdhëniet shqiptaro-kineze kishin arritur kulmin, vërejmë se pikërisht në këtë periudhë Shqipëria ka lënë një nga përshtypjet më të paharrueshme në historinë e Kinës të asaj kohe (Corne, 1997).

Madje, mund të përmendim edhe disa faktorë kulturorë, në ato vite filmat shqiptarë i kanë shoqëruar të rinjtë kinezë të asaj kohe. Për të mos thënë se shumica e atij brezi, që aktualisht janë të moshuar, nëse do të kishin mundësi, do e vizitonin Shqipërinë për ta parë më nga afër, këtë fakt e ka pohuar edhe Lian Gang, këshilltari ekonomik kinez. Ndërkohë, sipas INSTAT (2017) ne shohim një rritje të investimeve kineze në Shqipëri. Në vitin 2015, këto investime u shtuan me 87 milionë dollarë amerikanë, ndërsa në vitin 2016 këto investime arritën nivelin e 760 milionë dollarëve amerikanë. Përveç projektit “Një brez, një rrugë” dhe bashkëpunimit “16+1”, apo shkëmbimeve bashkëpunuese dypalëshe në fusha të ndryshme, pritet dhe një bashkëpunim i thelluar ekonomik-tregtar mes dy vendeve. Ky bashkëpunim do të bazohet mbi konsultime, të cilat do të jenë të barabarta dhe me leverdi të ndërsjella, në mënyrë që ky bashkëpunim të jetë sa më jetëgjatë, por të ketë edhe stabilitet.

Vitet e fundit bashkëpunimet midis shtetit kinez dhe atij shqiptar, në fusha të ndryshme ekonomike, politike dhe sociale, po forcohen pandërprerë, veçanërisht tek pjesa tregtare shohim që ka pasur zhvillime me ritme të shpejta. Nga fundi i vitit 2016, tregtia midis këtyre dy vendeve ka pasur rritje të vazhdueshme, madje mund të themi se Kina është një nga partneret e dyta më të mëdha tregtare që ka Shqipëria. Në mars të vitit 2017, shohim se ka pasur një rritje të eksporteve të Shqipërisë në Kinë. Rritja vjetore ka qenë nga 6.3% deri në 7.8%, një rritje e cila ka kaluar Greqinë, Turqinë dhe shumë vende të tjera të Ballkanit. (INSTAT 2017; Musabelliu, 2020). Nga ana tjetër, Kina është shndërruar në një nga vendet më të rëndësishme për sa i përket investimeve të huaja direkte në Shqipëri. Sipas Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), investimet kineze po luajnë një nga rolet më nxitëse të punësimit, të shtimit dhe të mbledhjes së taksave, duke rritur kështu dhe normën e aftësive profesionale që punonjësit vendorë duhet të kenë për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë. Nëse do të bënim një analizë të profilit të kompanive të ndryshme kineze që kanë investuar në Shqipëri, do të shihnim që deri në janar të vitit 2017, në total janë regjistruar 148 kompani kineze, ku 103 prej tyre janë aktive. Kompanitë me kapitale kineze janë të përqendruara më së shumti në qarkun e Tiranës dhe të Durrësit, pasi gjithë veprimtaria kryesore e bizneseve në Shqipëri është e bazuar në këto qytete. S’mund të lëmë pa përmendur dhe praninë e dy kompanive shumë të fuqishme kineze, të

cilat janë regjistruar në Shqipëri vitet e fundit: “China Everbright” dhe “Geo-Jade”, të cilat operojnë në fushën e naftës, e njëjta fushë ku vite më parë vepronte “Bankers Petroleum”. Përveç investimeve të shumta, këto kompani kanë pasur dhe ndikime në punësim dhe në trajnimin e punonjësve të ndryshëm shqiptarë (Invest-In-Albania, 2015). Në fakt, ky proces është më se normal, pasi çdo investitor përveç pjesës investuese ka ndikim të madh edhe tek rritja e punësimit, e kualifikimit dhe aftësimin profesional. Nëse do të bënim një analizim të prirjes së tregut që kanë kompanitë kineze, ato në Shqipëri nuk janë vetëm si importuese mallrash, por janë pasi janë rritur së tepërmi pjesa e importit të makinerive dhe të pajisjeve. Pra, përveç punësimit, vihet re dhe një rritje e njohurive teknike të punonjësve shqiptarë. Meqenëse Shqipëria është një vend i vogël, normalisht dhe tregu është i vogël, por kjo s’do thotë që kompanitë kineze do të investojnë vetëm në Shqipëri. Një nga idetë është që të importohen produktet në Shqipëri dhe të eksportohen në vendet e tjera. Gjithashtu, shohim se kompani të ndryshme kineze kanë shprehur interesim për të bërë investime në fusha të ndryshme, siç mund të përmendim: në infrastrukturë, në rrugët, në hekurudhat e ndryshme, në energjetikë dhe industrinë përpunuese, etj. Kur themi industri përpunuese, nuk është domosdoshmërisht e thënë që të prodhojnë dhe të shesin në Shqipëri, ideja kryesore është që produktet të prodhohen në Shqipëri dhe të eksportohen në tregjet e Evropës. Kjo pasi produkti do të ketë një kosto më të ulët, tregjet do të jenë më afër, për shkak të pozicionit gjeografik që ka vendi ynë dhe për shkak të marrëveshjeve tregtare të lira që Shqipëria ka me vendet e Evropës dhe Ballkanit.

Në ditët e sotme po vërehet një trend rritës, ku kompanitë kineze po përqendrohen që ta shtrijnë kapitalin e tyre në Shqipëri dhe në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, duke zëvendësuar partnerët tradicionalë evropianë. (Mardell, 2020). Kina, si ekonomia numër dy e botës, po përpiket të investojë në pasuri strategjike me kompani të cilat në shumicën e rasteve janë në pronësi të vet qeverisë, të cilat propagandojnë vetveten në arenën evropiane për potencialitetin dhe aftësitë e tyre. Në dekadën e fundit, Kina është shndërruar në një nga partnerët më të rëndësishëm ekonomikë të Shqipërisë, ku kompani të rëndësishme të saj si “Geo-Jade Petroleum” po eksplorojnë rrugë të reja për investime afatgjata.

Investimet dhe marrëdhëniet ndërmjet Kinës dhe Shqipërisë janë jetike për ecjen përpara të ekonomisë tonë. Shteti shqiptar, duke parë qasjen dhe trendin e investimeve të huaja, po punon për të krijuar lehtësira ligjore, duke shtuar apo ndryshuar ligje dhe miratuar politika tatimore, të cilat synojnë uljen e korrupsionit dhe eliminimin e procedurave burokratike.

Gjithashtu, edhe qeveria e Kinës po nxit me grante fermerët shqiptarë për rritjen e volumit të punës, si dhe blerjen e pajisjeve të reja. Investimet kineze janë një plotësues i mirëpritur me qëllim afatgjatë, i mbështetur nga një konsensus i gjerë ndërpartiak në vend. Shqipëria mbetet një nga vendet më pak të zhvilluara në Evropë, megjithëse, ajo ka bërë përmirësime në rritje dhe tani është më pak e varur nga ndihma e huaj. (Mikhalyova, 2016).

Integrimi i vonuar i vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian ka rritur vulnerabilitetin e këtyre vendeve ndaj ndikimit ekonomik të Kinës, po ashtu krahas Turqisë, (Ikenberry, 2008). Ndërkohë, duhet pranuar se Shqipëria është një vend shumë i vogël në raport me interesat ekonomike të Kinës, por me një pozicion gjeografik tepër të favorshëm, me porte të shumta, që i ofron avantazhe të konsiderueshme krahasuar me vendet e tjera në rajon. Në këtë mënyrë, Shqipëria ofron një rrugë përmes së cilës Kina mund të hyjë jo vetëm në tregjet e Bashkimit Evropian, por edhe në tregjet e tjera rajonale. (Parlamenti Evropian, 2018).

Interesat ekonomike kineze janë të qarta, pavarësisht se vendet e Bashkimit Evropian janë konsideruar si partnerët më të rëndësishëm ekonomikë, ndërsa vendet e Ballkanit vetëm si një urë që lejon lëvizjen përtej kapitalit dhe mallrave të saj. (Ikenberry, 2008). Është fakt se Kina po zgjerohet gjithnjë e më shumë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, me një potencial të madh ekonomik, duke konkurruar fuqishëm aktorët e tjerë në rajon, si Bashkimi Evropian, Rusia dhe Turqia. Të gjitha këto vende kanë interesa të rëndësishme në këtë rajon dhe për këtë arsye “lufta për territorin” është jashtëzakonisht e fortë. (Martino, 2017).

Edhe pse Kina është përpjekur të imponohet në Ballkanin Perëndimor, posaçërisht në Shqipëri, ndikimi i saj ka qenë kryesisht në aspektin ekonomik, megjithëse ka elemente që nuk e favorizojnë në raport me “konkurrentët” e tjerë, perëndimorë dhe joperëndimorë, në

këtë rajon. Distanca gjeografike dhe diferenca në aspektet kulturore mes dy vendeve, shpjegojnë ndikimin e dobët të Kinës në dimensionet politike apo kulturore në Shqipëri.

KAPITULLI IV: METODOLOGJIA

4.1. Përzgjedhja e metodologjisë së studimit

Krahas ndarjes tradicionale në metodologji cilësore e metodologji sasiore, artikujt me faktorë impakti botuar së fundmi në revistat shkencore po përdorin gjithmonë e më shumë metodën e kombinuar. Në këtë kuadër, fryma e përgjithshme ndaj qasjeve të pastra metodologjike, në dy dekadat e fundit, priret drejt një zbehjeje gjithnjë e më të theksuar të dallimeve mes metodologjive sasiore dhe atyre cilësore. (Schwandt, 2006). Në të vërtetë, metoda e kombinuar është rasti më i mirë për të treguar se qasja sasiore dhe ajo cilësore nuk janë në kundërshti me njëra-tjetrën, përkundrazi ato janë komplementare të njëra-tjetrës. Kjo qasje metodologjike lejon shfrytëzimin e pikave më të forta të secilës qasje metodologjike, për të kuptuar çështjen specifike me interes shkencor. Pra, metodologjia e kombinuar lejon një hulumtim të problematikës shkencore nisur nga perspektiva të ndryshme, të cilat synojnë të kuptuarin e problematikës. Nga ana tjetër, të dyja qasjet së bashku kompensojnë përkufizimet e njëra-tjetrës, duke lejuar konkluzione shkencore më të besueshme. (Johnson, Oneuegbuzie, & Turner, 2006).

Sipas Sechrest dhe Sidana (1995), dy prej arsyeve kryesore për të mbështetur përzgjedhjen e një metodologjie të kombinuar përfshijnë:

1. Verifikimin e rezultateve të hulumtimit: Pra, nëse dy rrugë të ndryshme të çojnë në konkluzione të njëjta ose të ngjashme, ky rezultat është shkencërisht më i besueshëm.

2. Reduktimin e gabimeve në matje: Duke pranuar se në çdo matje të mundshme ekziston marzhi i gabimit, i mëshohet faktit se përdorimi i më shumë se një lloj instrumenti matës (p.sh. pyetësor kundrejt intervistës) redukton konsiderueshëm cakun e gabimit.

Pra, përdorimi i metodologjisë së kombinuar lejon krijimin e një baze të dhënash më të pasur dhe më të plotë, duke rritur besueshmërinë në nxjerrjen e konkluzioneve shkencore.

Përveç avantazheve të përgjithshme të metodës së kombinuar, të sipërcituara, ky studim ka përzgjedhur këtë qasje nisur edhe nga tematika specifike e hulumtimit. Matja e perceptimit (pavarësisht nga tematika) përfaqëson një sfidë të rëndësishme, sidomos në nivelin e ndërtimit të instrumentit matës. Në këtë kontekst, metodologjia cilësore është mjaft e përshtatshme për faktin se lejon një hulumtim të detajuar të çështjes, duke dhënë një pasqyrë të qartë të botës subjektive të individit. Përgjithësimi i rezultateve përtej kampionit të

marrë në hulumtim përbën një aspekt mjaft të rëndësishëm, sidomos për sa i përket implikimeve apo rekomandimeve të lidhura me gjetjet. Nga ana tjetër, një pyetësor sasior, i cili mat perceptimet në shkallë Likert (1-5), jep mundësinë e të kuptuarit të trendit në një kampion deri diku përfaqësues së popullatës, madje mund të lejojë edhe disa konkluzione përgjithësuese, gjithsesi rezultatet sasiorë japin thjesht një pasqyrë të realitetit pa lejuar shpjegimin/interpretimin në thellësi të arsyes. Në përmbledhje, metodologjia e kombinuar, e cila vlerëson perceptimet nga një qasje sasiorë, por edhe cilësore, u konsiderua e përshtatshme për studimin në fjalë.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë orientimin gjeostrategjik të Shqipërisë nën ndikimin e SHBA-së dhe BE-së nga njëra anë, si dhe Rosisë, Turqisë dhe Kinës, nga ana tjetër, gjithë duke shqyrtuar dimensionet ekonomike, politike dhe social-kulturore.

Në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi, objektivat kryesore janë:

- a) Analizimi dhe identifikimi i ndikimit të fuqive joperëndimore me fokus në dimensionet: ekonomike, politike dhe social-kulturore.
- b) Vlerësimi i ndikimit të vendeve aleate të Shqipërisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian.
- c) Paraqitja e një analizë vlerësuese të ndikimeve të këtyre vendeve në nivel rajonal.
- d) Matja e perceptimit të ndikimit të këtyre vendeve nga dy grupe të ndryshme, ekspertë të fushës dhe studentë.

Pyetja kërkimore: A është zhvendosur orientimi gjeostrategjik properëndimor i Shqipërisë nën ndikimin e vendeve joperëndimore?

Hipoteza: Ndikimi i Turqisë, Rosisë dhe Kinës nuk e ka zhvendosur orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë.

4.2. KAMPIONIMI

Në funksion të përmbushjes së qëllimit të këtij punimi shkencor, sikurse është përcaktuar edhe në objektivat e tij, kampionimi është i përbërë nga dy grupe, me karakteristika të ndryshme. *Grupi i parë* përbëhet nga të rinj të angazhuar në forumet politike, dhe të rinj të paangazhuar politikisht. Arsyeja e përzgjedhjes së të rinjve të angazhuar pranë forumeve politike, ka të bëjë me faktin se kjo kategori, ka një interes më të shtuar në lidhje me ngjarjet politike në vend dhe jashtë saj. Sa i takon studenteve të paangazhuar politikisht, ata janë përzgjedhur për të pasur një pasqyrë më të plotë të kësaj grupmoshe. *Grupi i dytë*, përbëhet nga ekspertë të fushave të ndryshme të cilët kanë eksperiencë konkrete në çështjet që janë zgjedhur për studim. Ekspertët janë përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme, sipas profilit akademik, përfaqësimit politik, dhe njohjes së mirë të politikës së jashtme.

4.2.1. Kampioni sasior

Studimi përbëhet nga një kampionim i përgjithshëm prej 500 pjesëmarrësish: 254 femra dhe 246 meshkuj të moshës ndërmjet 17 dhe 34 vjeç, me një moshë mesatare prej 23.84 (SD = 3.53) (Shih Tabelën 1. Shpërndarja gjinore e kampionit). Për sa i përket statusit të punësimit, 38.6% e kampionit ishin studentë, 46.6% ishin të diplomuar dhe të punësuar, ndërsa 17.9% ishin të diplomuar, por të papunë (Shih Tabelën 2. Shpërndarja e kampionit sipas statusit të punësimit).

Ky studim është ndarë në dy faza kampionimi:

Në fazën e parë të punimit janë përzgjedhur 304 të rinj, të angazhuar në forumet politike të FRESSH-it, FRPD-së dhe LRI-së, prej të cilëve u përgjigjën 241 ose 78.9%. Këta të rinj supozohet të jenë vendimmarrësit e së ardhmes; kjo perspektivë do të ballafaqohet me atë të profesionistëve të fushës (intervistat cilësore), për të parë nëse takohen perceptimet në lidhje me problematikën studimore. Përzgjedhja e pjesëmarrësve u bë në mënyrë rastësore, duke iu referuar regjistrave të organizatave politike, por meqenëse pyetësi u shpërnda online, kufizimi i vetëm i kampionimit është vetë-seleksionimi (78.9 % shkalla e përgjigjeve). Për sa i përket anëtarësisë nëpër forumet politike, kampioni u nda si më poshtë: 57.1% i përkisnin FRESSH-it (Forumi Rinor Eurosocialist i Shqipërisë), 40.7% FRPD-së (Forumi Rinor i Partisë Demokratike) dhe 2.1% LRI-së (Lëvizja Rinore për Integrim) (Shih Tabelën 3).

Në fazën e dytë, kampionimi u zgjerua më tej, duke përfshirë një grup intervistuesish më të rinj, kryesisht studentë, por të paangazhuar politikisht. Të përzgjedhur gjithsej janë 324 të rinj, nga të cilët u përgjigjën 259 ose 79.9% (shkalla e përgjigjeve). Të rinjtë u përzgjedhën nga auditorët e universiteteve të Tiranës dhe të universitetit të Durrësit. Pyetësi u shpërnda nëpërmjet adresave të postës elektronike (e-mail) dhe formave të tjera të komunikimit online.

Tabela 1.

Shpërndarja e kampionit sipas gjinisë

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
E vlefshme	Femra	254	50.8	50.8	50.8
	Meshkuj	246	49.2	49.2	100.0
	Gjithsej	500	100.0	100.0	

Tabela 2.

Shpërndarja e kampionit sipas statusit të punësimit

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
E vlefshme	Student	193	38.6	38.6	38.6
	Diplomuar/Punësuar	218	43.6	43.6	82.1
	Diplomuar/Papunë	89	17.9	17.9	100.0
	Gjithsej	500	100.0	100.0	

Tabela 3.**Shpërndarja sipas llojit të forumit politik**

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
E vlefshme FRESSH	138	57.1	57.1	57.1
FRPD	98	40.7	40.7	97.9
LRI	5	2.1	2.1	100.0
Total	241	100.0	100.0	

4.2.2. Kampioni cilësor

Për realizimin e intervistave cilësore u përzgjedhën 6 ekspertë të fushës, të cilët kanë eksperiencë konkrete në çështjet që janë zgjedhur për studim. Ekspertët janë përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme, sipas kriterëve të mëposhtme:

1. *Profili akademik.*
2. *Aktorë politikë të nivelit të lartë që përfaqësojnë të gjithë spektrin politik.*
3. *Njohës të politikës së jashtme.*

Prof. Dr. Arben Malaj ka një karrierë të spikatur si politikan dhe si studiues. Mban gradën Prof. Dr. në Shkencat Ekonomike në Universitetin e Tiranës dhe është lektor i jashtëm i Fakultetit Ekonomik. Është autor dhe bashkautor i shumë publikimeve dhe artikujve shkencorë. Arben Malajt i është akorduar titulli “*Honoris Causa*” nga Akademia Ndërkombëtare për Tregjet në Zhvillim, Nju Jork -SHBA dhe njëkohësisht është anëtar nderi i kësaj akademie. Po ashtu, ai ka mbajtur një sërë leksionesh në disa prej qarqeve akademike në Evropë, si në Universitetin e Bocconit në Itali, në Universitetin e Bumbergut në Gjermani, në Universitetin e Prishtinës, në Universitetin e Tetovës, në Casa NATO në Bukuresht të Rumanisë, Komiteti i Breton Woods. Karriera politike e Profesor Malajt ka kapur nivelet më të larta të hierarkisë drejtuese të Partisë Socialiste të Shqipërisë, ku ka mbajtur pozicionin e anëtarit të kryesisë, po ashtu edhe në Ekzekutiv, ku ka shërbyer tri herë si Ministër i Financave dhe Ekonomisë, në periudha të ndryshme: në vitin 1997-98, 2002-2003 dhe 2003-2005.

Prof. Asoc. Dr. Selami Xhepa është President i Universitetit European të Tiranës. Gjithashtu, ai është menaxher kërkimesh në Qendrën Shqiptare për Tregun Ndërkombëtar. Ka qenë Shefi Ekonomik i Departamentit Kërkimor në Bankën e Shqipërisë, Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja, si dhe pedagog i Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tiranës. Po ashtu, Prof. Asoc. Dr. Selami Xhepa ka qenë deputet i Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë.

Prof. Asoc. Dr. Grida Duma është doktoruar në Shkencat Ekonomike pranë Universitetit të Tiranës, ku ka qenë gjithashtu edhe lektore dhe, më pas, Shefe e Departamentit të Sociologjisë të Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës. Gjithashtu ka qenë eksperte, udhëheqëse dhe konsulente e një sërë projektesh në fushën e arsimit të organizatave dhe fondacioneve që veprojnë në Shqipëri, si OSBE dhe Fondacioni “Soros”. Prof. Asoc. Dr. Grida Duma ka kryer funksionin e Zëvendësministres së Integritimit për një periudhë gati dyvjeçare. Aktualisht mban pozicionin e Sekretares së Marrëdhënieve me Publikun në Partinë Demokratike.

Prof. Dr. Ylljet Aliçka ka dhënë një kontribut të veçantë në diplomacinë e vendit, duke shërbyer si Ambasador i Shqipërisë në Francë, Portugali, Monako dhe UNESCO, përfaqësues personal i Presidentit të Republikës pranë Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë 2007-2013. Aktualisht është Profesor pranë Universitetit European të Tiranës dhe Universitetit të Arteve në Tiranë.

Klajda Gjoshja është diplomuar në Mbretërinë e Bashkuar, në drejtimin e Studimeve Evropiane. Ka shërbyer si Ministre e Integritimit Evropian, me një rol të spikatur në përshpejtimin e proceseve integruese të Shqipërisë në BE.

Dr. Gentian Elezi është diplomuar në drejtimin Marrëdhënie Ndërkombëtare, ka marrë gradën “Doktor” në fushën e Politikave Evropiane, më pas ka shërbyer si Zëvendësministër i Integritimit Evropian në kabinetin e Qeverisë Rama, njëkohësisht është lektor në Universitetin e Tiranës. Veprimtaria e tij spikat si ekspert në proceset e integritimit evropian.

4.3. Instrumenti matës

4.3.1. Instrumenti sasior

Instrumenti matës është pyetësi vetë-raportues me 12 pyetje, i ndërtuar me qëllim vlerësimin dhe krahasimin e perceptimeve të ndikimit BE-SHBA përballë vendeve joperëndimore: Rusi, Turqi dhe Kinë në Shqipëri. Seksioni i parë i pyetësorit përbëhet nga informacione demografike, të tilla si mosha, gjinia, statusi i punësimit, anëtarësimi në forume politike etj. Pyetësi është ndërtuar me shkallën Likert, e cila konsiderohet si forma më e përshtatshme për matjen e perceptimeve (qëndrimeve) përmes instrumenteve sasiorë. Shkalla Likert lejon konkluzione më të sakta në lidhje me nivelin e dakordësisë, apo fortësinë e qëndrimeve të raportuara nga pjesëmarrësit, sesa instrumentet e dikotomisë të tipologjisë “PO” ose “JO”. Pra, përdorimi i kësaj shkalle lejon larmi më të gjerë në përgjigjet e pjesëmarrësve. Në studimin në fjalë u përdor shkalla nga 1 në 5, ku: 1 = aspak, 2 = pak, 3 = disi, 4 = të konsiderueshme dhe 5 = shumë.

Qëndrimi i pjesëmarrësve, në lidhje me sfidat më të rëndësishme me të cilat përballet Shqipëria sot, u vlerësua me 1 pyetje, e cila adresonte: 1. Mungesën e vizionit politik; 2. Ndikimin e vendeve joperëndimore; 3. Krimin e organizuar; 4. Ekstremizmin e dhunshëm. Vlerësimi i ndikimit të tri dimensioneve përbëhej nga *Ndikimi Ekonomik*, *Ndikimi Politik* dhe *Ndikimi Socio-Kulturor* i SHBA-së, BE-së, Rusisë, Turqisë dhe Kinës në Shqipëri. Së fundmi, pyetësi vlerëson gjithashtu edhe qëndrimet e pjesëmarrësve në lidhje me influencën e Rusisë, Turqisë dhe Kinës, si barriera të mundshme ndaj integritit evropian. Pyetësi është ndërtuar dhe administruar përmes Platformës Online të “Google Forms”.

4.3.2. Instrumenti cilësor

Për qëllimin e studimit u përdor një pyetësor me pyetje të hapura. Përdorimi i këtij instrumenti garanton një proces të standardizuar në mbledhjen e të dhënave me natyrë cilësore, gjatë të cilit çdo pjesëmarrës i përgjigjet të njëjtit set pyetjesh, të paraqitura në të njëjtin rend. Gjithashtu, ky pyetësor lejon hulumtimin e saktë, specifik dhe të fokusuar, të çështjeve për të cilat kërkuesi është i interesuar drejtpërsëdrejti. Ky instrument cilësor, i përdorur së bashku me pyetësin sasior, lejon thellim të mëtejshëm në analizën e çështjeve studimore, duke dhënë një tjetër perspektivë plotësuese në të kuptuarit e problematikës studimore.

Gjithashtu, duke pasur parasysh se të intervistuarit janë ekspertë në fushat përkatëse, me njohuri absolutisht të gjera mbi subjektin, përzgjedhja e pyetësorit me pyetje të hapura, por specifike, garanton përqendrimin në tematikat përkatëse, duke ulur shanset për shmangie apo shpërndarje në drejtime, të cilat nuk kanë rëndësi qendrore për studimin.

Për këtë arsye, pyetësi u ndërtua mbi bazën e 5 pyetjeve. Pyetjet u adresohen të njëjtave çështje, të cilat gjithashtu përmenden paralelisht tek instrumenti sasior. Kështu, në përputhje me udhëzimet mbi ndërtimin e një pyetësi cilësor, u fillua nga pyetjet e ndërtuara me diapazon më të gjerë (të cilat e pozicionojnë pjesëmarrësin në kontekstin e studimit) drejt pyetjeve më specifike, që çojnë drejt esencës së problematikës së trajtuar. Si rrjedhim, pyetja e parë dhe e dytë, janë relativisht të përgjithshme, në përpjekje për të vendosur kontekstin ku do të realizohet më vonë pjesa më specifike e pyetësorit: Pyetja 1: “Si e vlerësoni rolin e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor (si aktor politik rajonal)?”; Pyetja 2: “Në pikëpamjen tuaj, cilat janë sfidat më të rëndësishme me të cilat po përballet Shqipëria sot (kemi parasysh kursin politik brenda dhe jashtë vendit)?”.

Duke filluar nga pyetja e tretë, fokusi zhvendoset në mënyrë më specifike mbi problematikën e studimit. Në fakt, pyetja e 3-të kërkon një vlerësim mbi ndikimin e vendeve perëndimore në Shqipëri: “Si e vlerësoni ndikimin e vendeve perëndimore SHBA-BE në Shqipëri?”. Së fundmi, pyetjet 4 dhe 5 fokusohen mbi perceptimet në lidhje me impaktin specifik të Turqisë, Kinës dhe Rusisë në Shqipëri. Pyetja 4: “Si e vlerësoni ndikimin e Rusisë/Turqisë/Kinës në Shqipëri?” dhe Pyetja 5: “Sipas jush, cila nga këto tre shtete (Turqi, Rusi, Kinë) ka ndikimin më të madh në Shqipëri në aspektin ekonomi, politikë, art/kulturë?”.

4.4. Procedura e studimit

Ky studim është kryer në dy faza. Në fazën e parë, janë identifikuar dhe përzgjedhur të rinj anëtarë të tri forumeve kryesore politike në vend. Në fazën e dytë, pjesëmarrësit janë përzgjedhur nga auditorët universitarë, përkatësisht studentë të Universitetit të Tiranës dhe universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Aksesimi i të rinjve anëtarë të forumeve politike është bërë nisur nga të dhënat e regjistrave të anëtarësisë së tyre në forumet përkatëse, ndërsa grupi i dytë i të intervistuarve është bërë i mundur përmes adresave të postës elektronike të administruara në bazën e të dhënave të universitetit, sigurisht duke marrë paraprakisht pëlqimin e tyre për këtë studim.

Në të dyja fazat, pyetëtori u është dërguar nëpërmjet një linku me e-mail, si dhe është shpërndarë përmes rrjeteve sociale si WhatsApp dhe Viber.

Aspekti cilësor i punimit është realizuar përmes pyetësorit me pyetje të hapura. Pyetësorët u janë dërguar me postë elektronike gjashtë ekspertëve të përzgjedhur, të cilët kanë dhënë përgjigjet e tyre me shkrim dhe i kanë dërguar ato përmes postës elektronike (e-mail).

4.5. Kufizimet metodologjike

Kufizimet metodologjike lidhen përkatësisht me kampionimin, procedurën e ndjekur, si dhe instrumentet matëse.

Për sa i përket kampionimit, kufizimi konsiston në mos përfaqësimin 100% të grupeve të të intervistuarve shoqërorë, pasi ata janë përzgjedhur nga anëtarësia e forumeve të partive politike dhe kategoria studentore. Përbërja e kampionimit në fazën e parë të studimit, nuk është përfaqësuese e popullatës së anëtarëve të forumeve politike (ku forumi rinor LRI, është i nënpërfaqësuar në këtë kampionim, në raport me dy forumet e tjera politike: FRESSH dhe FRPD). Në fazën e dytë të studimit, kufizimi i kampionimit është në përzgjedhjen e grupit të të intervistuarve, grup që është pjesë përbërëse vetëm e dy universiteteve: universiteti i Tiranës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (pavarësisht faktit se përfaqësojnë dy universitetet më të mëdha në vend).

Pavarësisht kufizimeve të sipërpërmendura, vlen të nënvizojmë se kampioni në total prej 500 pjesëmarrësish përfaqëson një numër të konsiderueshëm të rinjsh të anketuar, gjë e cila lejon që analiza dhe rezultatet statistikore të kenë një cak të ulët gabimi (besueshmëri të lartë).

Sa i takon procedurës, u ndoq mënyra e shpërndarjes së pyetësorit realizuar në formë elektronike (online), gjë e cila nuk i lejon studiuesit të ketë një nivel të kënaqshëm kontrolli tek të anketuarit, por edhe sa i përket mbarëvajtjes së procesit në tërësi.

Sa i takon kufizimeve të hasura në metodologjinë cilësore, përmendim kufizimin në thellimin e mëtejshëm të përgjigjeve dhe argumenteve të dhëna nga i intervistuari, përkundër marrjes në pyetje ballë për ballë.

Për sa i takon instrumenteve që janë përdorur, rendisim numrin e kufizuar të pyetjeve, rrjedhimisht mungesën e mbulimit të plotë të çështjeve për të cilat janë përgjigjur të intervistuarit.

Nga ana tjetër, ky numër pyetjesh është përzgjedhur edhe për arsye praktike, pasi një numër më i madh pyetjesh do të rrezikonte humbjen e fokusit ndaj çështjeve me interes dhe do të rriste ndjeshëm mundësinë e mospërgjigjeve (shkalla e përgjigjeve/response rate) ose përgjigjeve jo cilësore.

Me gjithë numrin e kufizuar të pyetjeve, ato janë orientuar drejt çështjeve esenciale dhe i është mëshuar faktit për të nxjerrë konkluzionet më të domosdoshme.

KAPITULLI V: ANALIZA SASIORE DHE CILËSORE

Ky kapitull është organizuar në dy pjesë kryesore: pjesa e parë përmban analizën sasimore, ndërsa pjesa e dytë analizën cilësore.

5.1. Analiza sasimore

Të dhënat sasimore u analizuan përmes programit SPSS, u përdorën analiza përshkruese (deskriptive) dhe inferenciale.

5.1.2. Sfidat aktuale të Shqipërisë

Analiza deskriptive në lidhje me sfidat kryesore, me të cilat përballet vendi paraqiten në tabelat e mëposhtme. Tabelat 4-7 tregojnë shpërndarjen e përgjigjeve të kampionit në lidhje me sfidat e ndryshme të vendit. Sfida e parë: *Mungesa e vizionit politik*, tregon shpërndarjen e mëposhtme në përgjigje (Tabela 4). Sikundër vërehet mbi 1/3 e kampionit, 36.4% mendojnë se mungesa e vizionit politik përbën një sfidë mjaftueshëm/shumë të rëndësishme për Shqipërinë.

Tabela 5 tregon shpërndarjen e kampionit në lidhje me *Influencën e vendeve joperëndimore*. Në këtë rast vërehet një shpërndarje mjaft e ndryshme e përgjigjeve të kampionit, ku më shumë se gjysma (51.1%), mendojnë se ky aspekt është pak ose aspak i rëndësishëm.

Tabela 6 paraqet shpërndarjen e përgjigjeve të kampionit në lidhje me *Krimin e organizuar dhe trafiqet ilegale*. Ndryshe nga dy pyetjet pararendëse, në këtë rast mbi gjysma e kampionit (55.7%), mendon se ky aspekt përbën një sfidë mjaftueshëm/shumë të rëndësishme për Shqipërinë.

Së fundmi, për sa i përket *Radikalizmit fetar*, kemi një zhvendosje të konsiderueshme të përgjigjeve në intervalin “pak” ose “aspak” - në fakt 80.7% e kampionit kanë përzgjedhur këtë kah të intervalit (1-2) në përgjigjet e tyre.

Përveç shpërndarjes së përgjigjeve, u vlerësuan gjithashtu edhe vlerat mesatare për secilën prej sfidave. Tabela 8 tregon vlerat mesatare të raportuara për secilën sfidë. Vlera më e lartë e raportuar është për *Krimin e organizuar dhe trafiqet*: $M=3.78$, ($DS=1.25$), e ndjekur nga *Mungesa e vizionit politik*: $M=3.05$, ($DS=1.36$), *Influencia e vendeve joperëndimore*: $M=2.61$ ($DS=1.04$) dhe vlera më e ulët për *Radikalizmin fetar*: $M=1.59$, ($DS=.94$). Më pas, kryerja e

testit inferencial, për të vërtetuar nëse ka apo jo dallime të rëndësishme statistikore (Testi t) nxjerr në pah dallime të rëndësishme statistikore mes katër sfidave ($p < .001$). (Tabela 8.1). Pra, *Krimi i organizuar* cilësohet si sfida më e rëndësishme, ndërkohë që *Radikalizmi fetar* renditet si më pak i rëndësishmi.

5.1.3. SHBA dhe BE: Perceptimet e influencës ekonomike, politike dhe kulturore në Shqipëri

Tabela 9 paraqet mesataret dhe devijimet standarde për influencat e SHBA-së dhe BE-së në dimensionet ekonomike, politike dhe kulturore. Vërehet se vlerat mesatare më të larta janë raportuar në dimensionin politik, i ndjekur nga ai ekonomik dhe, në fund, renditet dimensionin kulturor.

Testet inferenciale për dallimet mes dimensioneve për SHBA-në dhe BE-në të marra më vete, kanë treguar diferenca statistikisht të rëndësishme si në rastin e SHBA-së, ashtu dhe BE-së (Tabelat 10 dhe 11). Kështu, në të dyja rastet, dimensionin me mesataren më të lartë është dimensionin politik: $M_{BE:POL} = 3.45$, $DS = 1.14$; $M_{SHBA:POL} = 3.44$; $DS = 1.22$. I dyti renditet dimensionin ekonomik: $M_{BE:EKO} = 3.10$, $DS = 1.18$; $M_{SHBA:EKO} = 3.00$; $DS = 1.26$; dhe i treti dimensionin kulturor: $M_{BE:KUL} = 2.20$, $DS = 1.11$; $M_{SHBA:KUL} = 2.04$; $DS = 1.01$. Testi t (paired samples) i administruar më pas (Tabela 12) tregoi se nuk ka dallime statistikisht të rëndësishme mes raportimit të influencave të perceptuara të SHBA-së dhe BE-së në asnjërën nga tri dimensionet, çka është e dukshme dhe në vlerat e mesatareve të raportuara më lart.

5.1.4. Turqia, Rusia, Kina: Perceptime të influencës ekonomike, politike, kulturore në Shqipëri

Analiza të mëtejshme inferenciale janë kryer për të kuptuar gjithashtu dimensionet e influencës (ekonomike, politike, kulturore) për Turqinë, Rusinë dhe Kinën. Rezultatet e testit-t treguan se ka dallime të rëndësishme statistikore në perceptimet e këtyre tri dimensioneve për sa i përket Ruisë (Tabela). Kështu, influenca e Ruisë perceptohet më e fortë në dimensionin politik ($M = 3.07$, $DS = 1.17$), i cili ndiqet nga ai ekonomik ($M = 2.54$, $DS = 1.05$) dhe, në fund, dimensionin kulturor ($M = 1.74$, $DS = .85$).

Po ashtu, analizat inferenciale për Turqinë treguan dallime të rëndësishme statistikore mes tri dimensioneve ($p < .001$) (Tabela 14.1.), por në dallim me Rusinë ndikimi më i madh turk

perceptohet në nivelin ekonomik: $M=3.51$, ($DS=1.20$), ndjekur nga dimensionin politik: $M=3.27$, ($DS=1.18$) dhe, së fundmi, ai kulturor: $M=3.51$, ($DS=1.20$).

Dallime të rëndësishme statistikore u vunë re edhe në rastin e tri dimensioneve të raportuara mbi Kinën (testi t-statistikisht i rëndësishëm, $p<.001$). Kështu, si në rastin e Ruisë, dimensionin me ndikimin më të madh perceptohet dimensionin ekonomik: $M=3.21$, ($DS=1.25$), i ndjekur nga ai politik: $M=2.08$, ($DS=1.05$) dhe, në fund, dimensionin kulturor: $M=1.76$, ($DS=.90$).

Përveç krahasimeve brenda shteteve, teste inferenciale u përdorën gjithashtu për krahasime mes shteteve sipas dimensioneve të caktuara. Testi t tregon dallime statistikore të rëndësishme mes këtyre 3 vendeve në dimensionin ekonomik ($p<.001$), ku në vendin e parë renditet Turqia e perceptuar si vendi me influencën më të lartë: $M=3.51$, ($DS=1.12$), e ndjekur më pas nga Kina: $M=3.21$, ($DS=.1.12$) dhe në fund nga Rusia: $M=2.54$, ($DS=1.06$). Vlen të theksohet gjithsesi, se vlerat e mesatares renditen në mes të intervalit (3-disi), me një zhvendosje të vogël drejt kahut pozitiv në rastin e Turqisë dhe Kinës.

Krahasimet mbi dimensionin politik tregojnë gjithashtu dallime të rëndësishme statistikore mes tri vendeve. Sikundër me dimensionin ekonomik, në vend të parë renditet sërish Turqia: $M=3.27$, ($DS=1.18$), por Rusia kalon në vendin e dytë: $M=3.07$, ($DS=1.17$) dhe Kina renditet e fundit: $M=2.08$, ($DS=1.05$). Gjithsesi, vlen të theksohet se vlerat e mesatares renditet në mes të intervalit (3-disi), me një zhvendosje minimale në rastin e Turqisë.

Së fundmi, për sa i përket dimensionit kulturor, sërish Turqia renditet në vendin e parë: $M=1.74$, $DS=.85$. Mirëpo, influencat kulturore të Kinës dhe Ruisë raportohen mjaft të ngjashme (nuk ka dallime statistikore të rëndësishme mes tyre) ($M_{Kinë}=1.77$; $M_{Rusi}=1.74$). Megjithëkëtë, duhet theksuar se mesataret e raportuara për këtë dimension janë më të ulëta [mes 'pak' (2) dhe 'aspak' (1)], çka do të thotë se perceptimi i përgjithshëm mbi influencën kulturore të këtyre tri shteteve është thujse jothelbësor.

5.1.5. Analiza krahasuese: Turqia përballë SHBA-BE

Analiza krahasuese, në lidhje me perceptimet e influencës ekonomike, politike dhe kulturore të SHBA-së në krahasim me Turqinë, tregoi dallime të rëndësishme statistikore për sa i përket dy dimensioneve (Testi t-paired samples Tabela 19.1.). Kështu, influenca ekonomike dhe ajo kulturore e Turqisë perceptohet krahasimisht më e lartë se SHBA (Vlerat e mesatareve, Tabela 19), ndërkohë që me dimensionin politik nuk ka dallime statistikisht të rëndësishme; influence e këtyre dy vendeve perceptohet e moderuar.

Analiza krahasuese, në lidhje me perceptimet e influencës ekonomike, politike dhe kulturore të BE-së krahasimisht me Turqinë, tregoi rezultate të ngjashme. Pra, ekzistonin dallime statistikore të rëndësishme për sa i përket dy dimensioneve ekonomike dhe kulturore, por jo politike. Në të dyja rastet, influenca e Turqisë raportohet më e lartë krahasimisht me BE-në (mesataret, Tabela 20). Sërish vlerat e mesatareve për dy vendet janë të moderuara, ndërkohë që vlerat më të ulëta raportohen në dimensionin kulturor.

5.1.6. Analiza krahasuese: Kina kundrejt SHBA-BE

Analiza krahasuese, në lidhje me perceptimet e influencës ekonomike, politike dhe kulturore të SHBA-së krahasimisht me Kinën, tregoi dallime statistikore të rëndësishme për sa i përket dy dimensioneve (Testi t-paired samples Tabela 21.1). Mirëpo, në dallim me gjetjet për Turqinë, SHBA-ja raportohet se ka influencë politike dhe kulturore më të lartë se Kina (mesataret, Tabela 21). Ndërkohë vërehet se në dimensionin ekonomik, nuk ka dallime statistikore të rëndësishme; influenca e këtyre dy vendeve raportohet të jetë e ngjashme në këtë dimension.

Rezultate të ngjashme u përftuan nga analiza krahasuese, në lidhje me perceptimet e influencës ekonomike, politike dhe kulturore të BE-së krahasimisht me Kinën. Sërish u gjetën dallime statistikoret të rëndësishme, për sa i përket dy dimensioneve: politike dhe kulturore (Testi t-paired samples Tabela 22.1.). Ndërkohë, sërish vërehet se në dimensionin ekonomik nuk ka dallime statistikore të rëndësishme; influenca e këtyre dy vendeve raportohet të jetë e ngjashme (me vlera të moderuara) në këtë dimension.

5.1.7. Analiza krahasuese: Rusia përballë SHBA-BE

Analiza krahasuese, në lidhje me perceptimet e influencës ekonomike, politike dhe kulturore të SHBA-së krahasimisht me Rusinë, tregoi dallime statistikore të rëndësishme sa i përket të tri dimensioneve (Testi t-paired Samples Tabela 23.1.). Kështu, në dallim me gjetjet e mësipërme, SHBA raportohet se ka influencë politike, ekonomike dhe kulturore më të lartë se Rusia (vlerat e mesatareve, Tabela 23). Gjithsesi, duhet theksuar se vlerat absolute (jo krahasimore) të mesatares janë të moderuara (3/5), madje dhe të ulëta (dimensioni kulturor).

Rezultate të ngjashme u përfytuan nga analiza krahasuese, në lidhje me perceptimet e influencës ekonomike, politike dhe kulturore të BE krahasimisht me Rusinë. Sërish u gjetën dallime statistikore të rëndësishme për sa i përket tri dimensioneve: ekonomike, politike dhe kulturore (Testi t-paired samples Tabela 24.1.). Sikundër në rastin e SHBA-së edhe BE-së, perceptohet se ka influencë më të lartë krahasimisht me Rusinë.

5.1.8. Turqia, Rusia, Kina, si pengesë ndaj integritit evropian

Tabela 25-27 tregojnë shpërndarjen e përgjigjeve të kampionit mbi Rusinë, Turqinë edhe Kinën, si pengesa ndaj integritit evropian të Shqipërisë. Tabela 25 tregon se vetëm 1/5 e kampionit ose 20.7% mendon se Rusia përbën “mjaftueshëm” ose “shumë” pengesë për Shqipërinë në rrugën e integritit evropian. Gjithsesi, kjo është përqindja më e lartë e raportuar në krahasim me dy vendet e tjera. Kështu, në rastin e Turqisë, vetëm 15.7% e kampionit e konsideron si pengesë të mjaftueshme ose të madhe, ndërkohë që raportimet mbi Kinën janë të ulëta, duke arritur nivelin 5% për këto dy kategori (“mjaftueshëm” ose “shumë”). Pra, në terma krahasimorë, duket se Rusia perceptohet si vendi që përbën pengesën më të madhe, e ndjekur nga Turqia dhe në fund Kina.

Për të specifikuar nëse dallimet e vërejtura nga analizat përshkruese kanë apo jo rëndësi statistikore, janë kryer gjithashtu teste inferenciale të dallimeve mes grupeve. Testi t-One Sample vlerësoi perceptimet mbi tri shtetet: Rusi, Turqi dhe Kinë, si pengesa ndaj integritit evropian të Shqipërisë. Sikundër vërehet tek tabelat e mëposhtme, rezultatet tregojnë dallime të rëndësishme statistikore mes grupeve ($p < .001$), ku, sikundër pritej, Rusia raportohet me mesataren më të lartë, e ndjekur nga Turqia dhe në fund Kina.

Për sa i përket dallimeve në raportim bazuar mbi tipologjinë e forumit politik, testi-t (independent samples) nuk arriti rëndësi statistikore ($p > .05$), duke konkluduar se nuk ka

ndryshime në perceptime në varësi të forumit politik. Tabela e mëposhtme tregon mesataret dhe devijimin standard për secilin prej tri shteteve dhe tri dimensioneve, të ndara sipas forumeve politike ku bëjnë pjesë raportuesit.

5.2. Analiza cilësore: Roli i Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor

Të intervistuarit bashkohen në idenë e identifikimit të Shqipërisë si faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon. Z. Xhepa e vë theksin tek roli konstruktiv i saj, duke nënvizuar qasjen dhe kontributin e saj proaktiv ndaj nismave rajonale me karakter ekonomik dhe politik, të cilat kanë për qëllim integrimin e përbashkët të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Deviza e Shqipërisë në politikën e jashtme, tashmë e njohur për publikun e gjerë është: “Zero probleme me fqinjët”, kjo si një busull orientuese në marrëdhëniet e saj diplomatike, e theksuar fort kjo edhe nga linja zyrtare, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropës, së fundmi.

Ndërkohë z. Malaj, po ashtu si kolegu Xhepa, bie dakord për rolin konstruktiv të Shqipërisë në rajon, por ai analizon më tej sfondin (backgroundin) socio-politik të saj, mandej rendit avantazhet e Shqipërisë në raport me fqinjët. Shqipëria asnjëherë nuk ka pasur probleme etnike, apo fetare. Mbi të gjitha z. Malaj e konsideron rolin e Shqipërisë në rajon si *pozitiv* dhe *në rritje*, duke përmendur mentalitetin kulturor të hapur në kontrast me nacionalizmin e *sëmurë*, që mund të kenë vende të caktuara në rajon, siç shprehet ai.

Ndërsa znj. Duma, po ashtu si dy kolegët Malaj e Xhepa, nënvizon rolin konstruktiv të Shqipërisë në rajon, nga ana tjetër, ajo i mëshon rrezikut të *qasjeve populiste* të politikanëve, si faktor dëmtues i perspektivës jo vetëm të Shqipërisë, por edhe të rajonit. Një risk tjetër që vihet re në përgjigjen e znj. Duma, është *qasja nacionaliste*, që po ashtu nënvizohet si problem në diskursin politik lokal e po ashtu rajonal.

Z. Elezi në përgjigjen e tij thekson, njëlloj si kolegët e tij, rolin pozitiv dhe konstruktiv të Shqipërisë në rajon, përgjatë dy dekadave. Këtë qasje ai e lidh kryesisht me qëndrimet mbështetëse ndaj Kosovës, në sfidat për rritjen dhe njohjeve të saj në arenën ndërkombëtare dhe konsolidimin e shtetit ligjor, gjë e cila është interpretuar jo pozitivisht nga fqinjët sllavë, duke i quajtur deklarata të cilat nuk kontribuuan në stabilitetin rajonal.

Znj. Gjosha, nga ana tjetër, i bashkohet analizës së kolegëve, ku Shqipëria luan një rol pozitiv në rajon. Gjithashtu, ajo nënvizon dhe një vlerë të shtuar të Shqipërisë: modelin e bashkëjetesës fetare.

Z. Aliçka në intervistën e tij vlerëson, si kolegët e tjerë, rolin e Shqipërisë si faktor stabiliteti dhe paqeje në rajon, por, nga ana tjetër, ndryshe nga kolegët, në analizën e tij theksin e vendos tek roli dhe përgjegjësia e Tiranës zyrtare, në raport me interesat e shqiptarëve që banojnë në trojet shqiptare, të ndarë në pesë shtete të Ballkanit, e cila kërkon një rol më të spikatur të Shqipërisë për të mbrojtur dhe promovuar këto interesa.

Si përfundim, qasjet e të intervistuarve janë të drejta, kur ata i referohen Shqipërisë si faktor paqeje dhe stabiliteti. Bashkëjetesa fetare është një tjetër vlerë, që e veçon Shqipërinë nga vendet e tjera të rajonit, e cila theksohet nga të intervistuarit. Një tjetër shembull për t'u përmendur, është mbështetja që Shqipëria i dha popullit të Kosovës gjatë luftës në vitet 1998-1999 me serbët, kur ajo hapi dyert për më shumë se 500.000 shtetas kosovarë, të cilët u larguan nën terrorin dhe represionin ushtarak serb. Një element tjetër është historia e vendit tonë, ku Shqipëria në asnjë rast dhe asnjëherë nuk ka cenuar integritetin territorial të shteteve fqinjë, apo të ketë pasur qasje shoviniste ndaj tyre në 110 vjet të ekzistencës së saj si shtet sovran.

Nga ana tjetër, edhe në raport me sfidat dhe perspektivat aktuale të rajonit, Shqipëria ka dëshmuar një rol tejet konstruktiv, duke mos u bërë pengesë për asnjë vend të veçantë në rajon, përkundrazi, ajo ka bërë apel për dialog (referuar çështjes Kosovë-Serbi) për arritjen e një marrëveshjeje të pranuar nga dy palët dhe po ashtu ndërkombëtarisht.

5.2.1 Analizë: Sfidat e Shqipërisë

Z. Xhepa, pyetjes se cilat identifikon si sfidat më të rëndësishme me të cilat po përballlet Shqipëria, rendit si problematika kryesore luftën ndaj korrupsionit, mungesën e një sistemi funksional organizativ të shtetit, mungesën e institucioneve të pavarura, shërbimeve publike pa standarde të pranueshme, elemente të cilat minojnë rrugën e Shqipërisë në përmbushjen e sfidave kombëtare dhe atyre ndërkombëtare. Nga ana tjetër, z. Xhepa vë theksin edhe tek probleme të tjera, të cilat po ashtu përbëjnë pengesë në nxitjen e ekonomisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj, si kultivimin e lëndëve narkotike, aktivitetin kriminal që pason kjo gjendje, të cilat çojnë në pezmatimin e ekonomisë, por dhe faktorë me ndikim negativ në

perspektivën afatshkurtër dhe afatgjatë të qytetarëve, të cilëve u është vrarë shpresa, situatë e cila ka nxitur pasiguri dhe ka çuar në largimin e tyre jashtë vendit, pikërisht si pasojë e kësaj gjendjeje që mbizotëron në vendin tonë.

Shkaku i një pjese të konsiderueshme të problemeve të evidentuara nga **z. Malaj** vijnë nga paaftësia e klasës politike, për të prodhuar një sistem të paanshëm të pavarur dhe funksional të drejtësisë, i cili do të garantonte mbarëvajtjen e të gjitha proceseve që lidhen me sfidën e shtetformimit, ndërtimit dhe funksionimit të institucioneve të pavarura me kuadër të qartë veprimi, duke përmbushur misionin për të cilin ato janë krijuar. Malaj vlerëson disa problematika kryesore, së pari atë me kontekst strukturor.

a) Mungësën e konceptit shtetformues, element që është karakteristikë për vendet e zhvilluara, të cilat kanë arritur t'i ndërtojnë institucionet mbi parimin e lirisë dhe garantimit të tyre përmes rregullave dhe ligjeve të barabarta për të gjithë, gjë e cila mungon në vendin tonë. Jo vetëm kaq, por kjo tezë shfrytëzohet dhe nga fqinjët tanë serbë, të cilët e nënvizojnë këtë element ndaj shqiptarëve në diskutet e tyre diplomatike.

b) Mungesa e kohezionit social është një element, i cili ndikon drejtpërdrejtë dhe negativisht në ambientin shoqëror, të cilit i shtohet një tjetër peshë e pamërituar në përballimin e sfidave të përditshme. Malaj thekson se është detyrë e politikës dhe e politikanëve të jenë më afër me njerëzit, duke shmangur gjuhën populiste, duke hartuar politika që ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve, duke ulur kostot dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës.

c) Deficiti demografik vlerësohet nga Malaj, si një sfidë shumë e rëndësishme për vendin, në të cilën duhet ndërhyrë sa më parë me politika konkrete në rang kombëtar. Kjo sfidë, sipas Malajt, kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve dhe faktorëve politikë e socialë, për të reduktuar këtë deficit përmes politikave, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve, duke rritur mirëqenien, duke reduktuar kostot dhe krijuar kushte më të mira për të përballuar jetesën. Të gjitha këto elemente mund të shërbejnë si katalizatorë të shoqërisë, duke ndaluar emigrimin, si dhe duke krijuar stimuj për familjet e reja, në mënyrë që ta ndërtojnë këtu, në vendin e tyre, të ardhmen e tyre.

Znj. Duma sheh si problem ndalimin dhe aplikimin e politikave populiste, si në rrafshin e brendshëm, ashtu edhe në politikën e jashtme. Problemi tjetër që nënvizon znj. Duma është

pamundësia e Shqipërisë për të qenë e aftë dhe konkurruese me vendet e rajonit. Ajo thekson, se Shqipëria duhet ta zhvillojë ekonominë duke u bazuar tek tregu i lirë. Si rrezik të ekonomisë, ajo sheh përqendrimin e kapitalit në pak duar, e thënë ndryshe krijimin e karteleve ekonomike, të cilat ajo i sheh si dëmtues të rritjes ekonomike dhe barazisë për të garantuar në një treg të lirë, pasi kartelizmi shkatërron mundësinë e biznesit të vogël për t'u rritur dhe zhvilluar normalisht. Gjithë këto, të marra së bashku, krijojnë një klimë aspak pozitive, për më tepër ndikojnë negativisht edhe në sfidat e tjera të vendit.

Z. Elezi, në sinkron me kolegët e tjerë, nënvizon si sfida dhe probleme të Shqipërisë, dobësimin e shtetit të së drejtës, luftën kundër korrupsionit, krimin e organizuar, mungesën e një kulture politike konstruktive. Këto elemente ai i rendit pengesa të rëndësishme, për të krijuar një imazh pozitiv tek partnerët ndërkombëtarë, të cilët po ashtu së brendshmi kanë ngërçet e tyre të funksionimit si të tillë. Nga ana tjetër, në rrafshin e brendshëm këta faktorë ndikojnë shumë negativisht në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit në terma afatmesëm dhe afatgjatë.

Znj. Gjoshja, në analizën e saj, theksin e vendos tek mungesa e dialogut politik, i cili ka sjellë si derivate një pjesë të madhe të problematikave që ka sot politika shqiptare, ndër të cilat mund të përmendim: krizën e demokracisë, mungesën e funksionimit të institucioneve, mungesën e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, si dhe “hemorragjinë” e intelektualëve dhe profesionistëve të rinj. Nga ana tjetër, ajo shprehet se të gjithë këta faktorë përbëjnë pengesë në sfidën e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Z. Aliçka në analizën e tij thekson si sfida të Shqipërisë *reformat* e nisura, të cilat mendohen të bëjnë revolucion në pikëpamjen e valencës politike që do shkaktojnë, posaçërisht *reforma në drejtësi*, si dhe instrumentet e tjerë, të cilët, po ashtu, do të jenë komplementare në formatimin e një sistemi gjyqësor cilësor, gjë e cila i mungon vendit dhe koston e së cilës po e paguajnë qytetarët shqiptarë shumë shtrenjtë. Sfida tjetër, me të cilën duhet të përballlet vendi, sipas z. Aliçka, është procesi i integritit evropian, të cilin ai e konsideron të rëndësishëm dhe ku bën me përgjegjësi të gjithë klasën politike shqiptare të 30-viteve të fundit, të cilat i akuzon për keqpërdorim të kësaj teze, thjesht e vetëm për konsum politik. Veç të tjerash, konkretisht ai mendon se nuk janë bërë hapa serioze në këtë drejtim,

në mënyrë që t'u jepet shqiptarëve dinjiteti i merituar përkrah kombeve të tjerë po ashtu evropianë.

Dukshëm dallohen këndvështrimet e të intervistuarve, të cilët bashkohen tek përmirësimi i politikave dhe qartësimi i sfidave, duke ndjekur hapa konkretë për reduktimin e kostove që paguajnë qytetarët shqiptarë, por, nga ana tjetër, ata ndahen kur parashtrojnë sfidat dhe perspektivat që ka vendi. Z. Malaj është më gjithëpërfshirës në analizën e tij, kur thekson qartazi dhe në mënyrë koherente problematikat dhe ofron zgjidhjen e tij. Të intervistuarit, në përgjigjen e tyre diferencohen në nivelin e analizës. Z. Malaj shpalos idetë e tij në nivel makro, duke dhënë perspektivën e tij të zgjidhjes. Z. Xhepa është më specifik, duke sjellë një seri sfidash, të cilat sigurisht qëndrojnë dhe janë aktuale (lufta kundër korrupsionit, administratë e pavarur dhe shërbime publike jo cilësore). Znj. Duma dukshëm është më e afektuar nga roli i saj politik, gjë e cila ka ndikuar edhe në mënyrën sesi e sheh problemin, apo ofron zgjidhjet e saj.

Z. Elezi, znj. Gjosha dhe z. Aliçka, në analizat e tyre, janë në të njëjtën frekuencë me kolegët e tyre në parashtrimin e problematikave, të cilat i shohin jo vetëm si pengesa në sfidat e brendshme, por gjithashtu edhe në perspektivën e integritimit evropian.

Të intervistuarit të marrë së bashku sjellin më së miri sfidat me të cilat përballen qytetarët shqiptarë dhe ofrojnë perspektivat e tyre për zgjidhjet e nevojshme. Mendoj se Shqipëria duhet që të ridimensionojë dhe të qartësojë rolin proaktiv të saj, jo vetëm brenda territorit shqiptar, por për të gjithë (edhe në emër) shqiptarët që jetojnë në tokat e tyre në të gjithë rajonin e Ballkanit, si dhe të vizionit të saj evropian.

5.2.2 Analizë: Ndikimi i vendeve perëndimore SHBA-BE në Shqipëri

Xhepa thekson, se jo vetëm roli i Bashkimit Evropian, por edhe ai i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka qenë pozitiv dhe dashamirës ndaj Shqipërisë, mirëpo ai kërkon gjithashtu një rol më të shtuar në proceset integruese dhe shtetformuese të Shqipërisë. Xhepa mendon se si SHBA-ja, ashtu edhe BE-ja, duhet ta shprehin më qartë qëndrimin e tyre kur vjen puna tek dështimet e klasës politike të Shqipërisë. Janë jo të pakta angazhimet e këtyre vendeve dhe paratë e hedhura në reforma të rëndësishme (ndërtimi i administratës publike të pavarur nga politika, reforma në drejtësi), të cilat akoma nuk po japin rezultatet e nevojshme. Për këtë

arsye, Xhepa mendon se roli i SHBA-BE duhet të jetë detyrues dhe imponues, në funksion të realizimit të këtyre reformave.

Z. Malaj thekson, se roli i SHBA-së është i madh dhe i mirëpritur, ndryshe nga kolegu Xhepa Malaj e sheh rolin dhe ndikimin e SHBA-së që prej vitit 1919 (në Konferencën e Paqes në Paris). Fjala e Presidentit Willson ishte një mbështetje e madhe për aspiratën e Shqipërisë për shtetformim, duke i dhënë një shans për të vazhduar ekzistencën e saj. Më pas, kontributi i SHBA-së do të ishte më i spikatur dhe në rritje, vërejtur kjo menjëherë pas rënies së komunizmit dhe kalimi nga ekonomia e centralizuar në ekonomi të tregut të lirë, nga sistemi monist në sistem shumëpartiak, si dhe në zbatimin e të gjitha proceseve shtetformuese dhe integruese të Shqipërisë tri dekadat që pasuan, ku mbështetja e saj ka qenë e pazëvendësueshme, thekson z. Malaj.

Përmendim këtu mbështetjen e jashtëzakonshme të SHBA-së në anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, po ashtu dhe rrugëtimin e saj drejt BE-së. Sa i takon BE-së, z. Malaj thekson se ajo është partneri kryesor ekonomik i Shqipërisë, për këtë mjafton t'i referohemi statistikave në lidhje me shkëmbimet dhe volumin tregtar me vendet e Bashkimit Evropian. Bashkimi ekonomik, integrimi i Shqipërisë në tregjet e BE-së, do t'i paraprijnë dhe integritit të saj të plotë si anëtare me të drejta të plota në familjen evropiane. I gjithë ky proces do t'i paraprihet përmbushjes së detyrimeve të Shqipërisë ndaj kuadrit ligjor dhe përafrimit të tij me atë të BE-së.

Z. Malaj thekson se integrimi i Shqipërisë në BE nuk është thjesht e vetëm një bashkim politiko-ekonomik dhe kulturor, por dhe një mundësi për të shmangur konfliktet e mundshme dhe, nga ana tjetër, për të vendosur paqen dhe stabilitetin në mbarë rajonin. Nga ana tjetër, z. Malaj i mëshon faktit të integritit të njëkohshëm për të gjitha vendet e Ballkanit, duke shmangur kështu bllokimin reciprok që mund t'i bëjnë njëra-tjetrës këto shtete, në rast se futen më herët nga fqinjët e tjerë në BE.

Në këtë kuadër, sa i takon diskursit politik, z. Malaj e sheh *procesin e integritit* si të keqpërdorur nga palët politike për agjendën e tyre afatshkurtër dhe jo një sfidë reale, siç do duhej të ishte në të vërtetë.

Znj. Duma e sheh rolin e SHBA-së dhe BE-së si të madh dhe të rëndësishëm për vendin tonë, por ajo mendon se ndikimi më i madh është në Kosovë. Duma mendon, se, pavarësisht

qasjeve që kanë partitë politike dhe fokusimit ndaj agjendave të tyre në politikën e brendshme, Shqipëria vijon të mbetet një partner i besueshëm i Perëndimit (SHBA-BE). Ajo ndan të njëjtin mendim si kolegu Xhepa, se roli dhe ndikimi i tyre duhet të jetë më prezent në politikëbërje dhe në proceset e ndërmarra, ku theksi duhet të jetë i qartë në instalimin e një demokracie reale dhe funksionale, gjë e cila shihet dhe si mjet kryesor për të kaluar tranzicionin e tejzgjatur.

Z. Elezi, njëlloj si kolegët, SHBA-në dhe BE-në i konsideron si partnerë strategjikë që prej periudhës postkomuniste. Ai e rendit SHBA-në si më koherente dhe të mirëpozicionuar në aspektin strategjik, në dallim nga BE-ja. Në analizën e tij, ai e sheh SHBA-në më të përfshirë në sfidat e brendshme të Shqipërisë, ndryshe nga BE-ja, e cila përfshirjen e saj në diskursin politik të Shqipërisë e ka vetëm në raport me aspiratat e saj të integritit evropian.

Znj. Gjosha në analizën e saj, nuk e ndan qartazi ndikimin e SHBA-së nga ai i BE-së. Ajo i sheh këto dy entitete politiko-ekonomike si tepër të rëndësishme për Shqipërinë dhe rrugën e saj euroatlantike, BE-në më tepër në dimensionin ekonomik, ndërsa SHBA-në si aktore të rëndësishme politike, sidomos në momente kyçe të saj.

Z. Aliçka pas vlerësimit të SHBA-së dhe BE-së si partnerë tepër të rëndësishëm ekonomikë dhe politikë, ai bën një ndarje të prezencës dhe kontributit të këtyre dy superfuqive në rrugën dhe sfidat e Shqipërisë, ku miqësinë dhe partneritetin me SHBA-në e sheh historike dhe vendimtare në momente të caktuara, si në gjenezën e krijimit të shtetit shqiptar, ashtu edhe në sfidat aktuale. Ndërsa Bashkimin Evropian, më së shumti e sheh si partner ekonomik, dhe e lidh me përkatësinë e vlerave të saj gjeografike, historike dhe kulturore, të cilat pa diskutim i përkasin atyre perëndimore.

Të intervistuarit e shohin rolin dhe kontributin e SHBA-BE si tejet të rëndësishëm për Shqipërinë.

Z. Malaj dhe z. Aliçka janë thelluar në analizën e tyre. Ndryshe nga kolegët, ata bëjnë diferencën në analizën e tyre, ku rolin dhe kontributin e SHBA-së e shohin në aspektin politik si mbështetësin kryesor të sfidave të saj (anëtarësimi në NATO dhe mbështetja për integritimin evropian), ndërsa rolin e BE-së e shohin më së shumti si partner ekonomik. Gjithsesi, kjo nuk e pengon z. Malaj ta shohë procesin e integritit si shumë të rëndësishëm për shmangien e konflikteve dhe garantimin e paqes dhe stabilitetit në rajon.

Ndërsa kolegët e tjerë vlerësojnë rolin e SHBA- BE, por nuk bëjnë një ndarje të qartë të mbështetjes që ofron secila. Janë më të përgjithshëm në analizën e tyre, por gjithsesi vlerësohet roli dhe mbështetja e këtyre dy partnerëve të rëndësishëm për Shqipërinë dhe sfidat e saj integruese.

5.2.3 Analizë: Ndikimi i Ruisë / Turqisë / Kinës në Shqipëri?

Z. Xhepa në analizën e tij vlerëson, se me gjithë përpjekjet e gjithanshme të Ruisë për të ndikuar sa të jetë e mundur në rajonin e Ballkanit dhe posaçërisht në vendin tonë, ndikimi real i saj në Shqipëri mbetet i papërfillshëm. Në këtë analizë, ai sjell aspektin politik, ku vizitat apo ndërveprimi politik midis dy vendeve Shqipëri - Rusi mbetet modest. Sa i takon dimensionit ekonomik dhe shkëmbimeve tregtare, edhe këtë aspekt ai e sheh në të njëjtin nivel minimal (referuar INSTAT për shërbimet import-eksport). Turqia, në analizën e Xhepës shihet si një aleat i natyrshëm, ekonomik kryesisht, dimension ky që vërehet nga shkëmbimet tregtare dhe volumet ekonomike, si dhe investimet strategjike, marrëdhënie të cilat në përgjigjen e Xhepës vlerësohen si tejet të ngushta midis dy vendeve Shqipëri - Turqi. Në raport me Kinën, Xhepa vlerëson se ajo po rrit ndjeshëm rolin dhe prezencën e saj në rajonin e Ballkanit, në dimensionin politik dhe ekonomik. Po ashtu, me një vëmendje të veçantë edhe në Shqipëri, të cilin e sheh si pjesë e planeve afatgjata të saj në Evropën Juglindore.

Z. Malaj në analizën e tij ndikimin e Turqisë e sheh në dy dimensione: në dimensionin politik dhe ekonomik. Ai thekson se Turqia po tenton të përdorë ndikimin politik, për të imponuar agjendën e saj ekonomike, në kuadër të planeve gjeostrategjike për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Z. Malaj e sheh ndikimin politik si tejet imponues ndaj vendeve të Ballkanit, ku Turqia po shfaq agjendën e saj me teza të cilat afirmojnë rindërtimin e perandorisë turke. Agjenda e saj po kushtëzon të gjitha marrëdhëniet e tjera me vendet e rajonit. Vihet re se të gjitha investimet e drejtpërdrejta të Turqisë në rajonin e Ballkanit nuk mund të anashkalojnë agjendën dhe ambiciet e saj gjeopolitike.

Sa i takon ndikimit të Ruisë, z. Malaj vlerëson se ajo po i rikthehet angazhimit të saj të dikurshëm në rajonin e Ballkanit, duke rritur dukshëm prezencën e saj politike dhe ekonomike, kryesisht me vendet ish-aleate të saj, ish-republikat sllave: Serbi, Mal i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë e Hercegovinë. Z. Malaj thekson se Rusia kërkon të jetë

pjesë e vendimmarrjes, sa i takon perspektivës së këtyre vendeve për t'u integruar në NATO dhe BE, gjë e cila ka vënë në presion Bashkimin Evropian dhe NATO-n për të qenë më koherente dhe efikase në qasjen dhe vendimmarrjet politike që kanë për vendet të cilat janë akoma aspirante dhe janë jashtë dyerve të BE-së dhe NATO-s.

Z. Malaj thekson, se mungesa e vizionit të lidërshipt të BE-së dhe NATO-s për integrimin e rajonit, si dhe paqartësia në vendimmarrjet e mëdha politike, do të çojnë në mënyrë të pashmangshme në rritjen e rolit të Ruisë dhe planeve të saj për të shtuar prezencën dhe bllokuar perspektiven e këtyre vendeve, gjë e cila nuk bën tjetër veçse shton pasigurinë në rajonin e Ballkanit dhe ndaj vendeve të cilat janë aspirues për t'u integruar.

Kina, në analizën e z. Malaj, edhe pse është duke u përballur me sfidat e saj të brendshme ekonomike dhe politike, në politikën e jashtme ia ka dalë të pozicionohet me sukses si gjigant ekonomik në rang global, falë shtrirjes, madhësisë së kapitaleve dhe shkëmbimeve tregtare që ajo ka hedhur në tregun ndërkombëtar, duke u kthyer në “kërcënim” dhe përcaktues në tregjet globale.

Sa i takon prezencës së Kinës në rajonin tonë, konkretisht ajo ka shpalosur iniciativën “16+1”, ose e titulluar ndryshe “One road, one belt”, përmes së cilës do të investojë një kapital prej mbi 10 miliardë dollarë, në mënyrë që të rrisë prezencën e saj në rajonin e Ballkanit Perëndimor, meqenëse ajo e sheh si një rrugë kalimi për fluksin e mallrave dhe kapitaleve të saj në tregun e madh të Bashkimit Evropian. Vlen të përmendet, se për Kinën Serbia është partneri më i ngushtë në këtë rajon, vend i cili ka përfituar më tepër nga të gjitha vendet e tjera nga investimet kineze. Sa i takon Shqipërisë, shihet një prezencë e investimeve kineze në sektorë si ndërtimi i aeroporteve dhe në industrinë e naftës.

Znj. Duma, në analizën e saj, e përmend Kinën si një potencial ekonomik global, kurse qasjen e saj ekspansioniste në tregjet ndërkombëtare. Sa i takon prezencës së saj në Shqipëri, ajo përmend angazhimin dhe investimin e Kinës në disa fusha të rëndësishme (Aeroportin e Rinasit). Ndërsa ndikimin e Ruisë në Shqipëri, ajo e sheh jo të drejtpërdrejtë, por si ndikim të tërthortë përmes të tretëve, duke përmendur dimensionin ekonomik dhe shërbimet sekrete. Duma ndikimin e Turqisë në rajon e sheh në rritje, madje vlerëson prezencën e saj të shtuar në funksion të agjendës së saj politike dhe ekonomike.

Z. Elezi, në analizën e tij, thekson se ndikimi i Ruisë mbetet minimal, referuar fakteve dhe të dhënave parë në periudhë afatshkurtër dhe afatmesme. Ndërsa Turqia, në dallim me dy vendet e tjera, shihet si aktori më rezonant në Shqipëri, si në dimensionet ekonomike, nëpërmjet investimeve strategjike, ashtu edhe në ato politike, duke konsideruar agjendën e shpeshtë të takimeve ndërqeveritare dhe në nivel kryetarësh qeverie. E megjithatë, nga z. Elezi theksohet, se, tani për tani, kjo qasje nuk konsiderohet si mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në orientimin gjeostrategjik të Shqipërisë.

Znj. Gjoshë, duke krahasuar tri shtetet që janë marrë në analizë, e vendos Turqinë si vendin me ndikimin më të madh në Shqipëri në dimensionin ekonomiko-politik, duke iu referuar investimeve strategjike në vendin tonë. Ndërsa ndikimin e Kinës dhe të Ruisë ajo e konsideron të papërfillshëm, duke sjellë si argument qasjen dhe “besnikërinë” e Shqipërisë ndaj perspektivës euroatlantike.

Sipas **z. Aliçka**, të tri vendet po përshfaqin interesat dhe ambiciet e tyre në rajonin e Ballkanit, secila me interesat reciproke, ku ndikimin e Ruisë e sheh më së tepërmi në aspektin gjeopolitik, ndërsa Turqinë dhe Kinën i sheh të pozicionuara më tepër si aktorë ekonomikë.

Pavarësisht tentativave dhe shpalesjes së interesave të këtyre tri superfuqive në këtë rajon, në pikëpamjen e **z. Aliçka** ato nuk përbëjnë një shqetësim të dukshëm.

Nga vlerësimi dhe analizat e bëra nga të intervistuarit, tre prej tyre theksojnë qartazi ndikimin e tri vendeve sigurisht në dimensione të ndryshme. Ndërkohë që Z. Elezi dhe Znj. Gjoshë, identifikojnë Turqinë si të vetmin vend me ndikim domethënës në Shqipëri. Nga analizat e mësipërme rezulton, se Turqia është vendi me ndikimin më të madh në rajon, kjo përmes investimeve direkte dhe indirekte, të cilat janë në funksion të agjendës së saj gjeopolitike dhe ambicies për rindërtimin e perandorisë otomane të dikurshme.

Nga ana tjetër, tre nga të intervistuarit e identifikojnë Rusinë si një aktor dhe faktor të rëndësishëm global, e cila po ridimensionon dhe përaftron qëndrimet e saj me vendet ish-partnere strategjike, në mënyrë që të ketë një rol përcaktues dhe influencues mjaftueshëm për të penguar ose përshpejtuar agjendën e integritetit të vendeve të rajonit të Ballkanit. Në këndvështrimin e tre të intervistuarve, Kina po konsiderohet si vendi që bën përpjekje të fuqishme për të rritur rolin dhe ndikimin e saj në këtë rajon, por ndryshe nga dy aktorët e

tjerë të marrë në analizë, synimet e Kinës janë të dimensionit ekonomik, si dhe për shtrirjen e kapitalit të saj në tregun e Bashkimit Evropian. Angazhimi i saj në iniciativën “16+1” është në funksion të kësaj agjende, ku ajo po investon shuma të konsiderueshme për të përmirësuar infrastrukturën e vendeve të rajonit, të cilat shihen si rrugëkalimi e kapitaleve dhe volumeve tregtare të saj për tregun evropian.

Nga z. Elezi, znj. Gjoshja dhe z. Aliçka ky fakt nuk merret në konsideratë, si rrjedhojë ndikimi i Kinës konsiderohet i papërfillshëm.

5.2.4 Analizë: Krahasim i nivelit të ndikimit të Turqisë, Rosisë, Kinës në Shqipëri

Sipas z. Xhepa, Rusia ka një rol minimal në ndikimin e saj në Shqipëri, por jo në rajon, dhe jo me vendet ish aleate të saj, ku spikat qasja ndaj Serbisë. Turqia, në analizën e Xhepajt, shihet si partneri rëndësishëm ekonomik për Shqipërinë, ku përveç shkëmbimeve tregtare vlerëson dhe miqësinë dhe historinë e përbashkët të dy vendeve tona. Ndërsa Kina aktualisht shihet me një rol më modest dhe aspak influencues në Shqipëri, duke parë angazhimin e saj në këtë rajon, megjithëse potencialisht ajo mund të ketë një rritje në të ardhmen. Xhepa, në analizën e tij, në raport me tri shtetet, e vlerëson Turqinë si vendin më me influencë.

Z. Malaj, në dimensionin ekonomik vlerëson, se Turqia, në raport me dy vendet e tjera të marra në analizë, ka prezencën më të madhe në ekonominë shqiptare (referuar INSTAT për shkëmbimet import - eksport). Ndërsa Kina, sipas Malajt, megjithëse po futet disi vonë në planin e investimeve në këtë rajon, po konkurren ndjeshëm nëpërmjet investimeve të saj, përmendim këtu koncesionin e Aeroportit të Rinasit dhe kompaninë më të madhe të nxjerrjes së naftës. Sa i takon rajonit, ajo është duke u qasur me projektin “One road, one belt”, një investim afatgjatë për rritjen e influencës së saj tregtare dhe politike në vend, po ashtu dhe rajonin e Ballkanit.

Ndërsa për Rusinë, Malaj nuk e identifikon fare, që do të thotë se pesha e investimeve të saj ekonomike është pothuajse zero, pra e paidentifikueshme për ekonominë shqiptare.

Në rrafshin politik, Malaj vlerëson se Turqia ka influencën më të madhe jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon dhe, sidomos, tek shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë, ku vërehen financime direkte ose indirekte nga faktorë të ndryshëm në Turqi, në mënyrë që të ndikojnë më vonë. Ndërsa Rusinë dhe influencën e saj, Malaj e sheh më tepër në gjeopolitikë, sesa duke pasur ndikime të drejtpërdrejta në vende apo parti të caktuara në

rajonin e Ballkanit. Sa i takon Kinës, Malaj nuk e identifikon si faktor ndikues me karakter politik.

Në aspektin e artit dhe kulturës, Malaj vlerëson *diplomacinë kulturore* si një instrument të rëndësishëm të synimeve gjeopolitike, ku Turqinë e sheh si vendin me vizion dhe strategji afatgjatë të angazhuar në projekte konkrete, sidomos në fushën e kinematografisë dhe filmave, duke promovuar kulturën e saj në të gjithë rajonin e Ballkanit. Ndërsa Kinën, Malaj e sheh në tentativë për të zgjeruar ndikimin e saj, fillimisht nëpërmjet institutit “Confucius” dhe shumë aktiviteteve kulturore në promovimin e projektit të saj 16 +1 në Ballkanin perëndimor. Rusinë, Malaj nuk e identifikon në këtë dimension.

Znj. Duma, në analizën e saj, e vlerëson Kinën me ndikim më të madh në dimensionin ekonomik. Edhe Turqinë e sheh me një prezencë të madhe jo vetëm ekonomike, por edhe kulturore. Ndërsa Rusinë e sheh me një rol më të tërhequr në këto dy aspekte, pra ekonomik dhe kulturor, por, nga ana tjetër, thekson se kjo është perspektiva e momentit, pasi në një të ardhme jo të largët roli i saj mund të jetë në rritje.

Z. Elezi, në analizën e tij, thekson se asnjë nga këto vende nuk ka ndikim domethënës në orientimin gjeostrategjik të vendit. Megjithatë, ai veçon Turqinë, të cilën e identifikon me një prezencë më të lartë se dy vendet e tjera.

Znj. Gjoshja, sikurse kolegu Elezi, thekson se Rusia dhe Kina nuk kanë ndikim domethënës në vendin tonë, po ashtu ajo dallon rolin e Turqisë ndryshe nga dy vendet e tjera.

Ndërsa sipas **z. Aliçka**, ndikimi i të tri vendeve të marrë në analizë është i dukshëm në rajonin e Ballkanit, ku ai midis tyre i diferencon ato për nga interesat që ato kanë në këtë rajon.

Sipas tij, Turqia është më e pranishme në këtë rajon, më së shumti në dimensionin ekonomik, ndërsa Kinën e sheh si një faktor në rritje. Sa i takon Rosisë, z. Aliçka takohet me kolegët Gjoshja dhe Elezi, duke mos e konsideruar atë me prezencë shqetësuese në Shqipëri.

Në analizën e tyre në lidhje me ndikimin e Rosisë në vendin tonë, të intervistuarit Malaj dhe Xhepa, bashkohen për ndikimin e saj, të cilin e vlerësojnë si të fortë në rajon dhe në rrafsh gjeopolitik, por menjë rol të dobët kur vjen puna për ta identifikuar si ndikues në politikën e vendit tonë. Ndërsa znj. Duma e vlerëson si të zbehtë ndikimin e Rosisë në vendin tonë, në rrafshin politik.

Po ashtu, Malaj dhe Xhepa bashkohen në vlerësimin e tyre për Turqinë, të cilës i njohin rolin gjithnjë e në rritje të dimensionit ekonomik brenda vendit, por gjithashtu edhe në rajon. Gjithashtu, edhe znj. Duma vlerëson prezencën e Turqisë në vendin tonë, por me nota më të zbehta se kolegët Malaj e Xhepa.

Sa i takon ndikimit politik, të dy kolegët: Malaj e Xhepa, shprehen se Turqia është vendi me influencën më të spikatur në vendin tonë, por edhe në rajonin e Ballkanit, duke investuar në strategji afatgjata për të intensifikuar influencën e saj në mbarë vendet e rajonit. Një aspekt tjetër, që po ashtu mbetet për t'u nënvizuar si faktor ndikues, është dhe kinematografia, e përmendur në analizën e z. Malaj, i cili vlerëson se Turqia mban rekord për ekspansionin e saj kinematografik, duke shpërndarë gjerësisht kulturën e saj në të gjithë vendet e Ballkanit. Kina po ashtu përmendet në analizën e z. Malaj, si një vend i cili po bën të gjitha përpjekjet për të rritur dimensionin e saj kulturor, veçmas atij ekonomik dhe politik. Kjo e realizuar nëpërmjet institutit "Confucius" dhe në promovimin e shumë aktiviteteve kulturore në vendin tonë.

Ndërsa **z. Elezi, znj. Gjoshë** dhe **z. Aliçka** përafrojnë qëndrimet e tyre në raport me tri aktorët e marrë në analizë, ku veçojnë ndikimin e Turqisë, ndryshe nga Kina dhe Rusia, të cilat i shohin me relevancë tepër të ulët. Të intervistuarit nuk janë thelluar në analizimin e elementeve specifike të gjithsecilit shtet më vete, sa i takon dimensioneve ekonomike, politike dhe kulturore.

KAPITULLI VI: DISKUTIME DHE KONKLUSIONE

Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i orientimit gjeostrategjik të Shqipërisë në periudhën 2009 – 2019, duke u fokusuar kryesisht në ndikimin e fuqive joperëndimore Turqisë, Rosisë dhe Kinës. Në fund të viteve 2000, në rajonin e Ballkanit Perëndimor, fillon një fazë e re e ndikimeve të fuqive joperëndimore, si Rusia, Turqia dhe më pas Kina. Rritja e vazhdueshme e prezencës së tyre në këtë rajon, do të vinte në diskutim vijimësinë e orientimit gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë.

Për të realizuar qëllimin e këtij studimi, u ngrit pyetja kërkimore: *A është zhvendosur orientimi gjeostrategjik properëndimor i Shqipërisë nën ndikimin e vendeve joperëndimore?*

Në përputhje me pyetjen kërkimore u ngrit hipoteza e studimit: *Ndikimi i Turqisë, Rosisë dhe Kinës, nuk e ka zhvendosur orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë.* Nga të dhënat cilësore dhe sasimore rezultoi se hipoteza u vërtetua. Pra, pavarësisht debatit, edhe në rrafsh ndërkombëtar, të implikimit të fuqive joperëndimore në gjeopolitikën ndërkombëtare, e marrë në rrafshin rajonal dhe kombëtar, mund të thuhet se këto tri vende nuk kanë pasur ndikimin e mjaftueshëm për të zhvendosur orientimin properëndimor të Shqipërisë në rrugën e saj.

Për sa i përket dallimeve në raportim, bazuar mbi tipologjinë e forumit politik, testi *t* (independent samples) nuk arriti domethënie statistikore, duke nxjerrë si përfundim se në varësi të forumit politik nuk ka ndryshime në perceptim. Nga të dhënat statistikore rezultoi një element i rëndësishëm: vërehet se si në raportimet e të rinjve të Partisë Socialiste, ashtu edhe tek raportimet e të rinjve të Partisë Demokratike nuk shfaqen dallime midis tyre në aspektin e qasjeve që këto dy forume kanë me njëra-tjetrën. Shpjegimi është, se *partive politike shqiptare* u mungon dimensionin në perceptimin dhe analizimin e ngjarjeve në politikën e jashtme. Është vënë re se partitë politike shqiptare, në raste shumë të rralla ose asnjëherë, nuk kanë si kulturë të tyre mbajtjen e qëndrimeve të qarta politike në raport me ngjarje me rëndësi ndërkombëtare që lidhen me vendin tonë. Edhe në rastet kur ato mbajnë një qëndrim të caktuar, janë spekulative, pasi nxjerrin në plan të parë interesat e ngushta partiake dhe kurrësi ato të vendit, të cilat duhet të mbizotërojnë kudo dhe kurdoherë. E njëjta gjë ndodh si në rastin kur janë në pushtet, ashtu edhe kur dalin në opozitë.

Ende nuk njohim qoftë edhe një rast të vetëm, kur një parti e kryesore ne vend, të ketë mbajtur një qëndrim të spikatur për një çështje të caktuar, kjo shpjegon dhe faktin se përsë midis të rinjve nuk ka një ndarje ideologjike, apo një ndasi në raport me vlerat që partia politike mbron.

Duke iu referuar rezultateve, dalim në konkluzionin se të dyja forumet politike nuk kanë dallime të mëdha në perceptimin që ato kanë për ndikimin e këtyre vendeve në tri dimensionet e marra në studim.

Duke iu referuar të dhënave të mësipërme, konsiderojmë paqartësinë e partive politike në zhvillimin e qëndrimeve të tyre specifike në raport me politikën e jashtme apo të vendeve të caktuara, ku ato nuk mbajnë qëndrime zyrtare për çështje apo ngjarje që kërkojnë një ekspertizë më të thelluar në fushën e politikës së jashtme, përkundrazi bëjnë deklarata të mjegullta në raport me situata, vende, apo qëndrime të caktuara të linjës zyrtare qeverisëse.

Studimi është i ndarë në dy pjesë:

Në pjesën e parë studimi përfshin një përmbledhje dhe analizë të literaturës përkatëse, kurse në pjesën e dytë një analizë empirike me të dhëna nga terreni.

6.1. Perceptimi mbi sfidat dhe barrierat për integrimin evropian

6.1.1. Të dhënat sasiore

Pyetja, e cila vlerëson perceptimin mbi shkallën e pengesës që Rusia, Turqia apo Kina, paraqesin për integrimin evropian të Shqipërisë, tregon se përgjithësisht kampioni nuk e percepton influencën e këtyre vendeve si pengesë. Kështu, vetëm 1/5 e kampionit ose 20.7% mendon se Rusia përbën “mjaftueshëm” ose “shumë” pengesë për Shqipërinë në rrugën e integrimit evropian. Gjithsesi, kjo është përqindja më e lartë e raportuar në krahasim me dy vendet e tjera. Kështu, në rastin e Turqisë vetëm 15.7% e kampionit e konsideron si pengesë të mjaftueshme ose të madhe, ndërkohë që raportimet mbi Kinën janë të ulëta në nivelin 5% për këto dy kategori (mjaftueshëm ose shumë). Pra, në terma krahasimore duket se Rusia perceptohet si vendi që përbën pengesën më të madhe për Shqipërinë, në rrugën e saj të integrimit evropian, e ndjekur nga Turqia dhe në fund Kina.

Kjo gjetje, mbi perceptimin e Rusisë si pengesë për Shqipërinë, mund të shpjegohet për shkak të përfshirjes së saj në një diskurs shumë të madh, i cili e identifikon atë si faktor

ndikues global, duke e bërë temë debati mediatik e politik, së fundmi edhe subjekt hetimi, ndikimi i Ruisë në zgjedhjet presidenciale të SHBA-së.

Sa i takon rolit që luan Rusia në Ballkanin Perëndimor, apo ndikimit të saj në Shqipëri, perceptimi se ajo ka një rol pengues për Shqipërinë lidhet me angazhimin e saj absolutisht të madh në këtë rajon, duke shfrytëzuar çdo hapësirë/vakum që le BE-ja me paqartësitë e saj për të marrë vendime të rëndësishme për ta integruar këtë rajon në familjen e madhe evropiane.

Nga ana tjetër, roli dhe ndikimi i Turqisë dhe Kinës është vërejtur më pak i rëndësishëm në perceptimin e të intervistuarve dhe si shkak për këtë mendohet të jetë pafuqia e këtyre vendeve për të qenë ndikues krahasimisht me Rusinë.

Nisur nga ky këndvështrim, Turqia dhe Kina kanë prezencë të rëndësishme në rajonin e Ballkanit (Turqia shumë më tepër), nëpërmjet investimeve strategjike dhe ekonomike, por në këndvështrimin politik ato shihen më pak kërcënuese se Rusia, sa i takon ambicies së Shqipërisë për t'u integruar në BE. Megjithatë, vlen të theksohet se perceptimet e këtyre tri vendeve, si barriera të integritit evropian, ishin të dobëta. Me fjalë të tjera, të rinjtë, pjesë e forumeve politike të pyetur për këtë çështje, nuk e konsiderojnë ndikimin e Turqisë, Kinës dhe Ruisë si pengesë relevante për integrimin evropian. Vlen të nënvizojmë se kjo gjetje është në përputhje me hipotezën kryesore të punimit, e cila thekson se, pavarësisht ndikimeve të supozuara nga këto tri vende, Shqipëria nuk e ka ndryshuar kursin e saj europeist.

Në tjetër gjetje interesante, referuar statistikave, rezulton se krimi i organizuar dhe trafiket përbënin shqetësimin kryesor për të rinjtë e pyetur në këtë sondazh. Sigurisht, që kjo temë ka dhe një mbingarkesë nga amplifikimi politik dhe mediatik që i është bërë kësaj çështjeje, ku tematikat e kësaj natyre (me krim dhe drogë) janë shndërruar në linjë kryesore (mainstream) në diskursin publik shqiptar, për më tepër raportohen pa asnjë filtër në ekranet televizive kryesore në vend.

Nga ana tjetër, partitë politike opozitare nuk e kanë kursyer përdorimin e diskursit politik me pushtetin aktual, i cili, herë pas here, e ka tejkaluar sensin e realitetit në raport me këtë çështje. Po ashtu është vërejtur se klima e kriminalitetit në vend është me luhatje, pasi, edhe pse faktorët që ndikojnë në mungesën e stabilitetit janë të ndryshëm, ato kanë lidhje të drejtpërdrejtë me funksionimin e shtetit ligjor, forcimin e rendit dhe trajtimin e policisë së shtetit jo si instrument partiak, por si uniforma që mbron dhe është garant për të gjithë

nënshtetasit shqiptarë. Duhet thënë se roli i politikës është i mirëpritur për të lehtësuar punën e forcave të rendit, duke influencuar pozitivisht dhe duke mos cenuar statusin e kësaj trupe.

Në vijim të analizës: *Mungesa e vizionit politik* renditet e dyta për nga pesha që të intervistuarit i kishin dhënë, pas *Krimit të organizuar dhe trafiqeve*, çka do të thotë se ky dimension identifikohet si problematik. Nëse marrim në konsideratë faktin që këta të rinj, edhe pse janë pjesë e partive politike dhe, po ashtu, ndjekës të politikave makro e mikro që ushtrohen nga funksionarët e partive përkatëse, nuk kanë hezitur ta identifikojnë këtë çështje si problematike.

Ky fakt dëshmon, që *Elitat Politike* kanë një problem real në qasjen e tyre në raport me kërkesat e qytetarëve dhe përmbushjen e misionit të tyre për të përfaqësuar sa më mirë dhe sa më denjësisht interesat jo vetëm të partive të tyre, por të të gjithë shtetasve shqiptarë.

Si sfidë e tretë, në këtë pyetësor, është renditur *Influenca e vendeve joperëndimore*. Vihet re se të rinjtë e kampionuar nuk e shohin një shqetësim real qasjen apo ndikimin e supozuar të këtyre tri vendeve në raport me kursin properëndimor të Shqipërisë. Gjithashtu, kjo gjetje është në mbështetje të hipotezës kryesore.

Dhe sfida, e cila renditet e katërta për nga rëndësia, është *Radikalizmi fetar*. Për të intervistuarit në vendin tonë, kjo çështje çuditërisht vjen e fundit, megjithëse terrorizimi dhe radikalizmi fetar po marrin një dimension gjithnjë e më shqetësues në rrafsh kombëtar, rajonal dhe në rang global, për shkak të panikut dhe terrorit që këto celula përhapin në rajonet, ku ato ushtrojnë aktivitetin e tyre kriminal dhe aktet terroriste. Përmendim këtu se vetëm në vitin 2019 kanë ndodhur qindra akte kriminale në rang global, të cilat kanë lënë pas viktima të panumërta. Duhet thënë se kohët e fundit ky element në Shqipëri ka pasur një zbehje të ndikimit direkt, për shkak të çështjeve të tjera, të cilat kanë marrë vëmendje më të madhe të opinionit publik, për këtë arsye, kjo çështje është identifikuar si pak ose aspak shqetësuese si fenomen nga ana e të rinjve, në raport me çështjet e tjera.

6.1.2. Të dhënat cilësore

Vlerësimi i përgjithshëm mbi Shqipërinë, si aktor politik rajonal, i bashkon të 6 të intervistuarit në idenë se vendi ynë mund të konsiderohet si faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon. Xhepa e vë theksin tek roli konstruktiv i Shqipërisë, duke nënvizuar qasjen dhe kontributin e saj proaktiv ndaj nismave rajonale me karakter ekonomik dhe politik. Malaj

gjithashtu e konsideron rolin e Shqipërisë në rajon si “pozitiv” dhe “në rritje”, duke përmendur mentalitetin kulturor të hapur në kontrast me nacionalizmin e sëmurë që mund të kenë vende të caktuara në rajon, siç shprehet ai. Znj. Duma, po ashtu si kolegët Malaj, Xhepa, Elezi dhe Gjoshë, nënvizon rolin konstruktiv të Shqipërisë në rajon, nga ana tjetër ajo e vë theksin tek rreziku i qasjeve populiste të politikanëve si faktor dëmtues i perspektivës jo vetëm të Shqipërisë, por edhe të rajonit. Një risk tjetër që vihet re në analizën e Znj. Duma është qasja nacionaliste, e cila nënvizohet njëherazi si problem jo vetëm në diskursin politik lokal, por edhe në atë rajonal. **Nga ana tjetër, Z. Aliçka** ndryshe nga kolegët, vendos theksin në analizën e tij tek roli dhe përgjegjësia e Tiranës zyrtare, në raport me interesat e shqiptarëve që banojnë në trojet shqiptare, të ndarë në pesë shtete të Ballkanit.

Të dhënat cilësore tregojnë nivele të ndryshme të analizës së 6 ekspertëve. Z. Malaj i paraqet idetë e veta në nivel makro, duke përkufizuar si sfida paaftësinë e klasës politike për të prodhuar një sistem të paanshëm të pavarur dhe funksional të drejtësisë. Ai thekson se kjo do të garantonte të gjithë mbarëvajtjen e proceseve të tjera, që lidhen me sfidën e shtetformimit, ndërtimit dhe funksionimit të institucioneve të pavarura me kuadër të qartë veprimi, duke përmbushur misionin për të cilin ato janë krijuar. Z. Malaj vijon mandej duke nënvizuar se dy sfidat e tjera, që kërkojnë vëmendje të veçantë institucionale, janë: mungesa e kohezionit social dhe deficitin demografik, që lidhet me mpakjen e popullsisë dhe emigrimin e shtetasve jashtë vendit për një jetesë më të mirë. Ndërkohë që Xhepa është më specifik, duke nënvizuar një sërë sfidash, të cilat sigurisht qëndrojnë dhe janë aktuale, si lufta kundër korrupsionit, administrata e pavarur dhe shërbimet publike jo cilësore. Në këtë kuadër, ai rendit edhe probleme të tjera, të cilat po ashtu përbëjnë pengesë në nxitjen e ekonomisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj, si kultivimin e lëndëve narkotike apo aktivitetin kriminal. Nga ana tjetër, znj. Duma sheh si problem aplikimin e politikave populiste si në rrafshin e brendshëm, ashtu edhe në politikën e jashtme. Ajo vlerëson njëherazi si rrezikshmëri për ekonominë përqendrimin e kapitalit të vendit në pak duar, apo krijimin e karteleve ekonomike, të cilat i shikon si dëmtues të rritjes ekonomike dhe barazisë për të garuar në një treg të lirë. **Z. Elezi** fokusohet kryesisht në qëndrimet mbështetëse të Shqipërisë ndaj Kosovës, në sfidat për rritjen dhe njohjeve të saj në arenën ndërkombëtare dhe konsolidimin

e shtetit ligjor. **Znj. Gjosh**a, sikurse kolegët e tjerë, vlerëson rolin e Shqipërisë në rajon dhe veçon modelin e bashkëjetesës fetare.

Si përfundim, pikat përbashkuese të analizës sasiore dhe asaj cilësore e identifikojnë krimin e organizuar dhe trafiket si sfidën kryesore të Shqipërisë në rrugën e saj drejt BE-së. Një element tjetër, që i bashkon analizat, është identifikimi i *Mungesës së vizionit politik* si sfidë, ku si ekspertët, ashtu edhe të rinjtë e angazhuar në politikë, të pyetur për këtë çështje ndajnë pikëpamje të ngjashme. Së fundmi, qëndrimet e kampionit sasior dhe atij cilësor në lidhje me *Radikalizmin fetar* dhe *Influencat e vendeve joperëndimore* i vlerëson këto të fundit si sfida jo domethënëse në rrugën e Shqipërisë drejt BE-së.

6.2. Influencat ekonomike, politike dhe kulturore të SHBA-së dhe BE-së në Shqipëri

Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë dy partnerë strategjikë të padiskutueshëm të Shqipërisë, në rrugën e saj për integrim dhe në sfidën e epërme për ndërtimin e një shteti demokratik dhe institucioneve të pavarura, rrugë e cila nuk ka qenë aspak e lehtë. Në këtë kontekst, roli dhe mbështetja e tyre në dimensionet ekonomike, politike dhe kulturore janë thelbësore për Shqipërinë.

Ky studim ka marrë në analizë perceptimin e të rinjve *të angazhuar në politikë dhe atyre jopolitikë*, në lidhje me influencat e SHBA-së dhe BE-së në dimensionet: politike, ekonomike dhe kulturore.

Një gjetje interesante e këtij studimi është fakti, se pjesëmarrësit në këtë studim kanë një perceptim tepër të ngjashëm në lidhje me ndikimin si të BE-së, ashtu edhe të SHBA-së në Shqipëri.

Dimensioni me influencën më të madhe, në të dyja rastet, vlerësohet *dimensioni politik*. Dhe në fakt, kjo ishte një gjetje e pritshme, pasi të dyja fuqitë e mëdha, si BE-ja, ashtu edhe SHBA-ja, kanë qenë pika reference të padiskutueshme për klasën politike në vend, pavarësisht kush ka qenë në qeverisje e kush në opozitë. Klasa politike shqiptare, të paktën këto 30 vitet e fundit, ka qenë në unison në raport me partneritetin strategjik, që Shqipëria duhet të ketë me këto dy superfuqi ndërkombëtare. Mirëpo, nga ana tjetër, vihet re se perceptimi i të rinjve për influencën e këtyre dy superfuqive ndërkombëtare është në vlera të moderuara nga ajo që pritej. Në fakt, kjo gjetje mund të shpjegohet me dështimet e

njëpasnjëshme të klasës politike shqiptare në periudhën postkomuniste, në raport me angazhimet e marra kohë pas kohe përballë këtyre dy partnerëve strategjikë, mbështetës të sfidave të vendit tonë.

Kjo klasë politike është treguar e paaftë të përmbyllë tranzicionin e tejzgjatur dhe të pamerituar për qytetarët shqiptarë, për ndërtimin e një shteti funksional, me institucione demokratike dhe të fuqizuara.

Si rrjedhojë, partnerët tanë strategjikë SHBA-BE janë treguar të rezervuar në dhënien e mbështetjes në mënyrë të pakushtëzuar ndaj klasës politike, duke sjellë në këtë mënyrë një zbehje të prezencës së tyre në Shqipëri.

Dimensioni ekonomik radhitet i dyti, pas influencës politike të këtyre dy partnerëve tanë.

Risia e këtij studimi ka të bëjë me shenjën e barazisë që vendosin të intervistuarit, kur pyeten për valencën ekonomike që kanë këto dy superfuqi në raport me vendin tonë, ku si Bashkimi Evropian, ashtu edhe SHBA-ja të perceptohen afërsisht të barabarta për ndikimin e tyre ekonomik në Shqipëri. Ndërkohë që po t'u referohemi shifrave të shkëmbimeve tregtare, apo të dhënave import – eksport, veças njëri-tjetrit, vërejmë se ka diferenca të dukshme, madje rezulton se Bashkimi Evropian është partneri ekonomik kryesor i Shqipërisë. Nuk është e njëjta gjë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku marrëdhëniet ekonomike dhe shkëmbimet tregtare midis tyre janë në shifra modeste në raport me BE-në.

Një shpjegim i mundshëm për këtë rezultat është fakti, se, kur merren në analizë SHBA-ja dhe BE-ja, në pjesën e saj dërrmuese fokusi është në dimensionin politik, e shumë më pak diskutohet për aspektet ekonomike dhe shkëmbimet tregtare me këto shtete.

Dimensioni kulturor renditet me influencën më të vogël në raport me atë politike dhe ekonomike. Një element tjetër që vihet re është, se nuk ka dallime të dukshme midis SHBA-së dhe BE-së në këtë dimension, që në fakt është element jo pak befasues, pasi vendet e BE-së janë shumë më afër gjeografikisht dhe nga ana kulturore, si për t'u perceptuar edhe për t'u vizituar në raport me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Megjithatë, një shpjegim për këtë gjetje mund të jetë ngjashmëria apo unifikimi, që ata u bëjnë vlerave kulturore të BE-së dhe atyre të SHBA-së, duke i konsideruar si vlera perëndimore. Një shpjegim i mundshëm i rezultatit të ulët ndikues të vlerave perëndimore mund të jetë interferimi në rritje i vlerave kulturore nga vendet joperëndimore, si Turqia, Rusia apo vendeve të tjera.

Analiza cilësore tregoi rezultate të ngjashme me analizën sasiore. Për sa i përket rolit të SHBA-BE në raport me Shqipërinë, të 6 të intervistuarit bien dakord për rolin dhe kontributin e SHBA-së dhe BE-së. Z. Malaj identifikon rolin e SHBA-së në dimensionin politik (Anëtarësimi në NATO, si dhe mbështetja për integrimin evropian). Ndërsa rolin e BE-së e sheh më së shumti si partner ekonomik, por kjo nuk e pengon Profesor Malajn ta shohë procesin e integritit si shumë të rëndësishëm për shmangien e konflikteve dhe garantimin e paqes dhe stabilitetit në rajon. Nga ana tjetër, Xhepa mendon se si SHBA-ja, ashtu edhe BE-ja duhet të jenë më të qartë në qëndrimet e tyre, kur vjen puna tek identifikimi i dështimeve të aktorëve politikë, por edhe klasës politike të Shqipërisë në tërësi. Angazhimet dhe paratë e investuara nga këto vende (BE dhe SHBA), për kryerjen e reformave të rëndësishme janë absolutisht të konsiderueshme. Në tërësinë e tyre mund të përmendim: ndërtimi i një administrate publike të pavarur nga aktorët politikë, reforma në sistemin e drejtësisë, lufta kundër korrupsionit. Ndërsa Xhepa mendon se roli i SHBA-së dhe BE-së, në raport me klasën politike të Shqipërisë, duhet të jetë detyrues dhe imponues në funksion të realizimit të këtyre reformave jetike për vendin. Znj. Duma bashkohet me idenë se ndikimi i SHBA-së dhe BE-së duhet të jetë më prezent në politikëbërje dhe në proceset e ndërmarra nga aktorët dhe faktorët politikë shqiptarë, ku theksi duhet të jetë i qartë në instalimin e një demokracie reale dhe funksionale, gjë e cila shihet dhe si mjet kryesor për të kaluar tranzicionin e tejzgjatur.

Ndërsa Elezi, Gjosa dhe Aliçka vlerësojnë rolin e SHBA- BE, por nuk bëjnë një ndarje të qartë të mbështetjes që ofron secila. Ata janë disi më të përgjithshëm në analizat e tyre, por gjithsesi vlerësojnë rolin dhe mbështetjen e këtyre dy aktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë për Shqipërinë.

Tek të dyja analizat, si sasiore dhe ajo cilësore, perceptohet një rënie e ndikimit të SHBA-së dhe BE-së në angazhimet e tyre në vendin tonë tek të tri dimensionet: në atë politik, ekonomik dhe kulturor. Tek analiza sasiore, të rinjtë e pyetur nuk bëjnë një dallim të qartë teksa pyeten për ndikimin e SHBA-së dhe BE-së, duke parë influencën e tyre në vendin tonë si të njëjtë dhe me impakt të ulët. Ndryshe nga analiza sasiore, tek analiza cilësore, ekspertët

e kanë bërë dallimin dukshëm midis SHBA-së dhe BE-së, duke identifikuar pikat më të forta dhe më të dobëta vepruese të secilit aktor ndërkombëtar: SHBA-BE.

Nga ana tjetër, tek të dyja analizat, vihet re roli i munguar dhe prezenca aq shumë e nevojshme e këtyre dy aktorëve ndërkombëtarë në politikën shqiptare dhe vendimmarrjen e saj. Ndërsa tek analiza sasiore, kjo zbehje e rolit të SHBA-së dhe BE-së thjesht është konstatuar, tek analiza cilësore, ku këndvështrimet janë më të artikuluar, nga ekspertët shihet një kërkesë për një angazhim më të madh të këtyre dy aktorëve të rëndësishëm globalë në politikën shqiptare, si një faktor i pazëvendësueshëm i përpjekjeve dhe aspiratave të dëshmuara të popullit shqiptar pro vlerave dhe institucioneve demokratike perëndimore.

6.3. Influcencat ekonomike, politike dhe kulturore të Turqisë, Rosisë dhe Kinës

Rezultatet e analizave sasiore mbi dimensionet e influencës (ekonomike, politike, kulturore), për secilin vend treguan se ka dallime të rëndësishme statistikore në perceptimet e këtyre tri dimensioneve për sa i përket Rosisë, Turqisë dhe Kinës. Turqia renditet në vend të parë, si vendi më veprues në të tri dimensionet: ekonomike, politike, kulturore.

Ndikimi më i madh i shtetit turk perceptohet në nivelin ekonomik, ndjekur nga dimensionin politik dhe, së fundmi, ai kulturor, e ndjekur mandej nga Kina dhe në fund nga Rusia. Gjithsesi, vlen të theksohet se vlerat e mesatares renditen në mes të intervalit (3/5-disi), me një zhvendosje të vogël drejt kahut pozitiv në rastin e Turqisë dhe Kinës. Referuar të dhënave statistikore, rezulton që Turqia shihet si ndikues më i madh në fushën e ekonomisë në raport me dy vendet e tjera. Kjo e dhënë nuk është tërësisht e pambështetur, pasi po t'i referohemi të dhënave nga INSTAT dhe Banka e Shqipërisë, del që prezenca e Turqisë në raport me Kinën dhe Rusinë është shumë më e madhe, që do të thotë se perceptimi i të rinjve afrohet me realitetin. Është e qartë dhe e kuptueshme se nuk ka asnjë vështirësi për të dalë në këtë konkluzion, pasi shkëmbimet tregtare midis Turqisë dhe Shqipërisë e bëjnë atë një nga partnerët më të rëndësishëm në vend për sa i takon Import-Eksporteve për vitin 2018, duke iu referuar Bankës së Shqipërisë dhe INSTAT-it (www.bankofalbania.org; <http://ww.instat.gov.al/al>).

Dallime tregojnë gjithashtu edhe krahasimet mbi dimensionin politik, kështu në vend të parë renditet sërish Turqia, ndërsa Rusia kalon në vendin e dytë, ndërsa Kina renditet e fundit. Gjithsesi, vlen të theksohet se vlerat e mesatares renditen në mes të intervalit (3/5-

disi), me një zhvendosje minimale në rastin e Turqisë. Së fundmi, për sa i përket dimensionit kulturor, sërish Turqia renditet në vendin e parë, por influencat kulturore të Kinës dhe Ruisë raportohen mjaft të ngjashme (nuk ka dallime statistikisht të rëndësishme mes tyre). Gjithsesi, duhet theksuar se mesataret e raportuara për këtë dimension janë më të ulëtat [mes ‘pak’ (2) dhe ‘aspak’ (1)], çka do të thotë se perceptimi i përgjithshëm mbi influencën kulturore të këtyre tri vendeve është pothuajse inekzistent.

Në përmbledhje, të dhënat tregojnë se të rinjtë perceptojnë Turqinë si vendin me ndikimin më të madh politik, ekonomik, apo kulturor. Në një intervistë të ambasadorit turk, z. Murat Ahmet Yörük, raporton se në vendin tonë janë rreth 400 kompani turke, të cilat operojnë në tregun shqiptar, në fusha si energjia, telekomunikacioni, sistemi bankar, mineralet, etj., me një numër të punësuarish rreth 15.000 vetë, me potencial për t’u zhvilluar më tej në vitet në vazhdim (Intervistë e Ambasadorit të Turqisë, 2018). Shqipëria, së bashku me Kosovën përbëjnë dy ndër partnerët më të rëndësishëm ekonomikë të Turqisë në rajonin e Ballkanit, dhe jo rastësisht. Është fakt që një ndikim në këtë marrëdhënie kaq të ngushtë ekonomike ka luajtur faktori kulturor e sidomos ai fetar, ku në Shqipëri, sipas të dhënave të vetë institucionit shqiptar - INSTAT, popullsia e saj renditet si një vend me shumicë të besimit mysliman (www.instat.gov.al). Ky faktor ka bërë që kompanitë turke të operojnë natyrshëm në tregun shqiptar në fusha strategjike, ku si më të rëndësishmet mund të përmendim investimet në fushën e telekomunikacionit, përmes kompanisë “Türk Telekom”; në fushën e sistemit arsimor, përmes institucioneve arsimore, si: “Epoka University” dhe kolegjeve arsimore “Mehmet Akif”; në fushën e metalurgjisë, përmes kompanisë “Çalik Holding”; në sistemin bankar dhe atë të transportit së fundmi nëpërmjet kompanisë “Cengiz Construction”.

Fakti që Shqipëria është anëtare e NATO-s dhe Bankës Botërore dhe në vijim e sipër janë negociatat e saj për anëtarësim në BE, e kanë vendosur atë në një lloj qendre rajonale të tërheqjes së investimeve të huaja direkte, që arrijnë në 750 milionë euro në vit (në Evropën Juglindore në këtë parametër zë vendin e tretë, pas Serbisë dhe Kroacisë), duke bërë që ekonomia shqiptare të rritet në më shumë se 6% në baza vjetore. Lulëzimi i tregtisë dhe bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Turqisë, vjen si rezultat i nënshkrimit të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë mes dy vendeve në vitin 2006, sipas të cilës mallrat turke janë vendosur në të njëjtin pozicion me ato të BE-së, kurse rreth 80% e tyre janë liruar nga dogana shqiptare (në

të njëjtin vit, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE-në). Sipas një raporti të SETA-s, Organizatë Kërkimore për Çështje Politike, Ekonomike dhe Sociologjike, Turqia në vitin 2015 ka eksportuar mallra në Shqipëri në vlerë prej 287 milionë euro (SETA, 2018). Kjo dëshmohet edhe nga bujaria me të cilën mediet i kanë hapur ekranet për kinematografinë turke, duke transmetuar gjerësisht programe në gjuhën turke, po ashtu dhe shkëmbimet tregtare shoqëruar me marrëdhëniet e ngrohta politike midis drejtuesve të shteteve përkatëse, e bëjnë Turqinë një nga vendet më me ndikim në rajonin e Ballkanit. Qasja e Turqisë është më së shumti “luftë” për të dominuar tregjet e Ballkanit Perëndimor, duke shfrytëzuar të gjitha avantazhet që i krijon historia 500-vjeçare e sundimit të Perandorisë Osmane. Faktori i kulturës dhe fesë ka qenë një tjetër element, që e ka favorizuar shtrirjen e kapitalit dhe investimeve turke në Shqipëri, duke e bërë kështu të jetë në avantazh në raport me konkurrentët e tjerë.

Për sa i përket Rosisë, influenca e këtij vendi perceptohet më e fortë në dimensionin politik, i cili ndiqet nga ai ekonomik dhe, në fund, dimensionin kulturor. Arsyeja që Rusia perceptohet me influencë më të fortë politike, është roli i saj tejet aktiv në politikën e jashtme. Rusia, duke përdorur të gjithë mekanizmat ekonomike dhe gjeopolitike, ka arritur të përshfaqë rolin e një fuqie të dorës së parë në rrafshin politik dhe ekonomik, duke i bërë të qarta interesat e saj si në rang rajonal, ashtu edhe global.

Nëse i referohemi rajonit të Ballkanit, Rusia nuk e fsheh ambicien për të riafirmuar marrëdhëniet e saj sidomos me shtetin serb, të cilin konsideron si partnerin e saj të parapëlqyer ekonomik, politik dhe ushtarak, ku miqësia e kahershme midis këtyre dy popujve është dëshmuar historikisht.

Pavarësisht kësaj, Rusia nuk është limituar për të zgjeruar më tej influencën e saj me çdo aktor dhe faktor në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në këtë kontekst, çdo ndryshim apo avancim i vendeve të rajonit në agjendën Euroatlantike ndiqet me shqetësim nga ajo. Në këtë kontekst, anëtarësimi i Shqipërisë dhe Kroacisë me të drejta të plota në NATO, në prill 2009, nuk mund të kalonte pa shqetësim nga Rusia. Ishin pikërisht këto zhvillime, që çuan në intensifikimin e përpjekjeve të Rosisë për të krijuar sa më shumë mundësi komunikimi dhe ndikimi, për të zvogëluar në maksimum ndikimin e fuqive perëndimore, sikundër janë Shtetet

e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian, dy superfuqive botërore, të cilat kanë një rol dhe ndikim të dorës së parë në këtë rajon.

Shenjat pozitive shihen për tremujorin e parë të vitit 2017, ku eksportet ruse janë rritur me mbi 70%. Nga viti 2013 në 2015, importet nga Rusia panë një rritje të qëndrueshme, me një rënie të lehtë në vitin 2016. Për më tepër, viti 2017 ka pasur përpjekje të intensifikuara për të ringjallur dhe zhvilluar marrëdhëniet ekonomike midis Ruisë dhe Shqipërisë. Në prill, pas një takimi të nivelit të lartë midis delegacioneve të të dy vendeve, fokusi ishte në rritjen e investimeve ruse në sektorin e energjisë, transportit dhe turizmit në Shqipëri. E megjithatë në terma investimi, këto të dhëna janë akoma jo domethënëse. Në 2018, tregtia mes Shqipërisë dhe Ruisë është rritur deri në 64.58% krahasimisht me 2017 (nga (\$53,075,792, në \$125,691,009). Eksportet e Ruisë drejt Shqipërisë kanë pësuar rritje deri 73% krahasimisht me vitin 2017. Importet e Ruisë nga Shqipëria janë rritur deri 24% krahasimisht me 2017, konkretisht nga (\$3,742,798 në \$19,110,441). Fakte këto që tregojnë një trend rritës të shkëmbimeve tregtare midis dy vendeve dhe po ashtu konfirmojnë prezencën e saj të rritur në raport me Shqipërinë.

Nga ana tjetër, nuk mungojnë përpjekjet e saj në sektorë strategjikë, si ato të naftës dhe gazit në Shqipëri, ku kompanitë ruse “Lukoil” dhe “Gaspromi” kanë negociuar me kompanitë kineze për të drejtat e përdorim-shfrytëzimit të fushave të naftës në Patos-Marinzë, Shqipëri. Në të njëjtën linjë besohet se Ambasada Ruse në Tiranë po përpiqet të marrë kontrollin mbi pjesën shqiptare të tubacionit Trans-Adriatik (TAP), përmes rritjes së investimeve ruse në zonën ku do të kalojë TAP. Varësia e vendeve evropiane nga gazi rus dhe kërcënimi në rritje i rrugës alternative të gazit azerbajxhanas për në Evropë dëmton seriozisht tregun rus të gazit dhe të ardhurat ruse, gjë e cila justifikon interesin në rritje për Shqipërinë, si një vend strategjik në tregun e gazit nëpërmjet projektit TAP.

Interesi i fortë ekonomik dhe gjeopolitik i Ruisë në rajon është plotësuar edhe me përpjekjet e saj për të ndikuar dhe ndryshuar, pse jo, diskursin mediatik në Shqipëri, përveç vendeve të tjera nga rajoni. Një artikull jo i pranuar nga Ambasada Ruse në Tiranë, ku identifikohen përpjekjet e Ruisë për informimin dhe luftën e medie, duke blerë influencën e tyre në Shqipëri. Një strategji e tillë, sipas pretendimeve të paverifikuara, përfshin edhe shitjen e disa medie, TV, gazetave dhe medie online në kompanitë ruse, ku kuptohet që

qëllimi përfundimtar i tyre është përhapja e “propagandës ruse” dhe përmirësimi i imazhit të saj për publikun e gjerë shqiptar. Në fund të vitit 2016, vizita e papritur e CIA-s në Shqipëri rriti dyshimet, se ndikimi i Rusisë në Shqipëri dhe ekstremizmi ishin arsyeja për bisedimet e mbajtura me autoritetet shqiptare. Sa i takon marrëdhënieve politike, ato nuk mund të përshkruhen si shumë aktive, megjithatë vendet kanë bërë përpjekje për t’u afruar më shumë ekonomikisht dhe kulturisht. (Metohu, 2017; Gjonaj, Mark. 2017; Mejdini; 2016).

Vizitat e Ministrit të Energjisë, Ministrit të Kulturës së Shqipërisë dhe Kryetarit të Bashkisë së Tiranës në Rusi dëshmojnë për një qasje më miqësore midis dy vendeve (Intervistë e Ambasadorit Arben Gazioni, 2018).

Zonat e interesave të përbashkëta janë identifikuar dhe shkojnë përtej importit dhe eksportit tradicional të mallrave, duke u shtrirë në energji, bujqësi, minierë, infrastrukturë, transport dhe turizëm. Për të diskutuar interesat e përbashkëta në këto zona, një komision dypalësh ndërqeveritar ndërmjet dy vendeve do të mbajë sesionin e tij të shtatë në Tiranë pas 7 vjet ndërprerjeje. Edhe pse përmirësimi i marrëdhënieve po ecën ngadalë (siç konfirmohet nga ambasadori i Shqipërisë në Rusi dhe ambasadori rus në Shqipëri në intervista të ndara), përpjekjet në rritje për të mbajtur një dialog dypalësh, pavarësisht nga dallimet themelore në çështjet politike, sinjalizojnë një mbizotërim të interesave ekonomike, veçanërisht në fushën e energjisë. Të gjitha këto, duke pasur parasysh ndarjen e qartë politike dhe qasjen e Shqipërisë në njëzëshmëri me politikat e Bashkimit Evropian, pa harruar sanksionet e vendosura ndaj Rusisë. (Intervistë e Ambasadorit Arben Gazioni, 2018).

6.3.1 Ndikimi kinez në Shqipëri

Perceptimet mbi influencën e Kinës në Shqipëri renditen si dimensionin me ndikimin më të madh në atë ekonomik, të ndjekur nga dimensionin politik dhe, së fundmi, dimensionin kulturor. Për shkak të largësisë gjeografike, por edhe për shkak të agjendës së shpallur të interesave në kontinentin evropian, Kina e sheh Shqipërinë si një mundësi depërtimi të kapitaleve të saj drejt tregjeve evropiane. Në këtë kontekst, qasja e saj nuk është tjetër veçse ekonomike, por pa përjashtuar influencë të tjera. Çdo tentativë tjetër e saj, është në funksion të përmirësimit të klimës dhe ngritjes së urave të bashkëpunimit midis dy vendeve, për të pasur një komunikim sa më të mirë për shkëmbimet tregtare potenciale. Nga ana tjetër, Shqipëria si pjesë e projektit - nisma “16+1”, ku qëllimi kryesor i Kinës është ndërtimi i

infrastrukturës dhe shtrirja e kapitalit të saj drejt tregjeve evropiane, por kalimi përmes Ballkanit Perëndimor është i pashmangshëm, e në këto kushte, përmirësimi i marrëdhënieve politike dhe atyre infrastrukture ku mendohet të kalojë ky kapital, do e bëjë të vështirë shtrirjen e tij. Kjo është dhe arsyeja, që gjiganti kinez po investon në marrëdhënie shumëplanëshe në këtë rajon, me qëllim kryesor rritjen e kredos dhe zgjerimin e rrugëve të kalimit të mallrave dhe kapitaleve të saj drejt tregjeve evropiane.

6.3.2 Të dhënat cilësore

Analiza e të dhënave cilësore sugjeron, se ekspertët e perceptojnë Turqinë si vendin me ndikimin më të madh në rajon dhe në Shqipëri. Z. Malaj në analizën e tij e sheh ndikimin e Turqisë në dy dimensione: politik dhe ekonomik (investimet direkte dhe indirekte). Ai thekson, se Turqia po tenton të përdorë ndikimin politik për të imponuar agjendën e saj ekonomike, në kuadër të planeve gjeostrategjike për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në rrafshin politik, z. Malaj vlerëson se Turqia ka influencën më të madhe jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon dhe sidomos tek shqiptarët në Kosovë dhe Maqedoni, ku janë vënë re financime të drejtpërdrejta ose indirekte nga faktorë të ndryshëm, në mënyrë që të ndikojnë më vonë në agjendën e këtyre vendeve në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekt. Në aspektin e artit dhe kulturës, z. Malaj vlerëson diplomacinë kulturore si një instrument të rëndësishëm të synimeve gjeopolitike, ku Turqinë e sheh si vendin me vizion dhe strategji afatgjatë të angazhuar në projekte konkrete, sidomos në fushën e kinematografisë dhe filmave, duke promovuar kulturën e saj në të gjithë rajonin e Ballkanit.

Nga ana tjetër, z. Xhepa e konsideron Turqinë si një aleat të natyrshëm të Shqipërisë, por kryesisht në sektorin ekonomik. Së fundmi, edhe znj. Duma në vlerësimin e saj e percepton ndikimin e Turqisë me trend rritës, si në vendet e rajonit edhe në Shqipëri.

Nga ana tjetër, vërehet se Rusia perceptohet si një vend, i cili është duke ridimensionuar dhe përafruar qëndrimet e saj me ish-vendet satelitë të dikurshëm, partnerë strategjikë të saj, në mënyrë që të ketë një rol përcaktues dhe influencues, mjaftueshëm për të penguar ose përshpejtuar agjendën e integritit të vendeve të rajonit të Ballkanit, në raport me interesat e saj. Për shembull, në analizën e tij z. Malaj thekson se Rusia kërkon të jetë pjesë e vendimmarrjes sa i takon perspektivës së këtyre vendeve për t'u integruar në NATO dhe BE, gjë e cila ka vënë në presion Bashkimin Evropian dhe NATO-n për të qenë më koherente dhe

efikas në vendimmarrjet politike për vendet aspirantë, dhe janë jashtë dyerve të BE-së dhe NATO-s. Në kontrast me këtë qëndrim, z. Xhepa e percepton rolin e Rusisë në dimensionin politik edhe atë ekonomik ende si të papërfillshëm. Në këtë analizë, ai nënvizon aspektin politik, ku vizitat apo ndërveprimi politik midis dy vendeve Shqipëri – Rusi mbetet modest. Nga ana tjetër, znj. Duma gjithashtu e vlerëson ndikimin rus si jo të drejtpërdrejtë, por me ndikim të tërthortë përmes të tretëve, duke përmendur dimensionin ekonomik dhe shërbimet sekrete.

Së fundmi, Kina perceptohet në rrugën e përpjekjeve të vazhdueshme për të rritur ndikimin e saj në rajon, por ndryshe nga dy aktorët e tjerë të marrë në analizë, synimet e Kinës janë të dimensionit ekonomik, me qëllim shtrirjen e kapitaleve të saj në tregun e Bashkimit Europian. Z. Malaj vlerëson, se angazhimi i saj në iniciativën 16+ 1 është në funksion të kësaj agjende, ku Kina po investon shuma të konsiderueshme për të përmirësuar infrastrukturën e vendeve të rajonit, të cilat do të jenë rrugëkalimi për kapitalet e saj për tregun evropian. Po ashtu, z. Malaj specifikon se Serbia është partneri më i ngushtë i Kinës në rajon, ndërkohë që si shembuj për influencën kineze në Shqipëri përmenden vetëm aeroporti dhe industria e naftës. Malaj gjithashtu përmend përpjekjet e Kinës për të zgjeruar ndikimin e saj, fillimisht nëpërmjet institutit “Confucius” dhe shumë aktiviteteve kulturore në Ballkanin Perëndimor. Ndërsa **z. Elezi, znj. Gjoshja** dhe **z. Aliçka** përafrojnë qëndrimet e tyre në raport me tri aktorët e marrë në analizë, ku veçojnë ndikimin e Turqisë, ndryshe nga Kina dhe Rusia, të cilat i shohin me relevancë tepër të ulët. Të intervistuarit nuk janë thelluar në analizimin e elementeve specifike të secilit shtet më vete, sa i takon dimensioneve ekonomike, politike dhe kulturore.

Gjithsesi, ekspertët bashkohen në perceptimin e tyre se Kina është një potencial ekonomik global, me një qasje ekspansioniste në tregjet ndërkombëtare, së fundmi në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

6.4. Analizë krahasimore: SHBA-BE kundrejt vendeve joperëndimore: Turqi, Rusi, Kinë

Analiza krahasuese në lidhje me perceptimet e influencës ekonomike, politike dhe kulturore të SHBA-së dhe BE-së krahasimisht me Turqinë, tregoi dallime statistikisht të rëndësishme për sa i përket dy dimensioneve: ekonomike dhe kulturore.

Kështu, influenca ekonomike dhe ajo kulturore e Turqisë perceptohet krahasimisht më e lartë se e SHBA-së dhe BE-së, ndërkohë që në dimensionin politik nuk ka dallime statistikisht të rëndësishme. Influenca e këtyre dy vendeve perceptohet e moderuar, ndërkohë që vlerat më të ulëta raportohen në dimensionin kulturor.

Perceptimi për një barasvlerë të influencës politike midis SHBA-BE, nga njëra anë, dhe Turqisë, nga ana tjetër, mund të konsiderohet shqetësues nëse marrim parasysh aspiratat europeiste të vendit tonë, pa lënë mënjanë edhe devizën e shpallur euroatlantike në politikën e jashtme të qeverive shqiptare në periudhën postkomuniste.

Ky vlerësim i aktorëve të mësipërm mund të shpjegohet me një qasje më agresive në rritje të Turqisë, në raport me dy aktorët e tjerë në marrëdhëniet me Shqipërinë. Dukshëm Turqia po forcon interesat e saj në rajon dhe konkretisht në Shqipëri. Nga ana tjetër, roli i dy aktorëve perëndimorë, SHBA-së dhe BE-së perceptohet në rënie (me disa përjashtime) përtej aspiratave që kanë shqiptarët për to.

Sa i takon dimensionit ekonomik, perceptimi i të rinjve të intervistuar për SHBA-BE-në, nga njëra anë, dhe Turqisë, nga ana tjetër, vihet re se valenca është në favor të Turqisë. Ky fakt tregon se prezenca e saj nëpërmjet investimeve strategjike në vendin tonë ka qenë më e dukshme në raport me dy aktorët e tjerë. Duke iu referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, për vitin 2018, raportohet se investimet e huaja të drejtpërdrejta nga Turqia llogariten në 101 milionë euro, ndërkohë që po t'u referohemi të dhënave për investimet e huaja të drejtpërdrejta të SHBA-së, raportohet se kapin shifrën 14 milionë euro. Pavarësisht se kjo shifër është shumë më e ulët krahasimisht me Turqinë, por është shifra më e lartë e raportuar për SHBA-në, që prej vitit 2015 (Banka e Shqipërisë, 2018, marrë nga <https://www.bankofalbania.org/Statistikat/>).

Nëse i referohemi të dhënave për investimet e huaja të drejtpërdrejta të vendeve të Bashkimit Evropian në Shqipëri, shifrat janë krahasimisht shumë më të larta, madje ato

raportohen në shifrën 768 milionë euro për vitin 2018 (Banka e Shqipërisë, 2018, marrë nga <https://www.bankofalbania.org/Statistikat/>).

Pavarësisht të dhënave statistikore nga pyetësi, që ndikimin ekonomik të SHBA-së dhe BE-së i konsiderojnë në vlera shumë të përafërta, nëse u referohemi të dhënave konkrete nga Banka e Shqipërisë, rezulton se ka diferenca të konsiderueshme për sa i përket prezencës ekonomike të secilës pre tyre.

Për sa i përket dimensionit kulturor, po ashtu vihet re se influenca e Turqisë është më e madhe se e SHBA-së dhe BE-së. Ky indikator mund të shpjegohet në dy aspekte: *Faktori historik*, që lidhet me pushtimin 500-vjeçar nga Perandoria Osmane, sundim që ka lënë gjurmë të rëndësishme sociale-kulturore për vendin tonë, të cilat reflektohen edhe në ditët e sotme. Aspekti tjetër lidhet me ekspansionin kulturor të Turqisë, nëpërmjet medias dhe kinematografisë, duke përfshirë elementë të kulturës, gjuhës dhe traditës së saj në të gjithë rajonin e Ballkanit, po ashtu edhe në Shqipëri.

Analiza krahasuese në lidhje me perceptimet e influencës ekonomike, politike dhe kulturore të SHBA-së dhe BE-së, nga njëra anë, krahasimisht me Kinën, nga ana tjetër, tregoi dallime statistikisht të rëndësishme për sa i përket dy dimensioneve: politike dhe kulturore. Por në dallim me gjetjet për Turqinë, SHBA-ja dhe BE-ja raportohet se kanë influencë politike dhe kulturore më të lartë se Kina. Ndërkohë vërehet se në dimensionin ekonomik nuk ka dallime statistikisht të rëndësishme midis tyre; influenca e këtyre dy vendeve raportohet të jetë e ngjashme në këtë dimension. Mirëpo, nëse i referohemi të dhënave statistikore të Bankës së Shqipërisë, në lidhje me investimet e huaja të drejtpërdrejta të këtyre vendeve, shohim se shifra e raportuar për Kinën, për vitin 2018, është zero (Banka e Shqipërisë, 2018). Ndërsa nëse i referohemi të njëjtit burim, Bankës së Shqipërisë, për investimet e huaja të drejtpërdrejta të SHBA-së dhe BE-së për vitin 2018, raportohen shifrat respektivisht 14 milionë euro dhe 768 milionë euro (Banka e Shqipërisë, 2018). Nëse u referohemi të dhënave të të intervistuarve dhe të dhënave statistikore të Bankës së Shqipërisë, vërehet një mospërputhje shumë e madhe e këtyre të dhënave, pasi SHBA-ja dhe BE-ja, me gjithë prishjen e ekuilibrit midis tyre, në raport me Kinën janë absolutisht më ndikues në këtë dimension.

Për sa i përket dimensionit politik dhe atij kulturor, rezultatet janë të pritshme dhe të kuptueshme në favor të SHBA-së dhe BE-së në raport me Kinën. Kjo gjetje shpjegohet lehtësisht, pasi dihet që SHBA-ja dhe BE-ja janë shumë më tepër prezent në vendin tonë sesa Kina. Marrëdhëniet e Shqipërisë me dy vendet aktorë politikë ndërkombëtarë, si BE-ja dhe SHBA-ja, janë historike, gjeografike, politike, ekonomike dhe kulturore. Ndërsa marrëdhëniet me Kinën nuk kanë qenë asnjëherë domethënëse me Shqipërinë (përfshirë bashkëpunimi në periudhën komuniste). Megjithatë, së fundmi vihet re se kanë filluar përpjekje dypalëshe për të përmirësuar raportet midis dy vendeve, por në një kuadër më të gjerë, atë të bashkëpunimit rajonal, siç mund të përmendim iniciativën 16+1, në të cilën bën pjesë edhe vendi ynë.

Analiza krahasuese në lidhje me perceptimet e influencës ekonomike, politike dhe kulturore të SHBA-së dhe BE-së krahasimisht me Rusinë tregoi dallime statistike të rëndësishme për sa i përket të tri dimensioneve: politike ekonomike dhe kulturore. Kështu, në dallim me gjetjet e mësipërme, SHBA dhe BE raportohet se ka influencë politike, ekonomike dhe kulturore më të lartë se Rusia. Gjithsesi, duhet theksuar se vlerat e mesatares janë të moderuara (3/5), madje dhe të ulëta (dimensioni kulturor).

Në të vërtetë, këto gjetje kanë qenë të pritshme, duke konsideruar marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe BE-SHBA-së, që pa diskutim kanë qenë shumë më të konsoliduara dhe permanente, kjo për shkak të orientimit të gjithanshëm të saj pro-euroatlantik. Nga ana tjetër, Rusia me gjithë përpjekjet e saj, me dorën e shtrirë ndaj elitës politike shqiptare, nuk ka arritur të krijojë një marrëdhënie domethënëse me Shqipërinë, në aspektin politik dhe atë kulturor. Ndërkohë, në dimensionin ekonomik vihet re se në vitin 2018 tregtia mes Shqipërisë dhe Rusisë është rritur deri në 64.58% krahasimisht me 2017 (nga (\$53,075,792, në \$125,691,009). Eksportet e Rusisë drejt Shqipërisë kanë pësuar rritje deri 73% krahasimisht me vitin 2017. Importet e Rusisë nga Shqipëria janë rritur deri 24% krahasimisht me 2017, konkretisht nga (\$3,742,798 në \$19,110,441), fakte këto që tregojnë një trend rritës të shkëmbimeve tregtare midis dy vendeve dhe po ashtu konfirmojnë prezencën e saj të rritur në raport me Shqipërinë (Ref.). Pavarësisht këtyre fakteve, SHBA-ja dhe BE-ja kanë rol mbizotërues në marrëdhëniet me Shqipërinë krahasimisht me Rusinë.

Për sa i takon pyetjes, se cila nga tri vendet joperëndimore (Rusi, Turqi, Kinë) perceptohet si pengesa më e madhe për Shqipërinë në rrugën e saj euroatlantike, rezultatet tregojnë se 1/5 e kampionit ose 20.7% mendon se Rusia përbën “mjaftueshëm” ose “shumë” pengesë për Shqipërinë në rrugën e integritit evropian. Duhet thënë se kjo është përqindja më e lartë e raportuar në krahasim me të dy vendet e tjera: Turqinë dhe Kinën. Kështu, në rastin e Turqisë vetëm 15.7% e kampionimit e konsideron si pengesë të mjaftueshme ose të madhe, ndërkohë që raportimet mbi Kinën janë të ulëta në nivelin 5% për këto dy kategori (mjaftueshëm ose shumë). Pra, në terma krahasimore rezulton se Rusia perceptohet si vendi që përbën pengesën më të madhe, e ndjekur nga Turqia dhe në fund Kina.

Kjo gjetje bie në kontrast me të dhënat e raportuara nga të rinjtë në dimensionet e tjera: ekonomike, politike dhe kulturore, ku Rusia shfaqet inferiore ndaj Turqisë. Një shpjegim i kësaj gjetje mund të jetë influencë në rritje e Ruisë në politikën ndërkombëtare, ku ajo përshfaqet si një aktor global në gjeopolitikën ndërkombëtare, gjë që s’mund ta themi as për Turqinë dhe as për Kinën. Një aspekt tjetër është rigjallërimi i marrëdhënieve të Ruisë në Ballkanin Perëndimor, si dhe shtimi i prezencës së saj në këtë rajon, si rrjedhojë e bën atë të perceptohet nga të rinjtë me një potencial më të madh, për të luajtur një rol pengues në rrugën euroatlantike të Shqipërisë.

Në përmbledhje të të dhënave dhe gjetjeve të referuara në këtë pjesë të studimit, dalim në përfundimin se kemi një vërtetim të pjesshëm të hipotezës së ngritur: *“Ndikimi i fuqive të huaja joperëndimore (Rusi, Turqi, Kinë) në politikën e jashtme të Shqipërisë, nuk mjafton për të zhvendosur aksin ose orientimin perëndimor të politikës së jashtme”*. Hipoteza vërtetohet plotësisht në rastin e Kinës dhe Ruisë, por jo në rastin e Turqisë, ku influenca e saj ekonomike dhe kulturore shihet si superiore ndaj SHBA-së dhe BE-së, ndërsa influenca politike shihet përafërsisht në të njëjtat vlera.

Megjithëkëtë, pavarësisht se Turqia është vendi me influencën më të madhe politike, ekonomike dhe kulturore, ajo nuk perceptohet si pengesa kryesore për Shqipërinë në rrugën e saj euroatlantike. Nga ana tjetër, ndikimi i Ruisë perceptohet si pengesa kryesore për Shqipërinë, pavarësisht se vlerat e raportuara janë mesatare.

6.5 Konkluzione dhe sugjerime për studime të mëtejshme

Ky punim lindi nga nevoja për të kuptuar ndikimin e tri aktorëve ndërkombëtarë joperëndimorë, si: Rusia, Turqia dhe Kina në rajonin e Ballkanit Perëndimor, konkretisht në Shqipëri, në politikën e jashtme dhe kursin e saj properëndimor. Është pikërisht pozicioni i saj gjeografik, midis Lindjes dhe Perëndimit, që e bën atë të prekshme ndaj ndikimeve dhe implikimeve të Fuqive të Mëdha, qofshin këto në Lindje, ashtu edhe fuqive perëndimore. E gjendur në këtë kontekst, Shqipëria e ka bërë zgjedhjen e saj. Pas rënies së komunizmit në Shqipëri, në vitet '90-të, elita e kohës dalë prej zgjedhjeve të para pluraliste u pozicionua pa asnjë ekuivok drejt Evropës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Tashmë, kanë kaluar afërsisht 30 vite dhe kursi i Shqipërisë postkomuniste nuk shihet të ndryshojë orientimin pro-Perëndimor, në të gjitha dimensionet që ajo përfaqëson. E megjithatë, në një kontekst global, aktorët perëndimorë, nuk janë të vetmit aktorë dhe faktorë ndikues në Ballkanin Perëndimor. Kjo do të thotë se Shqipëria është jo immune ndaj ndikimeve gjeopolitike nga vendet joperëndimore, siç është Rusia, Turqia dhe Kina.

Pikërisht, në këtë kontekst gjeopolitik mori rrugë ky studim, nëpërmjet të cilit do të vlerësohej në mënyrë shkencore influenca e secilit aktor gjeopolitik rajonal dhe ndërkombëtar: perëndimor (SHBA–BE) dhe joperëndimor (Rusi, Turqi, Kinë).

Pyetja kërkimore e ngritur në këtë studim ishte: A është zhvendosur orientimi gjeostrategjik properëndimor i Shqipërisë nën ndikimin e vendeve joperëndimore?

Ndërsa hipoteza e studimit ishte: Ndikimi i Turqisë, Rosisë dhe Kinës, nuk e ka zhvendosur orientimin gjeostrategjik properëndimor të Shqipërisë.

Nisur nga analizat sasiore dhe cilësore të realizuara në këtë studim rezulton, se: *Të tri vendet joperëndimore të marra në analizë kanë ndikim të moderuar në Shqipëri, në të tria dimensionet e marra në analizë: në dimensionin ekonomik, politik dhe kulturor.*

Turqia është vendi, i cili perceptohet si më veprues në Shqipëri krahasimisht me dy vendet e tjera joperëndimore, po ashtu edhe ndaj SHBA-së dhe BE -së, në të tri dimensionet e marra në analizë. Në dimensionin ekonomik, Turqia shihet si vendi me prezencën më të madhe të investimeve të huaja të drejtpërdrejta në ekonominë e vendit tonë, duke qenë një investitor i rëndësishëm në sektorët më strategjikë: në sistemin bankar, telekomunikacion dhe infrastrukturë.

Një tregues tjetër interesant është, se Turqia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Bashkimit Evropian, perceptohen në të njëjtin nivel të influencës politike në vendin tonë. Ndërkohë, sa i takon influencës kulturore, nga analiza del një tjetër gjetje interesante, ku kjo influencë perceptohet më e lartë tek Turqia krahasimisht me SHBA-në dhe BE-në.

Sa i takon Ruisë, referuar të dhënave statistikore, rezulton se ajo perceptohet si vendi me më pak ndikim në politikën e jashtme të Shqipërisë në raport me vendet perëndimore: SHBA–BE, dhe Turqisë nga vendet joperëndimore. Mirëpo, nga ana tjetër Rusia perceptohet si pengesa kryesore e Shqipërisë në rrugën e saj euroatlantike, krahasimisht me dy vendet e tjera joperëndimore: Turqia dhe Kina. Së fundmi, influenca kryesore e saj perceptohet në dimensionin politik, krahasimisht me atë ekonomike dhe kulturore.

Kina renditet e fundit për nga influenca, në bazë të rezultateve të dala nga ky studim, krahasimisht me Rusinë dhe Turqinë. Kina ndryshe nga dy aktorët e tjerë joperëndimorë, Turqia dhe Rusia, interesat e saj kryesisht ekonomike i ka shfaqur së fundmi në rajonin e Ballkanit, ku bën pjesë edhe Shqipëria. Nëse i referohemi të dhënave krahasuese midis SHBA-së dhe BE-së, ajo perceptohet si pak ndikuese në dimensionet politike dhe kulturore, ndërsa në dimensionin ekonomik ajo pozicionohet përafërsisht në të njëjtën shkallë influence. Në fakt, nisur nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë, të referuara në këtë studim, rezulton se SHBA-ja dhe BE-ja janë në pozicion superior absolut në dimensionet ekonomike.

Nisur nga të dhënat e nxjerra nga studimi, konsiderojmë se të tri vendet e marra së bashku me gjithë ndikimin dhe implikimet e tyre në rajonin e Ballkanit Perëndimor, konkretisht në Shqipëri, rezulton se ndikimi i tyre është minimal, për pasojë nuk arrin të zhvendosë aksin e politikës së jashtme të shtetit shqiptar. E vetmja e dhënë, e cila nuk është në përputhje të plotë me hipotezën e ngritur në studim, është rasti i Turqisë, ku paraqitet me vlera më të larta influencuese në raport me SHBA-në dhe BE-në.

BIBLIOGRAFIA

1. Abazi (2008). Albania in Europe: Perspectives and Challenges. Eurasian Files (Avrasya Dosyasi): International Relations and Strategic Studies, 14 (1), pp.229-252
2. Albania Foreign Investment (2020). <https://santandertrade.com/en/portal/establish-overseas/albania/investing>
3. Amadeo, K. (2019). China's Economic Growth, Its Causes, Pros, Cons, and Future. <https://www.thebalance.com/china-s-economic-growth-cause-pros-cons-future-3305478>
4. Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës: Faqja Zyrtare, (2020) Deklarata e Përbashkët për Partneritet Strategjik mes RSH-së dhe SHBA-së. <http://www.ambasadat.gov.al/usa/sq/deklarat%C3%ABn-e-p%C3%ABrbashk%C3%ABt-p%C3%ABr-partneritet-strategjik-mes-rsh-s%C3%AB-dhe-shba-s%C3%AB>
5. Ambasada Shqiptare në SHBA (2015). Joint Declaration on Strategic Partnership between Albania and the USA. <http://www.ambasadat.gov.al/usa/en/joint-declaration-strategic-partnership-between-albania-and-usa>
6. Aron, L. (2013). The Putin Doctrine, «Foreign Affairs», March 2013, <http://www.foreignaffairs.com/articles/139049/leon-aron/the-putin-doctrine> 2 Concept of the Foreign Policy of the Russian Federation Approved by President of the Russian Federation Vladimir Putin on 12 February 2013, in http://www.mid.ru/brp_4.nsf/0/76389FEC168189ED44257B2E0039B16D.
7. Aral, B. (2001). Dispensing with tradition? Turkish politics and international society during the Özal decade', Middle Eastern Studies, Vol. 37, No. 1 (Jan., 2001), pp. 72-88.
8. Associated Press (2009). Albania, Croatia become NATO members. http://www.nbcnews.com/id/29995397/ns/world_news-europe/t/albania-croatia-become-nato-members/#.XsZ39v8zbIU
9. Ataman, M. (2008). Leadership change: Özal's leadership and restructuring in Turkish foreign policy', Alternatives. Turkish journal of international relations, Vol 1, No. 1.
10. Aydıntaşbas (2020). The Turkish Sonderweg: The new Turkish role in the global order. https://www.ecfr.eu/article/commentary_the_turkish_sonderweg_the_new_turkeys_role_in_the_global_order

11. Bandow, D. (1999). The US role in Kosovo. CATO Institute. <https://www.cato.org/publications/congressional-testimony/us-role-kosovo>
12. Banka e Shqipërisë (2014). Fakte dhe shifra. Marrë nga <https://www.bankofalbania.org/Statistikat>.
13. Banka e Shqipërisë (2017). Fakte dhe shifra. Marrë nga <https://www.bankofalbania.org/Statistikat>.
14. Banka e Shqipërisë (2018). Fakte dhe shifra. Marrë nga <https://www.bankofalbania.org/Statistikat>.
15. Blank, S. (2013). Russian Policy in the western Balkans. Atlantic Council. Marrë nga <http://www.acus.org/files/Blank.pdf>.
16. Bieber, F., Taleski, D., & Dimitrov, N. (2017). The avoidable return of geopolitics in the Balkans. Atlantic Council. Retrieved from <http://www.atlanticcouncil.org/blogs/new-atlanticist/the-avoidable-return-of>.
17. Bieber, F. (2019). Leadership adrift: American policy in the western Balkans. The Balkans in Europe Policy Advisory Group (BiEPAG). https://biepag.eu/wp-content/uploads/2019/08/Leadership-Adrift_fin-2.pdf
18. Bieri, M. (2015). The Western Balkans Between Europe and Russia. CSS Analyses in Security Policy, 170. <https://css.ethz.ch/content/dam/ethz/special-interest/gess/cis/center-for-securities-studies/pdfs/CSSAnalyse170-EN.pdf>
19. Bieri, M (2015). "The Western Balkans Between Europe and Russia" CSS Analyses in Security Policy. NO. 15
20. Brady, A. & Higashi, H. (2019). Are we real friends? Albania-China relations in the Xi Era. <https://sinopsis.cz/en/are-we-real-friends-albania-china-relations-in-the-xi-era/>
21. Brljavac, B. "Turkey entering the European Union through the Balkan doors: In the Style of a Great Power? Middle East Studies, N°6, Volum 3, 2011.
22. Bugajski, J (2020). "Can the Kremlin Take on the West"? <https://www.cepa.org/the-great-balkan-game>
23. Burazer, N. (2019). The Game of Envoys: Are the EU and the US taking the Western Balkans more seriously? <https://europeanwesternbalkans.com/2019/11/08/the-game-of-envoys-are-the-eu-and-the-us-taking-the-western-balkans-more-seriously/>

24. Cagaptay, S. (2007). "Secularism and foreign policy in turkey" washington Institute for Near East Policy, SHBA.
25. Casier, T. (2011). Russia's Energy Leverage over the EU: Myth or Reality?, «Perspectives on European Politics and Society», vol. 12, no. 4, 2011, pp. 493-508.
26. CESS, EU-Russia Relations. Time for a realistic turnaround. Marrw nga <http://thinkingeurope.eu/publications/eu-russia-relationstime-realistic-turnaround>
27. Chatzky, A., & McBride, J. (2020)China's Massive Belt and Road Initiative.Council on Foreign Relations. <https://www.cfr.org/backgroundunder/chinas-massive-belt-and-road-initiative>
28. China Daily (2017).Chinese investors show increasing interest in Albania: Official. https://www.chinadaily.com.cn/business/2017-04/12/content_28892777.htm
29. China's Economic Growth, Its Causes, Pros, Cons, and Future (2019). <https://www.thebalance.com/china-s-economic-growth-cause-pros-cons-future-3305478>
30. China's Economic Rise: History, Trends, Challenges, and Implications for the United States (2019). <https://www.everycrsreport.com/reports/RL33534.html>
31. Ciurtin, H. (2019). The "16+1" Becomes the "17+1": Greece Joins China's Dwindling Cooperation Framework in Central and Eastern Europe, China Brief Volume: 19 Issue: 10.
32. Conley, H. A., Mina, J., Stefanov, R., Vladimirov, M. (2016). The Kremlin Playbook, Understanding Russian Influence in Central and Eastern Europe. <https://www.csis.org/analysis/kremlin-playbook>
33. Conley, H. Coffey, L. (2018). Perwndimi dhe vendet e Ballkanit tw rrisin angazhimin ndaj ndikimit rus. <https://www.zeriamerikes.com/a/ballkani-ndikimi-rus-shba-perendimi-4364488.html>
34. Corne, P. H. (1997). Foreign Investment in China: The Administrative Legal System, Hong Kong University Press, Hong Kong.
35. Council of the European Union (2006). Signature Of Stabilisation And Association Agreement Between The Eu And The Republic Of Albania. https://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/pressData/en/er/89992.pdf

36. Crisol, J. (2009). Morgenthau vs. Morgenthau? “The Six Principles of Political Realism” in Context. *American Foreign Policy Interests*, 31: 238–244.
37. CRI online (2017). Këshilltari ekonomik kinez: Bashkëpunim i frytshëm ekonomikotregtar (2017) (<http://albanian.cri.cn/1552/2017/08/10/382s163362.htm>)
38. Daalder, I. H., (2002). The United States, Europe and the Balkans. *Problems of Post-Communism*, vol. 49, no. 1, 3–11.
39. Demir, I. (2017). *Turkey’s Foreign Policy Towards the Middle East*. Cambridge Scholars Publishing. <https://www.cambridgescholars.com/download/sample/63686>
40. Deutsche Welle (2007). Bush: It’s Time for Kosovo’s Independence. <https://www.dw.com/en/bush-its-time-for-kosovos-independence/a-2583711>
41. Deklaratë e përbashkët për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. (2014). <https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/01/Deklarata-per-bashkepunim-dhe-partneritet-strategjik.pdf>
42. Duroselle, J. B. Kaspi, A. (2009). *Historia e marrëdhënieve ndërkombëtare, vllimi II, Nga viti 1945 deri në ditët e sotme*. Tiranë.
43. ECFR, European Foreign Policy Scorecard 2013, http://www.ecfr.eu/page//ECFR73_SCORECARD_2013_Aw.pdf, p. 76.
44. European External Action Service (2017). The United States and the EU. https://eeas.europa.eu/delegations/united-states/america_en/27291/The%20United%20States%20and%20the%20EU
45. European Parliament (2018). China, the 16+1 format and the EU. [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/625173/EPRS_BRI\(2018\)625173_N.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/625173/EPRS_BRI(2018)625173_N.pdf)
46. European Commission. (1991). Summary of Treaty. <https://ec.europa.eu/world/agreements/prepareCreateTreatiesWorkspace/treatiesGeneralData.do?step=0&redirect=true&treatyId=125>
47. European Commission (2020). European Neighbourhood Policy And Enlargement Negotiations https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/albania_en

48. European Commission (2003). EU in Western Balkans. https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/PRES_03_163
49. European Council (2020). EU restrictive measures in response to the crisis in Ukraine. <https://www.consilium.europa.eu/en/policies/sanctions/ukraine-crisis/>
50. Encyclopaedia Britannica (2020). Cold War. <https://www.britannica.com/event/Cold-War>
51. Ersen, E. (2014). Rise of new centres of power in Eurasia: Implications for Turkish foreign policy. *Journal of Eurasian Studies*, Volume 5, Issue 2, July 2014, Pages 184-191. <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S1879366514000049>
52. Erickson, A(2019). Make China great again: Xi's truly grand strategy. <https://warontherocks.com/2019/10/make-china-great-again-xis-truly-grand-strategy/>
53. European Western Balkans (2020). EU and Western Balkans must work together to solve common challenges. <https://europeanwesternbalkans.com/2020/03/09/eu-and-western-balkans-must-work-together-to-solve-common-challenges/>
54. Fierke, K. M. (2007). *Konstruktivizmi*. Nw Dunne, T., Kurki, M., & Smith, S. "Teori tw marrwdhwnieve ndwrkombwtare" (faq.221-242). Oxford University Press.
55. Fraenkel, E. (2016). The EU and the Western Balkans: Do they share a future? https://www.cidob.org/en/publications/publication_series/notes_internacionals/n1_145_the_eu_and_the_western_balkans_do_they_share_a_future/the_eu_and_the_western_balkans_do_they_share_a_future
56. Garcia, M.J. (2009) "NATO Enlargement: Albania, Croatia, and Possible Future Candidates". <https://www.everycrsreport.com/reports/RL34701.html>
57. Graham, T. E., Levitsky, J.E., Munter, C. P., Wisner, F. G. (2018). Time for action in the Western Balkans. National Committee on American Foreign Policy, East West Institute <https://www.eastwest.ngo/sites/default/files/Time-for-Action-in-the-Western-Balkans.pdf>
58. [Goldstein, J. S. \(2001\). "Marrwdhwniet Ndwrkombwtare" Dituria:2003.](#)
59. Gordon, P. H., Taspinar, O., Ozel, S. (2009). *winning Turkey. How America, Europe, and Turkey can revive a fading partnership* washington DC: The Brookings institution, 2008.

60. Grigoriadis, I. (2010). The Davutoglu Doctrine and Turkish Foreign Policy. Hellenic Foundation for European and Foreign Policy. <http://www.eliamep.gr/wp-content/uploads>
61. Gjonaj, M. (2017). *Akuza e forte: Rusia ka blere nje televizion dhe tre portale ne Tirane. Pamfleti*. Retrieved from <http://www.pamfleti.com/akuza-e-forte-rusia-ka-blere-nje-televizion-dhe-tre-portale-ne-tirane>
62. Hide, E. (2015). Assessment of risks on national security//the capacity of state and society to react: Violent extremism and religious radicalization in Albania.
63. Hillman, J. E. McCalpin, M. (2019). Will China's '16+1' Format Divide Europe? Center for Strategic and International Studies. <https://www.csis.org/analysis/will-chinas-161-format-divide-europe>
64. History of Turkey-EU Relations (2020). https://www.ab.gov.tr/brief-history_111_en.html
65. Holzner, M., & Schwarzhappel, M. (2018). Infrastructure Investment in the Western Balkans: A First Analysis. https://www.eib.org/attachments/efs/infrastructure_investment_in_the_western_balkans_en.pdf
66. Human Rights Watch (1996). *Human Rights In Post-Communist Albania* <https://www.hrw.org/legacy/summaries/s.albania963.html>
67. How is China energy footprint changing? <https://chinapower.csis.org/energy-footprint/>
68. Ikenberry, J. (2008). The Rise of China and the Future of the west: Can the liberal system survive? Vol 87, Issue 1.
69. Information office of State Council (2012). China's energy policy: 2012. http://english.www.gov.cn/archive/white_paper/2014/09/09/content_281474986284499.htm
70. Intervistë e Ambasadorit Arben Gazioni për Portalin e Grupit të Vizionit Strategjik "Rusia - Bota Islame" (2018) <http://www.ambasadat.gov.al/russia/sq/intervist%C3%AB-e-ambasadorit-arben-gazioni-p%C3%ABr-portalin-e-grupit-t%C3%AB-vizionit-strategjik-%E2%80%9Crusia-bota>

71. INTERVISTA/ *Ambasadori i Turqisë: Projektet ambicioze që kemi për Shqipërinë* (2018). *BalkanWeb*. <https://www.balkanweb.com/intervista-ambasadori-i-turqise-projektet-ambicioze-qe-kemi-per-shqiperine/>
72. Intervistë Prof. Paskal Milo (2019). Marrëdhëniet Shqipëri-Kinë, histori suksezi. <http://albanian.cri.cn/1558/2019/05/27/61s179403.htm>
73. Intervistë Gjon Borici. (2019) .Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në syrin e një historian.
74. *Invest-In-Albania. Albania's Tourism and Energy Sectors Offer Potential for Chinese Investors* (2015). <https://invest-in-albania.org/albanias-tourism-and-energy-sectors-offer-potential-for-chinese-investors/>
75. Istrate, D. (2020) A new round of US sanctions against Russia could backfire. <https://emerging-europe.com/news/a-new-round-of-us-sanctions-against-russia-could-backfire/>
76. INSTAT. (2017). Foreign Trade data. Marrë nga <http://www.instat.gov.al/>.
77. Johnson, R. B., Onwuegbuzie, A. J., & Turner, R. A. (2006). Towards a definition of mixed methods research. *Journal of Mixed Methods Research*, Volume 1 Number 2, 112-133
78. Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim/Shteti Web. (2015). Shqipëria në Procesin e Berlinit Arritjet aktuale dhe sfidat e Samitit të Parisit. <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/13133.pdf>
79. Kholodilin, K. A., & Netšunajev, A. (2019). Crimea and punishment: the impact of sanctions on Russian economy and economies of the euro area, *Baltic Journal of Economics*, 19:1, 39-51
80. Këshilli i Ministrave. (2016). Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim. [file:///C:/Users/Administrator/Downloads/Strategjia%20SKZHI%20me%20ndryshime%20sipas%20porosise%20se%20mbledhjes%20se%20KM%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/Administrator/Downloads/Strategjia%20SKZHI%20me%20ndryshime%20sipas%20porosise%20se%20mbledhjes%20se%20KM%20(1).pdf)
81. Kreka, A. (2015). Marrëdhëniet Shqipëri – Kinë gjatë viteve 1960 – 1978. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2016/05/Alba-Kreka-Marr%C3%ABdh%C3%ABniet-Shqip%C3%ABri-Kin%C3%AB-Gjat%C3%AB-Viteve-1960-%E2%80%93-1978.pdf>

82. Kulla, N. (2019). Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane: Një historik gjithëpërfshirës. Tiranë: PLEJAD.
83. Kurbatskiy, V. (2012). Albania and Russia: Rapprochement. Russian International Affairs Council. <https://russiancouncil.ru/en/analytcs-and-comments/analytcs/albania-and-russia-rapprochement/>
84. Lachert, J. (2018). Western Balkans in the Context of Competition Between China, Russia, the European Union, and Turkey. Warsaw Institute Special Reports. <https://warsawinstitute.org/western-balkans-context-competition-china-russia-european-union-turkey/>
85. Lardy, N. (2012). Sustaining China's Economic Growth after the Global Financial Crisis. Asia Economic Policy Conference. http://www.freetradedoesntwork.com/research/Lardy_SustainingChinasEconomicGrowth.pdf
86. Lardy, Nicholas R. (2012), Integrating China into the Global Economy, Brookings Institution Press, Washington, D.C.
87. Larrabee, F. S., Pezard, S., Radin, A., Chandler, N. et al. (2017). Russia and the West after the Ukrainian crisis. https://www.rand.org/content/dam/rand/pubs/research_reports/RR1300/RR1305/RAND_RR1305.pdf
88. Lebov, R. N. (2007). Realizmi klasik. Në Dunne, T., Kurki, M., & Smith, S. "Teori të marrëdhënieve ndërkombëtare" (faq.83-104). Oxford University Press.
89. Leci, E. (1999). NATO dhe Shqipëria [NATO and Albania]. Tiranë.
90. Leci, E. (2006). Botime Ushtarake: Integrimi në NATO dhe Interesat Kombëtare [Military publications: Adriatic and integration in NATO] Tiranë.
91. Lleshi, A. (2009). Gjeopolitika dhe probleme të sigurisë në Ballkan. [Geopolitics and security issues in the Balkans]. Tiranë.
92. Lockie, A., & Rosen, A. (2019). Here's the awful story of the worst European massacre since World War II. <https://www.businessinsider.com/ratko-mladic-srebrenica-massacre-bosnia-war-2017-11>

93. Lory, B. (2007). "Europa Ballkanike, nga 1945, nw ditwt tona" Tiranë, Shtëpia Botuese "DITURIA".
94. Mardell, J. (2020). China's Economic Footprint in the Western Balkans. <http://aei.pitt.edu/102545/1/asia-policy-brief-chinas-economic-footprint-in-the-western-balkans-28c4d775834edcc469f4f737664f79f932d6f9a1.pdf>
95. Martino, F. (2017). China in the Balkans, "firmly in play in the coming years". Osservatorio Balcani e Caucaso Transeuropa. <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Balkans/China-in-the-Balkans-firmly-in-play-in-the-coming-years-184178>
96. Mearsheimer, J. (1990) "Back to the Future, Instability in Europe after the Cold war", *International Security* (Vol. 15, No.1, Summer 1990), pp. 5-56.
97. Mejdini, F. (2016). Russia and terrorism dominated CIA Chief's Albania visit. Balkan Insight. Retrieved from <http://www.balkaninsight.com/en/article/russia-influence-hunts-cia-director-visit-in-albania-12-08-2016>
98. Mejdini, F. (2016). Chinese Investments Raise Eyebrows in Albania. Balkan Insight. <https://balkaninsight.com/2016/05/03/chinese-investments-raise-eyebrows-in-albania-05-02-2016>
99. Metohu, F. (2017). Si Rusia kontrollon tregun e hidrokarbureve në Ballkan dhe tenton të kapë Shqipërinë. Retrieved from <http://www.gazetatema.net/2017/06/23/si-rusia-kontrollon-tregun-e-hidrokarbureve-ne-ballkan-dhe-tenton-te-kape-shqiperine/>.
100. Mikhalyova, M. (2016). China backs Albania's farming sector with 10 mln yuan (1.3 mln euro) grant. <https://seenews.com/news/china-backs-albanias-farming-sector-with-10-mln-yuan-13-mln-euro-grant-527742>
101. Milhiet, P. (2017). China's ambition in the pacific: Worldwide geopolitical issues. IRIS. <https://www.iris-france.org/wp-content/uploads/2017/10/Asia-Focus-49.pdf>
102. Ministria e Mbrojtjes: Faqja Zyrtare (2020). Historiku i marrëdhënieve NATO-Shqipëri. http://www.mod.gov.al/arkiv/index.php?option=com_content&view=article&id=516:historiku-i-marredhenieve-nato-shqiperi&catid=198&Itemid=589

103. Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë (2019). Adriatic Charter (A-5). <http://www.mod.gov.al/eng/index.php/security-policies/relations-with/international-and-regional-organization/90-adriatic-charter-a-5>
104. Milo, P. (2002).” Bashkimi Evropian” Tiranë, Shtëpia Botuese “ALBPAPER”.
105. Misha, P. (2015). ALBANIANS AND THE EUROPEAN SOCIAL MODEL Disadvantages, obstacles, challenges and visions. <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12304.pdf>
106. Mitrova, T. (2014). Gazprom’s Perspective on International Markets, Russian Analytical Digest , 41/08. Marrw nga www.laenderanalysen.de/russland.
107. Mlloja, G., & Hunci, D. (2016). Russia-Albania economic ties need to be revived. Albanian Daily News. <http://www.albaniannews.com/index.php?idm=6635&mod=2>
108. Montgomery, (1991). Non-Communist Rule Begins in Albania : Eastern Europe: The new leadership faces stiff economic and political challenges after 47 years of Stalinist control. Los Angeles Times.
109. Morgenthau, H. J. (1948). Politics Among Nations: The Struggle for Power and Peace. New York, 1948.
110. Musabelliu, M. (2020). Albania economy briefing: China officially Albania’s third trading partner. China-CEE Institute. <https://china-cee.eu/wp-content/uploads/2020/03/2020e02Albania.pdf>
111. Nato’s relations with Albania. (2014). https://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48891.htm
112. Newton, A. & Subbaraman, R. (2002). China: Gigantic Possibilities, Present Realities, Lehman Brothers, New York.
113. North Atlantic Treaty Organization: Official Website (2014). NATO’s relations with Albania https://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48891.htm
114. Nuttall (2019). BALKAN BLOG: EU rejection creates space for Russian return to the Western Balkans. <https://www.intellinews.com/balkan-blog-eu-rejection-creates-space-for-russian-return-to-the-western-balkans-170645/>

115. Palickova, A. (2019). Turkey Uses Ottoman Legacy To Gain More Influence Over The Balkans, Challenging The Eu Position In The Region. European Security Journal. <https://www.esjnews.com/turkey-uses-ottoman-legacy-to-gain-more-influence-over-the-balkans-challenging-the-eu-position-in-the-region>
116. Relations between Turkey and Albania (2017). <http://tirana.emb.mfa.gov.tr/Mission/ShowInfoNote/255500>
117. Ribaj, P; Cami, Sh. (2015). Lufta paqja dhe siguria: realitete ballkanike. [war, peace and security: Balkanic realities]. Tiranw.
118. Russian News Agency (2017). Russia's position on Kosovo remains unchanged, says Russian diplomat. <https://tass.com/politics/1017064>
119. Russia's position on Kosovo remains unchanged, says Russian diplomat. (2018). <https://tass.com/politics/1017064>
120. Saracini (2019). Diploarkiva – Sfidat e anëtarësimit të Shqipërisë në Këshillin e Europës në korrik 1995. <https://ata.gov.al/2019/01/20/diploarkiva-sfidat-e-anetaresimit-te-shqiperise-ne-keshillin-e-europes-ne-korrik-1995/>
121. Schweller R.L. (2000) Democracy and the Post-Cold War Era. In: Hansen B., Heurlin B. (eds) The New World Order. Palgrave Macmillan, London
122. Schoff, J. L., & Ito, A. (2019). Competing With China on Technology and Innovation. <https://carnegieendowment.org/2019/10/10/competing-with-china-on-technology-and-innovation-pub-80010>
123. Secrieru, S. (2019). Russia in the Western Balkans. Institute for Security Studies. https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief%208%20Russia%20Balkans_0.pdf
124. Sechrest, L., & Sidana, S. (1995). Quantitative and qualitative methods: Is there an alternative? Evaluation and Program Planning, 18, 77-87.
125. SETA Foundation for Political, Economic and Social Research (2018). Retrieved from <http://setav.org/en/>
126. Secrieru, S. (2018) The real and hidden costs of Russia's foreign policy. European Union Institute for security studies, 1-4.

127. Sly, L. (1991). Baker welcomes Albania to free world. Chicago Tribune. <https://www.chicagotribune.com/news/ct-xpm-1991-06-23-9102250445-story.html>
128. Tafili, N. (2015). Consolidation of Democracy: Albania. Journal of Political Inquiry. <http://www.jpinyu.com/wp-content/uploads/2015/01/consolidation-of-democracy-albania...najada-tafili1.pdf>.
129. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020). <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/dokumente/dokumente-kombetare/>
- 130.
131. Turkish Ministry of Foreign Affairs (2020). History of Turkey- EU Relations. https://www.ab.gov.tr/brief-history_111_en.html
132. The Belgrade Guidelines for Cooperation between China and Central and Eastern European Countries. http://www.china-ceec.org/eng/ldrhw_1/2014berglld/hdxw/t1410498.htm
133. The Balkanista (2018). The communist history of Albania. <http://thebalkanista.com/2018/02/25/communist-history-albania/>
134. The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation (2016). Foreign Policy Concept Of The Russian Federation. https://www.mid.ru/en/foreign_policy/official_documents/-/asset_publisher/CptICkB6BZ29/content/id/2542248
135. Top-Channel (2019). Java e Europës, sondazhi: 92% e shqiptarëve mbështesin anëtarësimin në BE. <http://top-channel.tv/2019/05/06/java-e-europes-sondazhi-92-e-shqiptareve-mbeshtesin-anetaresimin-ne-be/>
136. Toncev, P. (2017). China's road into the Balkans. European Union Institute for Security Studies. <https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief%203%20China%27s%20Silk%20Road.pdf>
137. Trenin, D. (2007). Getting Russia Right, «Carnegie Endowment for International Peace», washington DC, 2007.

138. Turkish Embassy. (2017). Relations between Turkey and Albania
<http://tirana.emb.mfa.gov.tr/Mission/ShowInfoNote/255500>
139. Ulgen, S. (2010). "A Place in the sun or fifteen minutes of fame? Understanding Turkey's new foreign policy. Carnegie Endowment for International Peace
140. Voice of Amerika (2009). Bush Becomes First US President to Visit Albania.
<https://www.voanews.com/archive/bush-becomes-first-us-president-visit-albania>
141. Veremis, T (2001). The end of history: American views of the Balkans. South-East European and Black Sea studies, 1, 113-123.
142. Vracic, A. (2016). Turkey's role in the western Balkans. SwP Research Paper. Marrw nga
https://www.swpberlin.org/fileadmin/contents/products/research_papers/2016RP11_vcc.pdf.
143. Vurmo,G., Lamallari, B., Papa, A., & Dhëmbo,E. (2015). Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri. Institute for Democracy and Mediation.
<https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/RadikalizmiFetar-webOK2.pdf>
144. Wilson, D. (2019). Great power competition in South East Europe.
<https://www.atlanticcouncil.org/blogs/new-atlanticist/great-power-competition-in-southeast-europe/>
145. World Politics Review (2020). How a rising China has made global politics.
<https://www.worldpoliticsreview.com/insights/27828/how-a-rising-china-has-remade-global-politics>
146. Waltz, K. (1964). "The Stability of a Bipolar world", Daedalus, Vol. 93, No. 3, Population, Prediction, Conflict, Existentialism,pp. 881-909
147. Waltz K. (1979). Theory of International Politics. USA: Mc.Graw-Hill.
148. World Bank (2012). South East Regular Economic Report. Marrw nga
http://www.worldbank.org/content/dam/worldbank/document/SEERER_3_Report_FINAL_eng.pdf.
149. Yavuz, H. (2006). The emergence of a new Turkey. Democracy and the AK Party, Salt lake city: University of Utah Press.
150. Yörük, M.A. (2018). Interview with Turkish Ambassador in Albania.

151. Zhelyazkova, A. (2000). Albanian Identities.
[http://pdc.ceu.hu/archive/00003852/01/Albanian Identities.pdf](http://pdc.ceu.hu/archive/00003852/01/Albanian_Identities.pdf)
152. Zhou, Zhujian and Nakagawa, Makoto (2002), The Current Tax System and Priorities for Reform, in China in the world Economy: Domestic Policy Challenges, OECD, Paris.

SHTOJCA 1

PYETËSORI PËR FORUMET POLITIKE

1. Moshë
2. Gjinia
 - a. Femër
 - b. Mashkull
3. Profesioni
 - a. Student
 - b. I diplomuar / I punësuar
 - c. I diplomuar / I papunësuar
4. Në cilin Forum politik bëni pjesë?
 - a. FRESSH
 - b. FRPD
 - c. LRI
5. Ju lutem zgjidhni opsionin që pasqyron më mirë opinionin tuaj? (Opsionet 1=aspak; 2=pak; 3=disi;4=mjaftueshëm; 5=shumë)
 - a. Identiteti shqiptar përbën pengesë për ndërtimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë në rajonin e Ballkanit?
 - b. Sa ka ndikuar futja e Shqipërisë në NATO, në rivendosjen e ekuilibrave gjeopolitike me fqinjët rajonale? A është Rusia pengesë për Shqipërinë në rrugën euroatlantike të saj?
 - c. A është Turqia pengesë për Shqipërinë në rrugën euroatlantike të saj?
 - d. A është Kina pengesë për Shqipërinë në rrugën euroatlantike të saj?
6. Sipas mendimit tuaj, ndikimi i
 - a. Rosisë
 - b. Turqisë
 - c. Kinësnë Shqipëri është fokusuar në...
 - a. Ekonomi Biznes

b. Politikë / Gjeopolitikë

c. Art /Kulturë

Opsionet: 1 = aspak; 2 = pak; 3 = disi; 4 = mjaftueshëm; 5 = shumë

7. Sipas mendimit tuaj, ndikimi i ...

a. SHBA

b. BE

...në Shqipëri, është i fokusuar në?

a. Ekonomi /Biznes

b. Politikë / Gjeopolitikë

c. Art / Kulturë

(Opsionet: 1 = aspak; 2 = pak; 3 = disi; 4 = mjaftueshëm; 5 = shumë)

INTERVISTAT E EKSPERTËVE

Kjo intervistë ka për qëllim të vlerësojë perceptimin tuaj në lidhje me ndikimin e vendeve joperëndimore (Rusi, Turqi, Kinë) në Shqipëri.

- 1. Si e vlerësoni rolin e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor (si aktor politik rajonal)?**
- 2. Në pikëpamjen tuaj, cilat janë sfidat më të rëndësishme me të cilat po përballet Shqipëria sot (kemi parasysh kursin politik brenda dhe jashtë vendit)?**
- 3. Si e vlerësoni ndikimin e vendeve perëndimore SHBA, BE në Shqipëri?**
- 4. Si e vlerësoni ndikimin e Rusisë/ Turqisë/ Kinës në Shqipëri?**
- 5. Sipas jush, cila nga këto tri vende (Turqi, Rusi, Kinë) ka ndikimin më të madh në Shqipëri? - Në aspektin (ekonomik, politik, art/kulturë)?**

SHTOJCA 2: INTERVISTAT E EKSPERTËVE

Intervistë: Selami Xhepa

1. Si e vlerësoni rolin e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor (si aktor politik rajonal)?

Si një vend me rëndësi për paqen në rajon, gjykoj se Shqipëria ka qenë një faktor konstruktiv. Ka përkrahur dhe ka marrë pjesë aktive në nismat rajonale dhe ka punuar ndershmërisht për të nxitur më shumë dialog dhe paqe mes fqinjëve. Si një rajon me një të shkuar historike problematike, ruajtja e paqes është një proces i vështirë dhe shumë i brishtë. Politika “zero probleme me fqinjët”, mendoj se ka nevojë të trajtohet dhe më fort mes gjithë vendeve tona dhe të shndërrohet në një platformë veprimi të politikës së jashtme për të gjithë njësoj.

2. Në pikëpamjen tuaj, cilat janë sfidat më të rëndësishme me të cilat po përballlet Shqipëria sot (krimi i organizuar, korrupsioni, mungesa e vizionit politik, etj.)?

Patjetër që korrupsioni ka minuar përpjekjet për të ndërtuar një ekonomi të shëndetshme dhe një shtet demokratik funksionues, shërbime publike të ofruara me një standard të pranueshëm dhe larg praktikave korruptive, të cilat kufizojnë aksesin e gjithë popullsisë. Kjo nga ana e vet, ka minuar ndërtimin e një administrate publike të efektshme, të aftë dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve. Rezultati i bashkëveprimit të faktorëve të mësipërm ka prodhuar një ekonomi të dobët e varfëri të përhapur, gjë e cila nxit aktivitetet ekonomike të paligjshme, si kultivimi bimëve narkotike, duke u bërë shkas për rritjen e aktiviteti kriminal dhe përhapjen e krimit të organizuar. Ky rreth vicioz në të cilën ka hyrë vendi, ka prodhuar një realitet shumë negativ dhe ka nxitur një rigjallërim të një vale emigracioni që mund të ketë pasoja afatgjata për vendin.

3. Si e vlerësoni ndikimin e vendeve perëndimore SHBA, BE në Shqipëri?

Perëndimi ka qenë dashamirës dhe mbështetës, por gjykoj se duhet të jenë më aktivë dhe të drejtpërdrejtë në qëndrimet e tyre ndaj politikave të gabuara. Për shembull, vendet e BE-së kanë shpenzuar shumë të mëdha monetare në reformën e administratës publike, por është fakt se ajo është shumë e dobët dhe joprofesionale. Edhe reforma të tjera të mbështetura nga BE dhe SHBA, nuk kanë dhënë efektet e pritshme, duke treguar se mbështetja ka qenë jo shumë

efikase. Ndoshta dështimi më kryesor lidhet me mungesën e standardeve demokratike në zgjedhjet politike, për të cilat fajtohet jo politika jonë lokale, por roli i miqve perëndimorë duhet të kishte qenë shumë më detyrues/imponues.

4. Si e vlerësoni ndikimin e Ruisë/ Turqisë/ Kinës në Shqipëri?

Edhe pse ka përpjekje të dukshme të Ruisë për të shtrirë ndikimin e vet në Ballkan, Shqipëria ka mbetur jashtë saj. Është fakt se shkëmbimet e niveleve politike janë në nivele të papërfillshme, njësoj siç janë dhe marrëdhëniet ekonomike tregtare dhe të investimeve. Madje, edhe shkëmbimet kulturore kanë qenë shumë rastësore. Nga ana tjetër, Turqia mbetet një aleate e natyrshme e vendit tonë, aq sa ndikimi i saj në Shqipëri është shumë i dukshëm dhe i prekshëm në të gjitha nivelet, që nga shkëmbimet e shpeshta të niveleve të larta politike, raportet e ngushta ekonomike e tregtare, prania e fortë e investimeve turke, edhe në sektorët strategjikë, etj. Kina po zgjeron influencën e vet në rajonin e Ballkanit, por duket se Greqia do të jetë vendi prej ku mund të shtrihet më fort në rajonin tonë. Ka një zgjerim të fortë të influencës së saj politike, si pjesë e rritjes së influencës së saj në Evropën Juglindore, ku bën pjesë dhe Shqipëria.

5. Cila nga këto tri vende (Turqi, Rusi, Kinë) ka ndikimin më të madh në Shqipëri? - Në aspektin (ekonomi, politikë, art/kulturë)?

Roli i Ruisë në Shqipëri ka qenë shumë i pandjeshëm dhe raportet ekonomike e tregtare mbeten të papërfillshme. Ndërsa roli i Turqisë ka qenë përherë i rëndësishëm, edhe për shkak të historisë sonë të përbashkët për shumë shekuj, por mendoj edhe për shkak të rolit balancues ndaj Greqisë. Mendoj se për Shqipërinë është shumë e dobishme zhvillimi i një partneriteti miqësie e bashkëpunimi me Turqinë, roli i së cilës në gjeopolitikën e ardhshme mendoj se do të jetë në një rritje të fortë. Nga ana tjetër, rolin e Kinës e shikoj të dobët, edhe pse sërish kemi një episod historik interesant dhe një rritje relativisht të shpejtë të aktiviteteve ekonomike e tregtare dhe të investimeve kineze në vendin tonë. Kjo është dhe pjesë e ekspansionit kinez në botë, siç shprehet dhe në jetësimin e projektit më të madh të “Rrugës së Mëndafshit”. Sidoqoftë, nga pikëpamja pragmatike, mendoj se marrëdhëniet me Turqinë janë me rëndësi shumë më të lartë strategjike.

Intervistë: Arben Malaj

1. Si e vlerësoni rolin e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor (si aktor politik rajonal)?

Shqipëria ka pasur ka dhe shpresohet se do të ketë një rol në rritje dhe me impakt pozitiv në Ballkanin Perëndimor, kjo sepse:

- a) Shqipëria kurrë nuk ka nxitur konflikte lufte-nxitëse në rajon;
- b) Shqipëria kurrë nuk është prekur nga konflikte fetare;
- c) Shqipëria kurrë nuk është prekur nga konflikte etnike, apo midis rajoneve të ndryshme të vendit.

Konfliktet me background etnik dhe fetar janë në themel të krizave historike të Ballkanit, aq sa Bismark do të shkruante: “Në qoftë se bota do të ketë një luftë tjetër botërore, ajo do të vijë prej çmendurisë së ballkanasve”; ndërsa Çerçilli lidhur me rrënjët e konflikteve në Ballkan do të theksonte, se: “Ballkani prodhon më shumë histori, se sa konsumon”; Lenini do ta konsideronte Ballkanin një fuqi të përhershme baruti... etj. etj. Mentaliteti kulturor i shqiptarëve është mendjehapur. Ata kurrë nuk janë influencuar në qëndrimet dhe zhvillimet shoqërore dhe politike brenda vendit dhe në kontributet e tyre në rajon nga mentalitete të nacionalizmit të sëmurë.

1. The Root Cause of Instability in the Balkans: Ethnic Hatred or Trans-Border Crime?
http://pdc.ceu.hu/archive/00003865/01/Root_Causes_of_Instability.pdf,
2. Dynamic development of the region of the Western Balkans by 2030 – (not) reality?
<http://www.diplomacyandcommerce.rs/dynamic-development-of-the-region-of-the-eastern-balkans-by-2030-not-reality/>

2. Në pikëpamjen tuaj, cilat janë sfidat më të rëndësishme me të cilat po përballet Shqipëria sot (kemi parasysh kursin politik brenda dhe jashtë vendit)?

Sfidat me të cilat është duke u përballur vendi ynë janë të shumta, por në pikëpamjen time tri janë me kryesoret:

a) Koncepti shtet-formues

Ky koncept lidhet drejtpërdrejt me funksionimin e parimeve thelbësore të ndarjes dhe kontrollit të pushteteve, garantimin e të drejtave themelore kushtetuese, liria e mendimit, shprehjes dhe organizmit, garantimi i të drejtave të pronës, mirëqeverisja (*Confuci: "Në një vend që mirëqeverisjet, varfëria e popullit tënd është ajo që të bën të turpëroresh. Në një vend që keqqeveriset, pasuria personale është ajo që të bën të turpëroresh*) administratë publike solide, profesionale dhe e përkushtuar.

Një nga tezat e Serbisë kundër shqiptarëve është ajo, se kombit tonë i mungon kultura shtetformuese. Kështu, sipas serbëve, ne duhet të jemi përherë të copëzuar, sepse sa më të mëdhenj të bëhemi nëpërmjet bashkimit të gjithë shqiptarëve në Ballkanin Perëndimor, aq më të dëmshëm bëhemi për këtë rajon. Kjo është arsyeja kryesore përse çdo fushatë e Serbisë kundër pavarësisë së Kosovës argumentohet me këtë tezë antishqiptare.

b) Kohezioni social

Mungesa e kohezionit social e mban ambientin shoqëror dhe politik të dëmtuar rëndë, e bën atë vulnerabël dhe lehtësisht të ndikueshëm negativisht. Mungesa e tij ushqen politikanët populistë, euroskeptikët dhe radikalët, tendenca të vërtetuara edhe në vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian, si dhe në institucionet drejtuese dhe përfaqësuese të saj.

Kjo tendencë, e ushqyer edhe nga emigracioni në rritje, mund të përkeqësohet në zgjedhjet parlamentare në BE, duke ndikuar jo pak prioritetet dhe agjendën e saj, nga e cila mund të vonohet, dëmtohet apo pengohet agjenda e integritit euroatlantik të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilët ndodhen në faza të ndryshme të këtyre proceseve (mund të bësh një grafik se ku ndodhet aktualisht çdo vend i Ballkanit në procesin e integritimeve euroatlantike – gjen harta të gatshme në internet. <https://www.westbalkan2030.com/>)

c) Deficiti demografik

Është gjithashtu një nga sfidat kryesore sociale, i ushqyer nga rënia e lindjeve, migrimi i madh dhe plakja e popullsisë. Mungesa e politikave efektive për të reduktuar deficitin demografik përbën një rrezik të madh:

- (i) social - që lidhet drejtpërdrejtë me zvogëlimin e burimeve njerëzore të rritjes;
- (ii) buxhetor - sepse deficitet e skemave dhe politikave sociale vijnë duke u përkeqësuar;
- (iii) politike - sepse rritja e emigracionit ka nxitur paqëndrueshmërinë sociale e politike edhe në vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian.

Një ambient social dhe politik pa kohezion dhe solidaritet social, rrit pasigurinë dhe paqartësitë për të ardhmen, kjo dëmton zhvillimet dhe arritjet ekonomike, sociale dhe politike sepse tkurren shpenzimet dhe investimet individuale dhe të biznesit, bie rritja ekonomike, rritet papunësia, rritet varfëria. Vendi dominohet nga një pasivitet shoqëror, individët shikojnë si zgjidhje jo përmirësimin e sistemit social, ekonomik e politik, por braktisjen e vendit të tyre.

Economic and social cohesion of the Western Balkans: Challenges and priorities
<https://europeanwesternbalkans.com/2018/02/01/economic-social-cohesion-western-balkans-challenges-priorities/>

3. Si e vlerësoni ndikimin e vendeve perëndimore SHBA, BE në Shqipëri?

Ndikimi i SHBA-së është i madh dhe i mirëpritur. Ajo ka kontribut të jashtëzakonshëm, që në vitin 1919 për mos zhdukjen / ndarjen e shtetit shqiptar, ndërtimin dhe konsolidimin e tij.

Pas viteve 1990, SHBA-ja inicioi dhe mbështeti Shqipërinë në periudhën e tranzicionit postkomunist, si dhe në hapat e parë të pluralizmit politik dhe hapjen e ekonomisë ndaj tregut të lirë.

Aktualisht mbështetja e tyre është sidomos në vendosjen e prioritetëve dhe kryerjen e reformave të rëndësishme që vendi ynë duhet të kryejë. Mbështetja e SHBA-së ka qenë e pazëvendësueshme në anëtarësimin e Shqipërisë në NATO dhe njëherazi në rrugëtimin e saj drejt Bashkimit Evropian.

Ndërsa BE-ja është partneri ekonomik kryesor i Shqipërisë, kjo bazuar në volumet tregtare, eksport-import, investimet e huaja direkte dhe fondet mbështetëse në aspektin bilateral me

vendet e BE-së dhe në atë multilateral, midis Shqipërisë, fondeve të BE-së dhe mbështetjet me kredi nga BERZH dhe BEI.

Bashkimi Evropian përfaqëson destinacionin e përbashkët të vendeve të Ballkanit Perëndimor bazuar në modelin e saj, ku nëpërmjet bashkëpunimit dhe integritit ekonomik synohet të eliminohen konfliktet dhe luftërat në këtë rajon, duke vendosur paqen, garantuar sigurinë dhe prosperitetin për mbarë vendet e rajonit. Bashkëpunimi me BE-në ka pasur luhajat reciproke për shkak të krizave të saj të brendshme, debatet, apo lodhja nga zgjerimi, konceptet e thellimit me dy shpejtësi dhe elemente të tjerë. Procesi është vështirësuar edhe nga dështimet e BE-së, sidomos goditja e saj nga papunësia në rritje, amullia e rritjes së të ardhurave, klimë e cila ka ushqyer rrymat populiste, euroskeptikët dhe radikalët, të cilët, nëse nuk frenohen në trendin e tyre rritës, mund të dëmtojnë projektin e BE-së. Marrëdhëniet BE-Shqipëri kanë brenda tyre dhe vonesat, deformimet dhe dështimet e vendit tonë në përmbushjen e prioriteteve kushtëzuese të integritit të tij në BE. Megjithatë, BE ka qenë më shumë një mollë sherri, sesa një prioritet real për partitë politike shqiptare.

4. Si e vlerësoni ndikimin e Rusisë/ Turqisë/ Kinës në Shqipëri?

Turqia

Ndikimi i saj duhet ndarë në dy dimensione: ekonomik dhe politik. Ka një lidhje të ndërsjellë shkak-pasojë midis këtyre dy ndikimeve.

Ndikimi politik tenton të përdoret për ndikim ekonomik, ku vartësia ekonomike përdoret për qëllime gjeopolitike. Në këtë aspekt, Turqia vlerësohet si vendi me një agjendë deri dhe imponuese për të rritur influencën politike dhe ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor. Deklarata, se Prizreni, Prishtina, Sarajeva, janë Turqia, janë dëgjuar jo rrallë këto vitet e fundit në vendet tona.

Teza politike e rindërtimit të perandorisë turke, duket se kushtëzon marrëdhëniet politike të Turqisë me vendet e Ballkanit, ku synohet të diktohen deri edhe në zhvillimet e brendshme politike në rajonin tonë. Investimi direkt i Turqisë, duke mbështetur parti tradicionale apo

duke nxitur dhe mbështetur parti të reja pro turke, e ka bërë më të cenueshëm dhe të paqëndrueshëm ambientin politik në Ballkan.

- Rebuilding the Turkish Empire: Fantasy or Reality?

https://www.realclearpolitics.com/articles/2013/04/17/rebuilding_the_turkish_empire_fantasy_or_reality_118004.html,

- Turkey and the Western Balkans: The Challenges for EU Enlargement

<https://rcc.harvard.edu/event/turkey-and-western-balkans-challenges-eu-enlargement>,

- The return of Turkey to the Western Balkans: A challenge or an opportunity for the European Union?

https://www.researchgate.net/publication/306298249_The_return_of_Turkey_to_the_Western_Balkans_A_challenge_or_an_opportunity_for_the_European_Union

Rusia

Lidhur me ndikimin e Ruisë në rajonin tonë *synimet e saj janë gjeopolitike*. Pas rënies së Murit të Berlinit, shpërbërjes së Bashkimit të ish-Republikave Ruse, daljes jashtë ndikimit të saj të Evropës Lindore, Rusia ka rritur angazhimin e saj të drejtpërdrejtë ose tërthorazi për ta rikthyer influencën e saj në ish-kufijtë gjeografikë të Luftës së Ftohtë. Kjo nuk është e lehtë, sepse shumë prej ish-republikave ruse dhe vendeve vasale të saj janë tashmë anëtare të NATO-s dhe BE-së. Në këto kushte, pjesa “më e lehtë” për Rusinë për të krijuar, ruajtur apo rritur influencën e saj gjeopolitike, është aktualisht Ballkani Perëndimor. Direkt apo indirekt, me influencë të madhe ekonomike e politike, apo me influencë simbolike, Rusia kërkon të jetë në tavolinën e vendimmarrjeve për perspektivën euroatlantike për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe të influencojë këtë agjendë në objektivat dhe kohën e arritjes së tyre, siç ndodhi me rastin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ku (jo) papritur dhe (jo) pa mirëkuptim, në heshtje, forcat ruse morën në kontroll aeroportin e Prishtinës, duke e bërë Rusinë publikisht aktore në këto zhvillime.

Këmbëngulja e Ruisë për të ruajtur influencën e saj në Ballkan, kërcënimi i rrezikut rus në ekonominë dhe zhvillimet politike të këtyre vendeve, kanë sjellë si pasojë rritjen e

angazhimit të NATO-s dhe kanë vënë nën presion Bashkimin Evropian për të përshpejtuar anëtarësimin e vendeve të Ballkanit, duke filluar me Rumaninë dhe Bullgarinë, anëtarësimin në NATO të Shqipërisë dhe Malit të Zi, Ndarjen e Malit të Zi nga Serbia, duke bllokuar daljen në Mesdhe të Rusisë nëpërmjet Serbisë dhe garantimin e të ardhmes euroatlantike të Ballkanit Perëndimor.

Një gjë duket se nuk do të jetë e lehtë për rajonin tonë: Sa më shumë vende anëtarësohen në NATO dhe BE, aq më e vendosur, më e qartë dhe me kalendar bllokues apo provokues bëhet ndërhyrja e Rusisë ndaj pjesës së mbetur, siç ndodhi me Malin e Zi, përpara anëtarësimin në NATO, apo një influence ruse në rritje në BE dhe në vende specifike, si Greqi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë.

- Russia-western Geopolitical Rivalry Returns to the Balkans
<https://www.voanews.com/a/russia-western-geopolitical-rivalry-returns-to-the-balkans/4672832.html>
- There is Life Beyond the EU: Russia, Turkey and China in the Western Balkans
<https://www.ispionline.it/it/pubblicazione/there-life-beyond-eu-russia-turkey-and-china-western-balkans-20528>
- Why it's such a big problem for Putin if the Balkan countries enter the EU
<https://www.independent.co.uk/voices/putin-balkan-countries-eu-join-russia-problem-serbia-albania-a8355866.html>

Kina

Në kontekstin e brendshëm, Kina është duke u përballur me sfida jo të lehta, siç janë sfida sociale, rreziqe demografike, pabarazi e theksuar midis rajoneve të ndryshme, risku për një krizë të rëndë financiare për shkak të subvencionimit me kredi nga bankat shtetërore të ndërmarrjeve të mëdha publike, të cilat janë jo fitimprurëse, si dhe shumë risqe të tjera potenciale. Me gjithë këtë panoramë të brendshme, Kina ka arritur të jetë një fuqi globale në rritje dhe “kërcënuese” për një pozicion të saj si përcaktues në tregjet globale. Për të arritur këtë influencë globale, Kina është shumë “agresive” nëpërmjet kredidhënies së saj të butë për

regjime totalitare, jo demokratike, në vende të varfra, apo në zhvillim, me qëllim të qartë, duke synuar tregjet e tyre, por edhe varfërinë për shkak të krizës që i pret edhe nga keq shfrytëzimi i pasurive natyrore që këto vende lënë peng për kthimin Kinës e të kredive të saj. Sot ekspertët analizojnë nëse kjo politikë e ndihmave të huaja nga Kina për këto vende është “Messia” - shpëtimtarja e tyre apo është një “Mostër” e fshehur që do t’i hajë/skllavërojë më tej këto vende.

Sigurisht, një analizë më e plotë duhet bazuar tek parimet, faktorët dhe format e kushtëzimit të ndihmës së huaj të profesorit të Harvard University Alberto Alessina. Kina është duke punuar shumë fort dhe duke shpenzuar miliarda jua për iniciativa si “16+1” ose e titulluar “One road, one belt”.

Who Gives Foreign Aid to Whom and Why?

<https://scholar.harvard.edu/alesina/publications/who-gives-foreign-aid-whom-and-why>

Zgjerimi në tregjet e reja në çdo pjesë të botës, akses në rritje në korridoret globale të zhvillimit, si hekurudha, autostrada, portet dhe aeroportet, janë në qendër të kësaj strategjie zhvillimi.

Çdo fuqi globale kërkon futje në potencialet globale e rajonale të zhvillimit, kërkon me shumë përfshirje në flukset tregtare të zhvillimit të tregjeve.

Sot, Kina është fuqia më e madhe lidhur me madhësinë e PBB (Produktit të Brendshëm Bruto), por nga ana tjetër, nëse i referohemi të ardhurave për frymë, në këtë vend ajo ngelet akoma pas.

Rritja e të ardhurave për frymë, reduktimi i varfërisë tani është bërë një sfidë më e rëndë, sepse rritja ekonomike e Kinës nga 10-12 % e PBB-së për shumë vite, aktualisht është reduktuar 5-7 % e PBB-së.

Iniciativa e Kinës për krijimin e grupit BRIC-s, e bënë atë drejtuese të bllokut më të madh ekonomik. Monedha kombëtare kineze Rinmin është sot pjesë e shportës së monedhës së

FMN-së, SDR – E drejta speciale e tërheqjes, duke rritur influencën e Kinës edhe në institucionet financiare ndërkombëtare.

Aktualisht sfida më e vështirë e Kinës është pamundësia që për një kohë relativisht të gjatë të arrijë një zhvillim ekonomik e social linear, pra vetëm rritje dhe rritje të larta. Pa dyshim, Kina do të preket nga krizat demografike, sociale, buxhetore, ekonomike, parandalimi i tyre dhe menaxhimi i kujdesshëm bazuar në politika ekonomike, monetare, financiare dhe reforma strukturore të rritjes së produktivitetit të ekonomisë kineze, do të kushtëzojnë kohën e shfaqjes dhe ashpërsinë e pasojave. Pavarësisht këtyre prognozave, Kina po synon dhe punon çdo ditë për rritjen dhe thellimin e influencës së saj në Ballkan.

Beogradi konsiderohet si kryeqyteti kinez i Ballkanit. Në çdo vend të rajonit, veç Shqipërisë, Kina ka arritur të ofrojë kredi të buta, të cilat përmbajnë të njëjtat rreziqe potenciale.

Në vendin tonë biznesi privat kinez është rritur. Qeveria kineze është e “pakënaqur” për mos arritjen e ndonjë projekti të rëndësishëm ndërqeveritar në investimet në infrastrukturë, të financuar me “kredi të butë”. Por, nga ana tjetër, prezenca e kompanive private kineze është rritur në sektorë të rëndësishëm të vendit, si aeroport dhe naftë, por akoma nuk është materializuar në sektorë të tjerë të ekonomisë dhe, sidomos, atë financiare, ku përfshihen bankat dhe investimet financiare të larmishme. Kisinger ka theksuar se çdo shekull ka superfuqinë e tij. Kjo është sfida e Kinës, do të jetë ajo superfuqia ekonomike, ushtarake dhe politike e shekullit të 21-të?

a) China, the Western Balkans and the EU: Can three tango?

<https://www.euractiv.com/section/energy/opinion/china-the-western-balkans-and-the-eu-can-three-tango/>

b) Beware Chinese Trojan horses in the Balkans, EU warns Commissioner Johannes Hahn also pushes back against Emmanuel Macron’s enlargement skepticism.

<https://www.politico.eu/article/johannes-hahn-beware-chinese-trojan-horses-in-the-balkans-eu-warns-enlargement-politico-podcast/>

c) Chinese investment is winning hearts and minds in western Balkans

<https://www.scmp.com/news/china/diplomacy-defence/article/2152298/chinese-investment-winning-hearts-and-minds-western>

d) China's Aid to Africa: Monster or Messiah?

<https://www.brookings.edu/opinions/chinas-aid-to-africa-monster-or-messiah/>

e) Face It, China Totally Owns The BRICS

<https://www.forbes.com/sites/kenrapoza/2017/09/01/china-owns-the-brics/#3187d63878f0>

f) China Goes Global

<https://www.fpc.org.uk/wp-content/uploads/2006/09/449.pdf>

g) China's economic problems are exactly why its global influence is expanding

<https://www.cnbc.com/2017/08/10/chinas-economic-problems-are-exactly-why-its-global-influence-is-expanding.html>

h) The Challenge of China

http://www.chinaelections.org/upload/file/20150531/20150531080754_9864.pdf

5. Sipas jush, cila nga këto tri vende (Turqi, Rusi, Kinë) ka ndikimin më të madh në Shqipëri? - Në aspektin (ekonomi, politikë, art/kulturë)?

Në aspektin ekonomik

Turqia është më prezent në ekonominë shqiptare (Instituti i Statistikës ka të dhëna për ecurinë e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe këtyre vendeve), por vitet e fundit Kina është duke e konkurrar, përmendim këtu kompanitë e saj koncensionare në Aeroportin e Tiranës dhe kompaninë më të madhe në nxjerrjen e naftës. Projekti i tyre “One road, one belt”, është një investim afatgjatë për rritjen e influencës së saj tregtare dhe politike në vendin dhe rajonin tonë.

Në aspektin politik

Turqia ka influencën më të madhe jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon, sidomos tek shqiptarët në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, ku janë vënë re financime direkte ose indirekte nga faktorë të ndryshëm në Turqi, për të krijuar parti të reja, të cilat edhe pse të vogla, mund të kenë ndikim jo të vogël në konfigurimet politike në parlamentet dhe qeveritë e këtyre vendeve.

Ndikimet e Ruisë janë më shumë në gjeopolitikë, sesa në ndikime të drejtpërdrejta në politikë nëpërmjet partive apo lëvizjeve të reja politike.

Arte dhe kulturë

Diplomacia kulturore është sot një instrument i rëndësishëm i synimeve gjeopolitike. Turqia është vendi me vizion dhe strategji afatgjatë dhe me projekte konkrete, sidomos nëpërmjet kinematografisë dhe filmave, për të promovuar sa më shumë kulturën e tyre.

Kina tenton ta zgjerojë këtë ndikim nëpërmjet institutit “Confuci” dhe shumë aktiviteteve kulturore në promovimin e projektit të saj “16+1” në Ballkanin Perëndimor.

Intervistë: Grida Duma

1. Si e vlerësoni rolin e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor (si aktor politik rajonal)?

Shqipëria është një treg i vogël në rajon; shpesh politikanët e nxjerrin nga perspektiva reale rolin e Shqipërisë, duke e shumëzuar me koeficient ngritës ose zbritës, çka e nxjerr Shqipërinë jashtë realitetit: ose shumë më e papërfillshme, ose shumë më e rëndësishme se ç’është. Roli i Shqipërisë në rajon është padyshim konstruktiv. Do të mbetet i tillë, nëse Shqipëria do të dijë t’u rezistojë tundimeve të populizmit që e shfrytëzon nacionalizmin për qëllime të ngushta elektorale. Asnjë vend, as vetë Shqipëria, nuk është i imunizuar nga ky fenomen.

2. Në pikëpamjen tuaj, cilat janë sfidat më të rëndësishme me të cilat po përballlet Shqipëria sot (kemi parasysh kursin politik brenda dhe jashtë vendit)?

Siç e përmenda më lart, Shqipëria duhet të dijë t'i rezistojë virusit të populizmit dhe aplikimit të tij në politikat e jashtme dhe marrëdhëniet me fqinjët. Në fakt, kjo dukuri nuk është diçka që ndoshta i përket së ardhmes – është pjesë e realitetit dhe aktualitetit. Sfida kryesore e Shqipërisë është shndërrimi i saj në një vend të aftë të konkurrojë me vendet e rajonit, përpara se të bëjmë propagandën e zakonshme, që e sheh vendin tonë konkurrent në rrafsh global. Shqipëria ka sfida kryesore të rritë produktivitetin; që kjo të ndodhë, ajo duhet të zhvendoset nga një ekonomi që kombinon në absurditet ultra-etatizmin dhe ultra-liberalizmin në një sistem më të hapur, më liberal, bazuar në tregun e hapur dhe konkurrencën e ndershme. Sfidë e madhe është shkëputja nga përqendrimi i kartelizimit të tregjeve dhe nga komprometimi i karteleve me ekonominë e krimit, që punon me marzhe të jashtëzakonshme fitimi që nuk e lë të marrë frymë biznesin e ndershëm. Nëse Shqipëria e bën këtë, ajo do të ketë ndoshta një shans të rrisë të ardhurat deri në një nivel më të pranueshëm konvergjence në BE. Nëse vazhdojmë kështu siç e kemi nisur, shqiptarët nuk do arrijnë kurrë të jenë ekonomikisht evropianë

3. Si e vlerësoni ndikimin e vendeve perëndimore SHBA, BE në Shqipëri?

Ndikimi mbetet i madh dhe pozitiv. Shoh një fokusim amerikan ndaj Kosovës që shpresoj të zgjerohet edhe në drejtim të Shqipërisë. Gjithsesi, pavarësisht rreshtimeve të politikës së brendshme, Shqipëria ka qenë një bashkëpunëtor i besueshëm për partnerët perëndimorë, dhe do të vazhdojë të jetë. Është koha që partnerët perëndimorë të theksojnë më shumë rëndësinë e të pasurit në thelb demokracie funksionale brenda Shqipërisë, nëse ky thelb dëmtohet pa kthim, partneriteti me Shqipërinë shndërrohet në një shkëmbim fasadash.

4. Si e vlerësoni ndikimin e Ruisë/ Turqisë/ Kinës në Shqipëri?

Aty ku politika e brendshme stonon, hapen digat e ndikimeve të jashtme. Kina është në ekspansion të plotë global, dhe kjo padyshim e ndikon edhe Shqipërinë. Kina ka blerë Aeroportin e Rinasit dhe duket shumë e interesuar të depërtojë kudo që shikon një mundësi. Rusia përpiqet të depërtojë me metoda më indirekte, nëpërmjet të tretëve, duke përdorur kryesisht levën ekonomike si dhe inteligjencën. Turqia e ka rritur ndjeshëm ndikimin dhe prezencën e saj rajonale, dhe kjo shkon në përpjesëtim të drejtë me rritjen e saj të rrafshme ekonomike në dekadën e parë të mijëvjeçarit të ri.

5. Sipas jush, cila nga këto tri vende (Turqi, Rusi, Kinë) ka ndikimin më të madh në Shqipëri? - Në aspektin (ekonomi, politikë, art/kulturë)?

Këto tri vende kanë ndikime në rrafshet dhe dimensionet, që lidhen me specifika shumë të ndryshme të secilës prej tyre. Ndikimi më i madh i Kinës shtrihet në rrafshin ekonomik, me ndikime politike të zhvendosura në kohë. Ndikimi turk është më imediat, pasi kondicionalitetet politike janë më afër me ndikimin ekonomik, kurse ndërveprimi kulturor me Turqinë është shumë më i madh. Rusia është disi më e tërhequr, më e kamufluar dhe më e reduktuar në të dyja aspektet, por kjo nuk e bën atë inekzistente, përkundrazi.

Intervistë: Gentian Elezi

1. Si e vlerësoni rolin e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor (si aktor politik rajonal)?

Roli i Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor gjatë dy dekadave të fundit ka qenë përgjithësisht pozitiv dhe konstruktiv. Kjo është theksuar edhe nga Komisioni Evropian në raportet e tij, si dhe nga aktorë të tjerë ndërkombëtarë. Megjithatë, vitet e fundit ka pasur disa raste dhe momente ku deklarata të caktuara të drejtuesve politikë në Shqipëri janë interpretuar si jo në ndihmë të stabilitetit rajonal. Kryesisht, këto kanë qenë të lidhura me Kosovën dhe rolin që Shqipëria ka në mbrojtjen e të drejtave të Kosovës në arenën ndërkombëtare, veçanërisht në procesin e integritetit evropian. Edhe pse sporadike dhe pa vijueshmëri veprimesh, këto qëndrime janë kritikuar nga përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe të Serbisë. Përveç këtyre rasteve jo të shpeshta, roli i Shqipërisë vazhdon të jetë konstruktiv në rajon.

2. Në pikëpamjen tuaj, cilat janë sfidat më të rëndësishme, me të cilat po përballet Shqipëria sot (kemi parasysh kursin politik brenda dhe jashtë vendit)?

Sfidat kryesore, me të cilat përballet Shqipëria, së brendshmi lidhen me dobësinë e shtetit të së drejtës dhe reformave përkatëse. Lufta ndaj korrupsionit (sidomos në nivelet e larta) dhe beteja sistematike dhe strukturore me krimin e organizuar mbeten ende fushat ku vendi nuk po përparon mjaftueshëm. Bashkë me përshpejtimin dhe zbatimin me sukses të reformës në drejtësi, këto sfera përbëjnë edhe pengesën kryesore të vendit në proceset integruese.

Destabiliteti politik, që vjen edhe si rrjedhojë e mungesës së një kulture politike konstruktive, e ka vështirësuar më tej punën e përbashkët që nevojitet për t'i bërë ballë këtyre sfidave.

Për sa i përket sfidave të jashtme, Shqipëria nuk ka mundur ende të krijojë një imazh pozitiv tek partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht vendet e Bashkimit Evropian. Si rrjedhojë, procesi i integritetit është i rrezikuar dhe parashikohet të jetë tejet i ngadaltë edhe nëse vendi fillon bisedimet për anëtarësim në BE. Krahas kësaj, kriza që po kalon vetë BE-ja nga pikëpamja institucionale dhe e koordinimit të përbashkët, është një tjetër risk dhe sfidë me pasoja për Shqipërinë, pasi vështirëson më tej procesin.

3. Si e vlerësoni ndikimin e vendeve perëndimore SHBA, BE në Shqipëri?

SHBA dhe BE konsiderohen partnerët kryesorë dhe strategjikë të Shqipërisë që pas rënies së komunizmit. Pavarësisht ndonjë momenti apo periudhe krize, në përgjithësi ky orientim ka qenë i palëkundur gjatë pothuaj tri dekadave të fundit.

SHBA ka pasur një pozicionim strategjik dhe koherent ndaj Shqipërisë, duke i mëshuar stabilitetit dhe orientimit demokratik të vendit. Pavarësisht ndryshimit të intensitetit të përfshirjes sipas periudhave dhe nevojave, prania e SHBA ka qenë konstante, edhe duke u përplasur shpesh me interesa politike të aktorëve të brendshëm. Parë nga ky këndvështrim, si aktor global, SHBA ka ushtruar shpesh tryzni ndaj politikës vendase në drejtim të shtyrjes përpara të reformave dhe konsolidimit institucional në vend.

BE është angazhuar pak më gradualisht në rajon, duke ndjekur politikën e kushtëzimit dhe duke ofruar perspektivën e anëtarësimit. Kjo mundësi ka bërë që Shqipëria të ndjekë rrugëtimin e procesit të integritetit dhe politikanët e ndryshëm të adoptojnë retorikën dhe mbështetjen publike ndaj këtij objektiv. Pavarësisht kësaj, angazhimi i BE është shfaqur relativisht më i dobët se SHBA në momente kyçe ose në raste krizash. Fuqia bindëse dhe trysnia që BE supozohet të ushtrojë në këto raste, nuk ka rezultuar gjithmonë efikase, diktuar edhe nga problematika të brendshme e strukturore të BE-së, sa herë që bëhet fjalë për politikën e jashtme apo të zgjerimit.

Në përgjithësi, të dy këta aktorë globalë kanë luajtur një rol pozitiv dhe shtytës për reformat në Shqipëri, duke mbajtur orientimin e vendit drejt konsolidimit demokratik.

4. Si e vlerësoni ndikimin e Rusisë/ Turqisë/ Kinës në Shqipëri?

Rusia duket të ketë ndikim minimal në Shqipëri dhe nuk ka pasur fakte të rëndësishme, që tregojnë se mund të ketë një interes apo potencial për të vepruar, të paktën në periudhën afatshkurtër dhe afatmesëm.

Turqia është e pranishme në Shqipëri me disa investime strategjike, si dhe me marrëdhënie të vazhdueshme politike. Vitet e fundit kjo prani është shtuar dhe marrëdhëniet janë intensifikuar, por pa prekur elementë thelbësorë të qeverisjes apo ekonomisë së vendit. Kjo prani ka shkaktuar shpesh edhe debate publike, por që për momentin nuk ndikojnë orientimin strategjik të Shqipërisë.

Kina ende nuk ka shfaqur një interes të mirëfilltë në Shqipëri, qoftë nga pikëpamja politike, por edhe ekonomike. Kjo qasje është pak a shumë e ngjashme edhe për vendet e tjera të Ballkanit. Pavarësisht tentativave për disa investime strategjike, nuk mund të thuhet ende se ka një prani domethënëse në Shqipëri.

5. Cila nga këto tri vende (Turqi, Rusi, Kinë) ka ndikimin më të madh në Shqipëri? - Në aspektin (ekonomi, politikë, art/kulturë)?

Asnjë nga këto vende nuk ka ndikim domethënës në Shqipëri nga pikëpamja e drejtimit strategjik të vendit, por midis të treve, Turqia ka patjetër ndikimin më të madh. Kjo i aplikohet të gjitha fushave.

Intervistë: Klajda Gjosh

1. Si e vlerësoni rolin e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor (si aktor politik rajonal)?

Shqipëria ka luajtur gjithmonë një rol konstruktiv në rajon edhe për faktin e ekzistencës së faktorit shqiptar në pjesën më të madhe të vendeve, duke promovuar politikat e fqinjësisë së mirë. Ka qenë gjithmonë modeli i bashkëjetesës fetare, si një vend unik në këtë çështje, duke

dhënë shembullin më të mirë për rajonin dhe përtej. Shqipëria ka pasur një rol të veçantë në pavarësinë e Kosovës dhe është munduar të luaj një rol stabilizues në marrëdhënien Kosovë-Serbi.

2. Në pikëpamjen tuaj, cilat janë sfidat më të rëndësishme, me të cilat po përballlet Shqipëria sot (kemi parasysh kursin politik brenda dhe jashtë vendit)?

Shqipëria sot po përballlet më shumë me problemet e brendshme, ku gjithmonë ka dominuar mungesa e dialogut politik. Kjo ka sjellë një krizë demokracie, mungesë të funksionimit të institucioneve, pamundësi të zhvillimit të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme dhe e gjitha kjo ka sjellë edhe rrënim të ekonomisë. Kjo situatë e zyrtë dhe disi e pashpresë, ka shkaktuar një valë të madhe të largimit të pjesës më të madhe të shtresës së mesme, profesionistëve dhe të rinjve. Situata e brendshme nuk e ndihmon pozicionin e Shqipërisë me BE-në, madje e ka penalizuar atë edhe në vendimin e çeljes së negociatave.

3. Si e vlerësoni ndikimin e vendeve perëndimore SHBA, BE në Shqipëri?

Ndikimi i SHBA-së dhe BE-së ka qenë jetik për Shqipërinë në shumë momente kyçe. Nëse ne kemi pasur një prioritet, ka qenë ai i integritetit euroatlantik. Kjo e ka bërë Shqipërinë shpeshherë të pacenueshme nga palët e treta. SHBA-ja dhe BE-ja kanë luajtur rol vendimtar në stabilitetin e Shqipërisë, duke zgjidhur edhe një sërë krizash të politikës tonë të brendshme. Janë dy partnerë që kanë investuar pafund në reforma kyçe, duke shtyrë kështu përpara, si modernizimin, ndryshimin e mentalitetit, rritjen e standardeve dhe perspektivën tonë evropiane.

BE gjithashtu dallon edhe për investimet kryesore në vendin tonë, duke i dhënë një mbështetje sektorit ekonomik. Megjithatë, Evropa dhe Shtetet e Bashkuara, në mos po distancohen më tepër, me siguri nuk po gjenerojnë një imazh të ambicies së përbashkët dhe kjo realisht reflektohet së fundmi edhe te fokusi ndaj Shqipërisë dhe Ballkanit Perëndimor. Kjo është vënë re edhe në krizën e fundit që po kalon Shqipëria.

4. Si e vlerësoni ndikimin e Rusisë/ Turqisë/ Kinës në Shqipëri?

Mendoj se vendi që ndikon më shumë në politikën dhe ekonominë shqiptare është Turqia, e cila disponon një pjesë të mirë të investimeve në disa sektorë, duke filluar me edukimin, ushrinë, biznesin e vogël dhe të mesëm. Gjithmonë ka qenë një pikëpyetje roli i Erdoganit në lidhje me kryeministrin Rama dhe influenca e tij në politikë. Kina dhe Rusia nuk kanë qenë asnjëherë influencuese në politikën tonë, pasi gjithmonë ne i kemi qëndruar besnikë perspektivës evropiane.

5. Cila nga këto tri vende (Turqi, Rusi, Kinë) ka ndikimin më të madh në Shqipëri? - Në aspektin (ekonomi, politikë, art/kulturë)?

Të tria vendet e shohin Shqipërinë në një rol kyç gjeostrategjik. Në përgjithësi, Shqipëria i ka mirëpritur investimet e të tri vendeve, por asnjëherë nuk ka pasur alternativë tjetër veç asaj të BE-së, ndaj ndikimi në këtë vizion është thujse zero. Ndikimin më të madh nga të tri vendet sigurisht që e ka Turqia, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në politikë dhe kulturë, por edhe në aspektin fetar, pasi vendi ynë përbehet nga një shumicë qytetarësh të fesë myslimane.

Intervistë: Ylljet Aliçka

1. Si e vlerësoni rolin e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor (si aktor politik rajonal)?

Në analizat e bëra nga studiuesit e rajonit të Ballkanit, cilësimi i Shqipërisë si faktor stabiliteti dhe paqeje është i gjithëpranuar. Sigurisht, në këtë drejtim Tiranës zyrtare i takon të bëjë më tepër kundrejt shqiptarëve, të cilët jetojnë të ndarë në 5 shtete të ndryshme, si në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbi (Lugina e Preshevës dhe Bujanovcit), ku pikë reference pa asnjë diskutim mbetet Tirana zyrtare.

Ky status i Tiranës zyrtare nuk duhet parë vetëm si privilegj, por edhe si detyrim i saj për të akomoduar e mbrojtur jo vetëm interesat civile e qytetare, por edhe ato politike e ekonomike të faktorit shqiptar në të gjitha trojet ku ata banojnë, pavarësisht shtetit të cilit i përkasin.

2. Në pikëpamjen tuaj, cilat janë sfidat më të rëndësishme me të cilat po përballlet Shqipëria sot (kemi parasysh kursin politik brenda dhe jashtë vendit)?

Problemet dhe sfidat e shtetndërtimit të Shqipërisë janë të shumta, por nëse mund të veçojmë ato më thelbësoret, nënvizojmë *reformën në drejtësi*, pra filtrimin e të gjithë trupës së sistemit gjyqësor dhe atë të prokurorisë, si dhe ngritjen e strukturave të posaçme të cilat do të godasin korrupsionin në nivelet më të larta shtetërore. Një tjetër sfidë e Shqipërisë mbetet *integrimi evropian*. Kjo tezë për shqiptarët është përdorur dhe keqpërdorur së tepërmi nga politika dhe politikanët në këto 30 vitet e fundit. Por mesa duket ka qenë vetëm një tezë për konsum politik nga të gjitha palët, pasi në momentet vendimtare për vendin, ato (Partitë politike dhe liderët e saj) asnjëherë nuk e kanë gjetur gjuhën e përbashkët për të lënë mënjanë interesat e vogla partiake të momentit, por të vendosnin agjendën e integritit si prioritet kombëtar.

3. Si e vlerësoni ndikimin e vendeve perëndimore SHBA, BE në Shqipëri?

Pa asnjë diskutim që aktorët më të rëndësishëm politikë dhe ekonomikë të Shqipërisë janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian.

Ndikimi i këtyre dy superfuqive ka qenë parësor për rrugën e Shqipërisë në konsolidimin e sfidave të saj. Miqësia dhe partneriteti midis vendit tonë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka rrënjë historike, përmendim mbështetjen e Presidentit Willson në Konferencën e Paqes, në Paris, në favor të çështjes shqiptare. Kjo mbështetje shënon një moment historik për kombin shqiptar, si dhe ka qenë pikënisje e një miqësie afatgjatë.

Nga ana tjetër, partneriteti strategjik midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian ka kontekst tjetër, pasi Shqipëria është pjesë e Evropës gjeografikisht, kulturalisht dhe në të gjitha dimensionet e tjera, sidomos ekonomike. Si e tillë, ajo të gjithë veprimtarinë e saj dhe qasjen shtetformuese nuk mund ta ketë ndryshe nga vlerat evropiane.

Përtej kontekstit historik, si me SHBA-në, ashtu dhe me BE-në, bashkëpunimi dhe lidhjet me këto dy superfuqi ekonomike dhe politike, Shqipëria i ka të pandërprera dhe me fokus të qartë.

4. Si e vlerësoni ndikimin e Rusisë / Turqisë / Kinës në Shqipëri?

Shtetet si Rusia, Turqia apo dhe Kina, po vihen re dukshëm së fundmi me interesat e tyre në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në Shqipëri. Kuptohet, secila me ambicien dhe interesat e saj, të cilat jo domosdoshmërisht duhet të konvergojnë me njëra-tjetrën.

Rusia më së tepërmi, qasjen e saj në këtë rajon e ka kryesisht gjeopolitik, ndërsa Turqia kryesisht është ekspozuar më tepër në dimensionin ekonomik, nga ana tjetër Kina gjithashtu po i afrohet këtij rajoni nëpërmjet qasjes ekonomike.

Por në pikëpamjen time, asnjëra nga këto superfuqi, pavarësisht ambicieve të shprehura në fushat që përmenda më sipër, nuk mund t'i konsideroj si influenca të cilat kanë efekte afatgjata në këtë rajon.

5. Cila nga këto tri vende (Turqi, Rusi, Kinë) ka ndikimin më të madh në Shqipëri? - Në aspektin (ekonomi, politikë, art/kulturë)?

Aktualisht Turqia ka një prani më të fortë në rajonin e Ballkanit dhe Shqipëri, kryesisht në fushën ekonomike. Kjo vihet re përmes investimeve të saj në këtë rajon, gjë e cila e veçon atë nga dy vendet e tjera: Rusia dhe Kina. Nga ana tjetër, Kina gjithnjë e më shumë po e evokon qasjen e saj dhe nevojën për ekspansion në rajonin e Ballkanit, duke investuar në marrëdhëniet e drejtpërdrejta të këtij rajoni dhe me investime të qarta në infrastrukturë. Të gjitha këto elemente e bëjnë Kinën të konsiderohet si aktor në rritje në këtë rajon në një periudhë afatmesme.

Sa i takon Rosisë, në pikëpamjen time, nuk shoh një qartësi të ndikimit të saj në Shqipëri.

SHTOJCA 3: ANALIZAT SASIORE

Tabela 8. Testi t: Sfidat kryesore të vendit (1)

	N	Mesatarja	Devijimi standard	Gabimi standard
Sfidë Vizioni	498	3.05	1.364	.115
Sfidë Vendet Joperëndimore	498	2.61	1.044	.088
Sfidë Radikalizmi Fetar	498	1.59	.936	.079
Sfidë Krimi i Organizuar	498	3.78	1.253	.106

Tabela 8.1. Testi t: Sfidat kryesore të vendit (2)

	Vlera e testit = 0					
	t	df	Sig.	Diferenca mesatare	95%	
					E poshtme	Sipërme
Sfidë Vizioni	26.455	497	.000	3.050	2.82	3.28
Sfidë Vendet Joperëndimore	29.559	497	.000	2.607	2.43	2.78
Sfidë Radikalizmi Fetar	20.134	497	.000	1.593	1.44	1.75
Sfidë Krimi i Organizuar	35.689	497	.000	3.779	3.57	3.99

Fig. 1. Shpërndarja e kampionit për sfidat kryesore të vendit/Mungesa e vizionit politik




Fig. 2. Shpërndarja e kampionit për sfidat kryesore të vendit/ Influenca e vendeve joperëndimore.




Fig. 3. Shpërndarja e kampionit për sfidat kryesore të vendit/ Krimi i organizuar/Trafiqet




Fig. 4. Shpërndarja e kampionit për sfidat kryesore të vendit/Radikalizmi fetar




Tabela 9. Analizë përshkruese, mesatare dhe devijimet standarde për influencat BE-SHBA

	N	Minimum	Maksimum	Mesatare	Devijimi standard
BE Ekonomi	497	1.00	5.00	3.1079	1.18988
BE Politikë	497	1.00	5.00	3.4532	1.14349
BE Art/Kulturë	497	1.00	5.00	2.2014	1.11108
SHBA Ekonomi	497	1.00	5.00	3.0072	1.26546
SHBA Politikë	497	1.00	5.00	3.4460	1.22281
SHBA Art/Kulturë	497	1.00	5.00	2.0432	1.01346
E vlefshme N	497				

Tabela 10. BE: Diferenca mes dimensioneve: ekonomike, politike, kulturore

	t	df	Sig.	Diferenca mesatare	95%	
					I poshtëm	I sipërm
BE Ekonomi	30.795	496	.000	3.10791	2.9084	3.3075
BE Politikë	35.604	496	.000	3.45324	3.2615	3.6450
BE Art/Kulturë	23.360	496	.000	2.20144	2.0151	2.3878

Tabela 11. SHBA-Diferenca mes dimensioneve: ekonomike, politike, kulturore

	t	df	Sig	Diferenca mesatare	95%	
					I poshtëm	I sipërm
SHBA Ekonomi	28.017	496	.000	3.00719	2.7950	3.2194
SHBA Politikë	33.225	496	.000	3.44604	3.2410	3.6511
SHBA Art/Kulturë	23.769	496	.000	2.04317	1.8732	2.2131

Tabela 12. Testi-t (Paired Samples) për krahasimin SHBA-BE në dimensionet: ekonomike, politike, kulturore

						t	df	Sig.
	Mesatarja	Devijimi standard	Gabim standard	95%				
				Poshtëm	Sipërm			
Pai r 1 SHBA Ekonomi BE Ekonomi	-.10072	1.16280	.09863	-.29574	.09430	-1.021	495	.309
Pai r 2 SHBA Politikë BE Politikë	-.00719	.88052	.07468	-.15487	.14048	-.096	495	.923
Pai r 3 SHBA Art/Kulturë BE Art/Kulturë	-.15827	1.24679	.10575	-.36738	.05083	-1.497	495	.137

Tabela 13. Mesatarja dhe devijimi standard: Perceptimet e ndikimit ekonomik, politik dhe kulturor të Ruisë

	N	Mesatarja	Dev. standard	Gabimi standard
Influenca ekonomike e Ruisë	498	2.54	1.055	.089
Influenca politike e Ruisë	498	3.07	1.173	.099
Influenca kulturore e Ruisë	498	1.74	.845	.071

Tabela 13.1. Testi t: Perceptimet e ndikimit ekonomik, politik dhe kulturor të Ruisë

	Test Value = 0					
	t	df	Sig.	Diferenca mesatare	95%	
					I poshtëm	I sipërm
Influenca ekonomike e Ruisë	28.429	497	.000	2.536	2.36	2.71
Influenca politike e Ruisë	30.979	497	.000	3.071	2.88	3.27
Influenca kulturore e Ruisë	24.308	497	.000	1.736	1.59	1.88

Tabela 14. Statistika: Perceptimet e ndikimit ekonomik, politik dhe kulturor të Turqisë

	N	Mesatarja	Dev. Standard	Gabimi standard
Influenca ekonomike e Turqisë	498	3.51	1.202	.102
Influenca politike e Turqisë	498	3.27	1.180	.100
Influenca kulturore e Turqisë	498	2.86	1.323	.112

Tabela 14.1 Testi t: Perceptimet e ndikimit ekonomik, politik dhe kulturor të Turqisë

	Vlera = 0					
	t	df	Sig.	Diferenca mesatare	95%	
					I poshtëm	I sipërm
Influenca ekonomike e Turqisë	34.509	497	.000	3.507	3.31	3.71
Influenca politike e Turqisë	32.791	497	.000	3.271	3.07	3.47
Influenca kulturore e Turqisë	25.561	497	.000	2.857	2.64	3.08

Tabela 15. Perceptimet e ndikimit ekonomik, politik dhe kulturor të Kinës

	N	Mesatarja	Devijimi standard	Gabimi standard
Kinë Ekonomi	498	3.21	1.249	.106
Kinë Politikë	498	2.08	1.053	.089
Kinë Art/Kulturë	498	1.76	.906	.077

Tabela 15.1. Testi t: Perceptimit e ndikimit ekonomik, politik, kulturor të Kinës

	Vlera= 0					
	T	df	Sig.	Diferenca mesatare	95%	
					I poshtëm	I sipërm
Kinë Ekonomi	30.372	497	.000	3.207	3.00	3.42
Kinë Politikë	23.355	497	.000	2.079	1.90	2.25
Kinë Art/Kulturë	22.948	497	.000	1.763	1.61	1.91

Tabela 16. Perceptime të ndikimit ekonomik të Ruisë, Turqisë dhe Kinës

	N	Mesatarja	Devijim standard	Gabimi standard
Rusi Ekonomi	498	2.54	1.055	.089
Turqi Ekonomi	498	3.51	1.202	.102
Kinë Ekonomi	498	3.21	1.249	.106

Tabela 16.1 Testi t: Perceptime të ndikimit ekonomik të Ruisë, Turqisë dhe Kinës

	Vlera = 0					
	T	df	Sig.	Diferenca mesatare	95%	
					I sipërm	I poshtëm
Rusi Ekonomi	28.429	497	.000	2.536	2.36	2.71
Turqi Ekonomi	34.509	497	.000	3.507	3.31	3.71
Kinë Ekonomi	30.372	497	.000	3.207	3.00	3.42

Tabela 17. Perceptime të ndikimit politik të Ruisë, Turqisë dhe Kinës

	N	Mesatarja	Dev. Standard	Gabimi standard
Rusi Politikë	498	3.07	1.173	.099
Turqi Politikë	498	3.27	1.180	.100
Kinë Politikë	498	2.08	1.053	.089

Tabela 17.1 Perceptime të ndikimit politik të Ruisë, Turqisë dhe Kinës

	Vlera = 0					
	T	df	Sig.	Diferenca mesatare	95%	
					I poshtëm	I sipërm
Rusi Politikë	30.979	497	.000	3.071	2.88	3.27
Turqi Politikë	32.791	497	.000	3.271	3.07	3.47
Kinë Politikë	23.355	497	.000	2.079	1.90	2.25

Tabela 18. Perceptime të ndikimit kulturor të Ruisë, Turqisë dhe Kinës

	N	Mesatarja	Devijim Standard	Gabimi standard
Rusi Art/Kulturë	498	1.74	.845	.071
Turqi Art/Kulturë	498	2.86	1.323	.112
Kinë Art/Kulturë	498	1.76	.906	.077

Tabela 18.1 Perceptime të ndikimit kulturor të Ruisë, Turqisë dhe Kinës

	Vlera = 0					
	t	df	Sig.	Diferenca mesatare	95%	
					I poshtëm	I sipërm
Rusi Art/Kulturë	24.308	497	.000	1.736	1.59	1.88
Turqi Art/Kulturë	25.561	497	.000	2.857	2.64	3.08
Kinë Art/Kulturë	22.948	497	.000	1.763	1.61	1.91

Tabela 19. Statistika përshkruese, mesatarja dhe devijimi standard për SHBA-Turqi

	Mesatarja	N	Devijimi standard	Gabimi standard
SHBA Ekonomi	3.0072	497	1.26546	.10734
Turqi Ekonomi	3.51	498	1.206	.102
SHBA Politikë	3.4460	497	1.22281	.10372
Turqi Politikë	3.28	498	1.180	.100
SHBA Art/Kulturë	2.0432	497	1.01346	.08596
Turqi Art/Kulturë	2.86	498	1.327	.113

Tabela 19.1. Testi-t (Paired Samples) për krahasimin SHBA-Turqi në dimensionet ekonomike, politike, kulturore

	Mesatare	Devijim Standard	Gabimi standard	95%		t	df	Sig.
				Poshtëm	Sipërm			
				SHBA Ekonomi				
Turqi Ekonomi	-.50360	1.78713	.15158	-.80332	-.20387	3.322	495	.001
SHBA Politikë								
Turqi Politikë	.16547	1.73455	.14712	-.12544	.45637	1.125	495	.263
SHBA Art/Kulturë								
Turqi Art/Kulturë	-.81295	1.59514	.13530	1.08047	-.54542	6.009	495	.000

Tabela 20. Statistika përshkruese, mesatarja dhe devijimi standard per BE - Turqi

	Mesatarja	N	Devijimi standard	Gabimi standard
BE Ekonomi	3.1079	497	1.18988	.10092
Turqi Ekonomi	3.51	498	1.206	.102
BE Politikë	3.4532	497	1.14349	.09699
Turqi Politikë	3.28	498	1.180	.100
BE Art/Kulturë	2.2014	497	1.11108	.09424
Turqi Art/Kulturë	2.86	498	1.327	.113

Tabela 20.1 Testi-t për krahasimet BE-Turqi në dimensionet, ekonomi, politikë, art dhe kulturë

	Mesatarja	Devijimi standard	Gabimi standard	95%		t	df	Sig. (2-tailed)
				I				
				poshtëm	I sipërm			
BE Ekonomi Turqi Ekonomi	-.40288	1.72668	.14646	-.69246	-.11329	- 2.751	495	.007
BE Politikë Turqi Politikë	.17266	1.65472	.14035	-.10486	.45018	1.230	495	.221

BE								
Art/Kulturë								
Turqi	-.65468	1.88707	.16006	-.97116	-.33819	-	495	.000
Art/Kulturë						4.090		

Tabela 21. Statistika përshkruese, mesatarja dhe devijimi standard për SHBA-Kinë

	Mesatarja	N	Devijimi standard	Gabimi standard
SHBA Ekonomi	3.0072	497	1.26546	.10734
Kinë Ekonomi	3.22	498	1.250	.106
SHBA Politikë	3.4460	497	1.22281	.10372
Kinë Politikë	2.08	498	1.057	.090
SHBA Art/Kulturë	2.0435	497	1.01715	.08659
Kinë Art/Kulturë	1.76	498	.909	.077

Tabela 21.1. Testi-t, për krahasimet SHBA-Kinë dimensionet ekonomi, politikë, art dhe kulturë

	Mesatarja	Devijimi standard	Gabimi standard	95%		t	df	Sig. (2-tailed)
				I	I sipërm			
				poshtëm				
SHBA Ekonomi Kinë	-.20863	1.82366	.15468	-.51448	.09722	- 1.349	495	.180
SHBA Politikë Kinë	1.36691	1.63363	.13856	1.09293	1.64089	9.865	495	.000
SHBA Art/Kulturë Kinë Art/Kulturë	.28261	1.40380	.11950	.04631	.51891	2.365	495	.019

Tabela 22. Statistika përshkruese, mesatarja dhe devijimi standard për BE- Kinë

		Mesatarja	N	Devijimi standard	Gabimi standard
BE	Ekonomi	3.1079	497	1.18988	.10092
Kinë	Ekonomi	3.22	498	1.250	.106
BE	Politikë	3.4532	497	1.14349	.09699
Kinë	Politikë	2.08	498	1.057	.090

BE Art/Kulturë	2.2101	497	1.11036	.09452
Kinë Art/Kulturë	1.76	498	.909	.077

Tabela 22.1. Testi T, për krahasimet BE-Kinë dimensionet, ekonomi, politikë, art dhe kulturë

	95%					t	df	Sig. (2- tailed)
	Mesatarja	Devijimi standard	Gabimi standard	I				
				I poshtëm	I sipërm			
BE Ekonomi Kinë Ekonomi	-.10791	1.76804	.14996	-.40444	.18861	-.720	495	.473
BE Politikë Kinë Politikë	1.37410	1.55700	.13206	1.11297	1.63523	10.405	495	.000
BE Art/Kulturë Kinë Art/Kulturë	.44928	1.48015	.12600	.20012	.69843	3.566	495	.001

Tabela 23. Statistika përshkruese, mesatarja dhe devijimi standard për SHBA –Rusi

	Mean	N	Std. Deviation	Std. Error Mean
SHBA Ekonomi	3.0072	497	1.26546	.10734
Rusi Ekonomi	2.54	498	1.058	.090
SHBA Politikë	3.4460	497	1.22281	.10372
Rusi Politikë	3.08	498	1.174	.100
SHBA Art/Kulturë	2.0432	497	1.01346	.08596
Rusi Art/Kulturë	1.73	498	.841	.071

Tabela 23.1. Testi T, për krahasimet SHBA-Rusi dimensionet: ekonomi, politikë, art dhe kulturë

	Mesatarja	Devijimi standard	Gabimi standard	95%		t	df	Sig. (2-tailed)
				I poshtëm	I sipërm			
				SHBA Ekonomi Rusi Ekonomi	.46763			

SHBA									
Politikë Rusi	.36691	1.79429	.15219	.06598	.66783	2.411	495	.017	
Politikë									
SHBA									
Art/Kulturë	.31655	1.23966	.10515	.10864	.52445	3.011	495	.003	
Rusi									
Art/Kulturë									

Tabela 24. Statistika përshkruese, mesatarja dhe devijimi standard për BE– Rusi

	Mean	N	Std. Deviation	Std. Error Mean
BE Ekonomi	3.1079	497	1.18988	.10092
Rusi Ekonomi	2.54	498	1.058	.090
BE Politikë	3.4532	497	1.14349	.09699
Rusi Politikë	3.08	498	1.174	.100
BE Art/Kulturë	2.2014	497	1.11108	.09424
Rusi Art/Kulturë	1.73	498	.841	.071

Tabela 24.1. Testi-t, për krahasimet BE-Rusi dimensionet ekonomi, politikë, art dhe kulturë

						t	df	Sig. (2-tailed)
	Mesatarja	Devijimi standard	Gabimi standard	95%				
				I poshtëm	I sipërm			
BE Ekonomi Rusi Ekonomi	.56835	1.55130	.13158	.30817	.82852	4.319	495	.000
BE Politikë Rusi Politikë	.37410	1.71639	.14558	.08624	.66196	2.570	495	.011
BE Art/Kulturë Rusi Art/Kulturë	.47482	1.36907	.11612	.24521	.70443	4.089	495	.000

Tabela 25. Shpërndarja e kampionit sipas perceptimeve të Ruisë si pengesë

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
E vlefshme aspak	114	22.8	22.8	22.8
pak	157	31.5	31.5	54.3

disi	125	25.0	25.0	79.3
mjaftueshëm	71	14.3	14.3	93.6
shumë	33	6.6	6.4	100.0
Total	500	100.0	100.0	

Tabela 26. Shpërndarja e kampionit sipas perceptimeve të Turqisë si pengesë

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
E vlefshme				
aspak	147	29.4	29.4	29.4
pak	136	27.2	27.2	56.6
disi	128	25.6	25.6	82.2
mjaftueshëm	47	9.4	9.4	91.6
shumë	42	8.4	8.4	100.0
Total	500	100.0	100.0	

Tabela 27. Shpërndarja e kampionit sipas perceptimeve të Kinës si pengesë

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
E vlefshme aspak	282	56.4	56.4	56.4
pak	107	21.4	21.4	77.9
disi	86	17.1	17.1	95.0
mjaftueshëm	18	3.6	3.6	98.6
shumë	7	1.4	1.4	100.0
Total	500	100.0	100.0	

Fig. 5. Perceptimet e Ruisë si pengesë




Fig. 6. Perceptimet e Turqisë si pengesë




Fig. 7. Perceptimet e Kinës si pengesë




Tabela 28. Mesataret dhe devijimet standarde mbi pengesat e perceptuara: Rusi, Turqi, Kinë

	N	Mesatarja	Devijim standard	Gabimi Standard
Rusia Pengesë	500	2.50	1.178	.100
Turqia Pengesë	500	2.35	1.192	.102
Kina Pengesë	500	1.72	.968	.082

Tabela 28.1 Dallimet në pengesat e perceptuara: Rusi, Turqi, Kinë

	Vlera e testit = 0					
	t	df	Sig.	Diferenca mesatare	95%	
					I poshtëm	I sipërm
Rusia Pengesë	25.103	499	.000	2.500	2.30	2.70
Turqia Pengesë	23.082	499	.000	2.350	2.15	2.55
Kina Pengesë	21.050	499	.000	1.721	1.56	1.88